**ALBANIAN UNIVERSITY**
**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE**
**DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO-ADMINISTRATIVE**

**TEMË PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"**

# "ADMINISTRIMI I POLITIKAVE KRYESORE NË BASHKIMIN EUROPIAN PAS TRAKTATIT TË LISBONËS. RISI DHE PROBLEMATIKA"

**PUNOI:**

**Leudita (Doçaj) ADEMI**

**UDHËHEQËS SHKENCOR:**

**Prof. Asoc. Dr. KARAMUÇO**

**TIRANË, 2020**

**ALBANIAN UNIVERSITY**
**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE**
**DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO-ADMINISTRATIVE**

Disertacion i paraqitur nga **Leudita (Doçaj) ADEMI**

për mbrojtjen e gradës shkencore **"Doktor"**

# ADMINISTRIMI I POLITIKAVE KRYESORE NË BASHKIMIN EUROPIAN PAS TRAKTATIT TË LISBONËS. RISI DHE PROBLEMATIKA

Programi i studimit: **Shkenca Administrative**

Udhëheqës Shkencor:

**Prof. Asoc. Dr. Ervin KARAMUÇO**

Mbrohet më, datë ____/____/_____

1._____ Kryetar

2._____ Anëtar (oponent)

3._____ Anëtar (oponent)

4._____ Anëtar

5._____ Anëtar

**TIRANË, 2020**

## Përmbajtja

**Administrimi i politikave kryesore në Bashkimin Europian pas Traktatit të Lisbonës. Risi dhe problematika.**

Dedikim

Deklarata e autorësisë

Abstrakti

Abstrakti në gjuhën Angleze

Lista e shkurtimeve

Lista e Tabelave

Hyrje

- Pyetje kërkimore dhe qëllimi i studimit
- Hipoteza
- Metodologjia e kërkimit
- Rëndësia e studimit
- Strukturimi i studimit

**KAPITULLI I – Fillesat e Traktatit të Lisbonës:**

I.A. Zhvillimet historike që sollën Traktatin e Lisbonës

I.B. Nryshimet institucionale si pasojë e këtij Traktati

I.C. Sfidat dhe mosmarrëveshjet mbi miratimin e Traktatit të Lisbonës

I.Ç. Politikat kryesore në vijim të Traktatit

I.D. Funksionimi i BE-së në terma ekonomike

**KAPITULLI II - Çështjet më të diskutuara në raport me politikat kryesore të BE-së pas Traktatit të Lisbonës:**

II.A. Edukimi dhe punësimi në BE sfiduar nga kultura dhe teknologjia:

II.A.1 Edukimi: sa të punësueshëm dhe sa punësohen të rinjtë në BE,

II.A.2 Edukimi dhe kultura në BE,

II.A.3 Edukimi dhe teknologjia në BE.

II.B.Dalja e Britanisë nga BE (BREXIT):

II.B.1 Rrjedha e ngjarjeve deri në Brexit,

II.B.2 Një version zgjidhjesh për rindërtimin e Post-Brexitit të BE-së,

II.B.3 Gjendja aktuale e BE-së pas procedurave të Brexit.

II.C.Barazia Gjinore:

II.C.1 Një argument mbi përparimin e ngadaltë drejtë barazisë efektive në dekadën e fundit,

II.C.2 Sa i adreson strategjia e re çështjet e pazgjidhura të së kaluarës.

II.Ç.Siguria dhe Mbrojtja:

II.Ç.1 Zhvillimet institucionale dhe politike,

II.Ç.2 Sfida dhe zgjidhje që parashikohen në këto fusha.

**KAPITULLI III - Ballkani Perëndimor drejtë zgjerimit në BE:**

III.A. Rrugëtimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor për në integrimin Europian dhe gjendja aktuale,

III.B. Qëndrimi i institucioneve kryesore të BE-së lidhur me zgjerimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor,

III.C. Politikat e reja për Ballkanin Perëndimor mbi zgjerimin në BE.

**KAPITULLI IV -Risitë dhe Problematikat e Traktatit të Lisbonës**

**KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

**Bibliografia**

## Dedikim

*Ky punim i dedikohet familjes time,*

*Leudita*

# Deklarata e autorësisë

Unë vërtetoj që ky punim doktoral është vepër dhe punë origjinale e imja, bazuar në studimin tim personal e hulumtimin tim dhe që kam njohur, cituar, referuar, të gjitha materialet dhe burimet e përdorura në përgatitjen e tij, qofshin ato libra, artikuj, raporte, leksione dhe çdo lloj dokumenti, komunikimi elektronik ose personal. Unë gjithashtu vërtetoj që ky punim nuk është paraqitur më parë për vlerësim në ndonjë institucion tjetër, përveç disa pjesëve të tij, në respektim të rregullores së programit të studimit të ciklit të tretë të Universitetit "Albanian University", dhe që unë nuk kam kopjuar pjesërisht ose plotësisht punën e personave të tjerë dhe nuk kam kryer plagjiaturë.

Këtë deklaratë e bëj me përgjegjësinë time të plotë intelektuale dhe morale.

**Emër Mbiemër**

_____

**Nënshkrimi**

_____

**Data**

_____

## Abstrakti

Ky studim synon të shqyrtojë disa prej politikave kryesore të Bashkimit Europian të para në dimensionet që i dha Traktati i Lisbonës. Duke analizuar: sjelljen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të vendeve anëtare,kompetencat që mori tashmë BE-ja në fushat e caktuara,instrumentat e disponueshëm për politikat, procedurat e reja të vendim-marrjes, zhvillimet institucionale, qasjet ndaj vendeve që synojnë të jenë pjesë e BE-së.

Në aspektin krahasues shprehem se Traktati i Lisbonës shkëlqeu nga traktatet e mëparshme sa i përket reformimit, vendosjes së objektivave, përcaktimin e procedurave specifike, përmirësim të instrumentëve politikë, kompetenca të reja dhe hapësirës për vendime që nuk kërkojnë unanimitet.

Në aspektin praktik vë në dukje hapësirën e limituar ndërsektoriale / multidisiplinore që shfaq kufizime në praktikë dhe zbatueshmëri duke dhënë sygjerimet e mia pas analizës sesi mund të përmirësohet zbatueshmëria dhe administrimi i këtyre politikave për të rritur në nivel më të lartë efiçencën e tyre. Politikat e trajtuara në studimin tim janë ato politika të konsideruara si pikat më të ndjeshme të Bashkimit Europian.

***Fusha e studimit**: administrimi i politikave kryesore në BE, pas Traktatit të Lisbonës.*

***Fjalët kyçe**: administrim, BE, Traktati i Lisbonës, politikat kryesore, analizë, krahasim, procedura, efiçencë, problematika, sygjerime.*

## Abstract

This study aims to examine some of the key policies of the European Union in the dimensions given to them by the Lisbon Treaty. Analyzing: the behavior at national and international levels of the member states, the competencies that the EU has already acquired in certain areas, the policy instruments available, the new decision-making procedures, the institutional developments, the approaches to the countries that intend to be part of the EU in the future.

In comparative terms, the Lisbon Treaty excels from previous treaties in terms of reform, setting objectives, setting specific procedures, improving policy instruments, giving new powers and room for unanimous decision-making.

In practical terms, I note the limited space in practice and applicability, giving my suggestions after the analysis of how the implementation and administration of these policies can be improved to increase their efficiency to a higher level. The policies addressed in my study are: policies on EU enlargement in the Balkans, policies on education and employment, policies about gender equality, policies on security and defense issues and Brexit.

***Field of study****: the administration of key policies in the EU, after the Lisbon Treaty.*

***Keywords****: administration, EU, Lisbon Treaty, key policies, analysis, comparison, procedures, efficiency, issues, suggestions.*

## Lista e shkurtimeve

- ABAC - Sistemi i Kompjuterizuar i Kontabilitetit
- AEM - Agjensia Europiane e Mbrojtjes
- AFIS - Sistemi i Informacionit Anti-Mashtrim
- BUDG - Komiteti i Parlamentit për Buxhetet
- CARD - Rishikimi i Koordinuar Vjetor i Mbrojtjes
- CEDEFOP - Qëndra Europiane për Zhvillimin e Aftësimit Profesional
- CEF - Objekti i Ndërlidhjes Europiane
- CFR - Karta e të Drejtave Themelore
- CFSP - Politikat e Përbashkëta të Jashtme dhe Sigurisë
- CP - Politika e Kohezionit
- CSDP- Politikat e Mbrojtjes dhe Sigurisë së Përbashkët
- EU – Bashkimi Europian/Bashkimi/Unioni
- EAFRD- Fondi Europian Bujqësor për Zhvillim Rural
- EAGF- Fondi Europian i Garancisë Bujqësore
- ECA- Gjykata Europiane e Auditorëve
- ECB –Banka Qëndrore Europiane
- ECHR - Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

- ECI - Iniciativa Qytetare Europiane
- ECSC- Komuniteti Europian i Qymyrit dhe Çelikut
- EDF- Fondi Europian për Mbrojtjen
- EEAS - Shërbimi Europian për Veprim të Jashtëm
- EEC - Komuniteti Ekonomik Europian
- EfC - (program) Europa për Qytetarët
- EFSF- Stabiliteti Financiar Europian
- EIB- Banka Europiane e Investimeve
- EIF-Fondi Europian i Investimeve
- EMU- Unioni Ekonomik dhe Monetar
- EPO- Zyra Europiane e Patentave
- EPP- Partia Popullore Europiane
- EPPO- Zyra Europiane e Prokurorit Publik
- ERCC- Qëndra e Koordinimit të Veprimeve të Emergjencës
- ERDF- Fondi Europian për Zhvillimin Rajonal
- ESA- Sistemi Europian i Llogarive
- ESCS-Komuniteti Europian i Qymyrit dhe Çelikut
- ESF – Fondi Social Europian

- ESM- Mekanizmat Europian të Stabilizimit
- EUGS- Strategjia globale e Bashkimit Europian
- EUROATOM- Komuniteti Europian i Energjisë Atomike
- EUROJUST- Njësia e Bashkëpunimit Gjyqësor e Bashkimit Europian
- EUROPOL- Zyra e Policisë Europiane
- FTD - Fondi i Tranzicionit të Drejtë
- GNI- Të ardhurat Kombëtare Bruto
- IFAC- Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
- IGC- Konferenca Ndërqeveritare
- JHA - Drejtësia dhe punët e brendshme
- IIA - Marrëveshja e Parë Ndërinstitucionale
- IMS- Sistemi i Menaxhimit të Parregullsive
- IPSAS - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
- KEE- Komuniteti Ekonomik Europian
- Klauzola Passerelle - Klauzolë në traktatet e BE-së që lejon ndryshimin e një procedure legjislative pa ndërhyrje në traktate.
- MFF- Kuadri/ Korniza Financiare Shumëvjeçare
- MPCC- Planifikimi Ushtarak dhe Kapaciteti Përcjellës

- MSA- Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit
- MTR- Rishikimi Afatmesëm
- NEET- Përdorur për t'u referuar të rinjve që janë të paarsimuar dhe të papunë
- NK - Nënkryetari i Komisionit
- OLAF- Zyra Europiane kundër Mashtrimit
- PADR- Plani përgatitor i Veprimit për Kërkim Shkencor në Çështjet e Mbrojtjes
- PESCO- Bashkëpunim i Strukturuar i Përhershëm
- PL - Përfaqësuesi i Lartë
- QMV- Votim me shumicë të kualifikuar
- RYCO – Zyrat Rajonale të Bashkëpunimit Rinor
- SBA- Zonat Bazë Sovrane
- SRHR- Shëndeti Seksual dhe Riprodhues dhe të Drejtat
- *Spitzenkandidaten* - Kandidati Kryesor propozuar nga secili grupim politik më i përfaqësuar në Parlament për emërimin në postin e Presidentit të Komisionit përpara zgjedhjeve parlamentare.
- TEU - Traktatit për Bashkimin Europian
- TFEU- Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian
- VAT- TVSH
- VAW- Dhuna ndaj Grave

- WBCIF- Forumi i Dhomave të Investimeve të Ballkanit Perëndimor
- WBF - Fondi për Ballkanin Perëndimor
- WPS- Axhendës së Gruas, Paqes dhe Sigurisë
- WTO- Organizata Botërore e Tregtisë

## Lista e Tabelave

**Tabela 1** -Zhvillimet historike që sollën Traktatin e Lisbonës

**Tabela 2 -**Skemë mbi procedurat e zakonshme legjislative, marrë nga *Udhëzuesi për Institucionet e BE-së:Si funksionon BE*

**Tabela 3 -** Pasqyrimi i votimit nga shtetet anëtare të Traktatit të Lisbonës

**Tabela 4 -** Risitë që solli Traktati i Lisbonës në pesë politikat kryesore

**Tabela 5 -**Traktati i Lisbonës në këndvështrimin e disa politikave kryesore: Më shumë kompetenca për veprime rregulluese?

**Tabela 6 -** Zgjerimi dhe thellimi i aftësive të politikë-bërjes i parë tek politikat kryesore, duke e krahasuar në disa Traktate

# Hyrje

Traktati i Lisbonës është rezultati përfundimtar i një kërkimi të zgjatur për të patur një Bashkim Europian më efikas dhe demokratik, si dhe të jetë më koherent në marrëdhëniet e tij të brendëshme dhe politikat e përbashkëta të jashtme. Por sa i rëndësishëm është atëherë traktati?

Traktati i Lisbonës prezantoi dhe më pas aplikoi ndryshime të shumta institucionale sikurse jam përpjekur të shpjegoj përgjatë punimit tim, të cilat patën ndikim të madh. Votimi i shumicës në Këshillin e Ministrave supozohet të ketë rritur efikasitetin. Kështu është zgjedhja e një presidenti i cili tashme ka një angazhim me kohë të plotë në Këshillin Europian. Më shumë bashkë-vendime që përfshijnë Këshillin dhe Parlamentin Europian në procesin legjislativ supozohet të rrisin demokracinë dhe legjitimitetin, ku Parlamenti Europian është i vetmi organ i zgjedhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Krijimi i postit të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë / Zëvendës Presidenti i Komisionit si dhe Shërbimi Europian për Veprim të Jashtëm për ta ndihmuar atë, janë hapa që u ndërmorrën më qëllim rritjen e bashkëveprimit midis marrëdhënieve të jashtme ekonomike, politikat e përbashkëta të jashtme dhe çështjet e sigurisë . Ndryshimet institucionale sollën zhvillime të politikave kryesore sikure janë: politikat ekonomike që kishin si synim një bashkim ekonomik e monetarë; politikat mbi sigurinë dhe mbrojtjen ku shprehen qartazi mbi vendimet që duhet të miratohen unanimisht nga 27 vendet anëtare për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes; politikat sociale ku dallohet dukshëm një zgjerim i fushave të cilat tashmë duhet të konsiderohen nga vendet e BE-së dhe kryesisht duke vendosur në fokus politikat e punësimit; politika në lidhje me të drejtat e njeriut ku u vendos si një detyrim për të gjitha vendet anëtare zbatueshmëria e Kartës së të Drejtave Themelore.

**Pyetjet kërkimore dhe qëllimi i studimit**

A janë institucionet e reja të ndërtuara dhe konceptuara mirë për t'u përballur me sfidat që paraqiten , qofshin ato dhe në aspektin e administrimit ? Apo drejtuesit dhe institucionet kryesore vendim-marrëse duhet të ndihmojnë më shumë për të kapërcyer problemet e veprimit të përbashkët dhe, nëse po, sa të disponueshëm janë treguar? Pse intgrimi është kaq i diferencuar ndërmjet vendeve anëtare? A po provon koha për një konvergjencë interesash sa i takon politikave kyçe? A kanë arritur që të krijojnë më

shumë identitet kolektiv aktorët e përfshirë? A ekziston vullneti politik, praktika dhe besimi i ndërsjelltë që mund ta shndërrojë BE-në në aktorin kryesor gjeopolitik? Këto janë të gjitha pyetjet kryesore në hulumtimin e vazhdueshëm mbi integrimin europian.

Qëllimi i punimit të temës time është të identifikojë problematikat dhe risitë qe solli ky traktat pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të tij, për të shërbyer si material analizues për kedo që do të ketë interes në këtë fushë studimi, sikurse dhe të shërbejë si udhëzues për vendet që duan të jenë pjesë në të ardhmen, e Bashkimit Europian. Ku sigurisht Shqipëria  është një prej tyre. Synoj gjithashtu të shpreh konceptin dhe mendimin tim mbi Traktatin e Lisbonës, se deri ku po shkon në planin e tij të veprimit dhe mbi të gjitha se cila është e ardhmja.

**Hipoteza**

Krijimi i një traktati të ri , do të ngacmonte më tej situatën ekonomike dhe politike në BE, e cila është shumë e ndjeshme sidomos pas krizave që ka kaluar në 10-vjeçarin e fundit (kujtojmë krizën financiare, të emigrimit,zbatimin e legjislacionit, Brexit dhe një presioni të vazhdueshëm gjeopolitik nga Kina,Amerika ose Rusia). Në këto kushte mund të them se Traktati i Lisbonës ka qënë një sukses përsa i përket produktivitetit të tij.

**Sfida e BE-së  nëse do nuk do që të humbasë influencën në një mjedis politik dhe ekonomik ndërkombëtarë që është në ndryshim të vazhdueshm, mbetet rritja e efiçencës së këtij traktati, duke shfrytëzuar të gjitha aspektet ose dispozitat të cilat rezultojnë si të pa prekura më parë, ose të pa shfrytëzuara si duhet.**

**Metodologjia e Kërkimit**

Tema e këtij punimi shkencor është teorike. Për këtë ndjek një metodologji tipike standarde për punime të kësaj fushe. Ajo mbështetet në të dhëna cilësore. Jam angazhuar për mbledhjen e të dhënave parësore. Përgjatë punimit  kam konsideruar me seriozitet të gjithë aspektet etike të kërkimit shkencor. Ky punim përpiqet të diskutojë mbi një temë pak të folur në Shqipëri si dhe të përshkruaj karakteristikat më të veçanta të BE-së. Besoj se kjo e bën më të vlefshëm punimin tim.

Formulimi i temës erdhi pas konsultimeve thuajse një vjeçare për të gjetur, në fushën e interesit dhe pasionit tim, një kënd të pa trajtuar më parë për të adresuar pse jo dhe një hapësirë boshe në literaturë për këtë.

Punimi është mbështetur në factsheet-e, studime, analiza të thelluara dhe punime shkencore të prodhuara nga ekspertë dhe kërkues shkencor (Think Tank) të BE-së publikuar në faqen zyrtare për këtë qëllim, të Parlamentit Europian.

Metoda e analizës së përdorur, ndryshe nga sa ndodh shpesh në kërkimin shkencor në Shkencat Politike, nuk është analizë krahasuese por analizë diskursi që nënkupton se informacioni është procesuar duke përshkruar, diskutuar, shtjelluar, analizuar dhe interpretuar konstatime e përfundime nga gjetje të deri më tanishme për t'i dhënë një kuptim dhe sqarim rasteve studimore.

Kjo qasje metodologjike u dakortësua si pasojë e kushtëzimit prej praktikave të caktuara mbi kërkimin në këtë fushë, ky ishte varianti më i përshtatshëm i qasjes duke konsideruar hapësirën në literaturë sa i takon temës. Kjo ishte dhe pengesa më e madhe, bashkë me ngarkesën shkaktuar nga punimi me literaturë të huaj. Të gjitha këto vetëm intensifikuan përpjekjet për ta bërë kërkimin dhe hulumtimin sa më rigoroz.

**Rëndësia e studimit**

Traktati i Lisbonës siguristh që ka patur efekte në funksionimin Bashkimit Europian, dhe ka shumë diskutime si për funksionimin e tij përmes dispozitave të tij për qeverisjen dhe vendimmarrjen, ashtu edhe për zhvillimin e mëtejshëm të BE-së. Traktati i Lisbonës ka qasje politike për formën sesi ky bashkim po zhvillohet dhe këto janë po aq domethënëse për të diskutuar të ardhmen e mundshme për funksionimin më të mirë të BE-së sa dhe ndryshimet institucionale. Përkundër këtyre ndryshimeve, Lisbona nuk garanton një të ardhme për Bashkimin Europian dhe lë shumë çështje të pazgjidhura të cilat i kam përshkruar në kapitullin e fundit të punimit tim.

Traktati i Lisbonës u krijuar për të siguruar një themel të fortë për të ardhmen e Bashkimit Europian dhe kishte tre qëllime kryesore: më shumë efikasitet në procesin e vendimmarrjes; më shumë demokraci përmes një roli më të madh për Parlamentin Europian dhe parlamenteve kombëtare; sikurse dhe koherencë në rritjen e politikave të përbashkëta të jashtme ". Këto janë fushat më të prekura nga traktati, dhe janë gjithashtu në fokus të analizës së këtij punimi.

Me inovacionet që solli Lisbona, çelësi për BE-në që të shndërrohet në një aktor më të besueshëm gjeopolitik nuk qëndron në ndryshimet e mëtejshme të traktatit, por në

vullnetin politik, praktikën dhe besimin e ndërsjellë. Ajo kërkon që, shteti i madh anëtar, apo kryeqytetet kombëtare të shohin interesat e tyre strategjikë në drejtim të një interesi më të gjerë europian dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat. Në parim, të gjitha instrumentet janë ku duhet. Ato që nuk rezultojnë të jenë, mund të krijohen brenda kornizës së Lisbonës.

Rëndësia e këtij  punimi qëndron në faktin se identifikon problematikat dhe risitë që solli ky traktat pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të tij, se deri ku po shkon në planin e tij të veprimit dhe mbi të gjitha se cila është e ardhmja, me qëllimin për të shërbyer si material analizues për këdo që do të ketë interes në këtë fushë studimi, sikurse dhe të shërbejë si udhëzues për vendet që duan të jenë pjesë në të ardhmen , e Bashkimit Europian.

**Strurkturimi i studimit**

Ky punim është i strukturuar në katër kapituj për t'u përmbyllur më pas me pjesën e fundit kushtuar konkluzioneve dhe rekomandimeve.

*Në kapitullin e parë*, të titulluar fillesat e Traktatit të Lisbonës, kam trajtuar katër nënçështje të rëndësishme të lidhura me zhvillimet historike që sollën Traktatin e Lisbonës, ndryshimet institucionale që erdhën si pasojë e këtij traktati ( ku përmend institucionet kryesore dhe drejtuese të BE-së), sfidat dhe mosmarrëveshjet për miratimin e Traktatit të Lisbonës, politikat kryesore dhe orjentimin që morën ato pas kësaj periudhe sikurse dhe buxhetimin e financimin e tyre .

*Në kapitullin e dytë*, të titulluar çështjet më të diskutuara në raport me politikat kryesore të BE-së pas Traktatit të Lisbonës, kam trajtuar disa prej këtyre politikave. Jam përqëndruar tek politikat e edukimit dhe punësimit nën ndikimin e kulturave kombëtare dhe avancimeve të teknologjisë, duke analizuar sesa të punësueshëm dhe sa punësohen të rinjtë në BE.

Jam përqëndruar tek politikat mbi barazinë gjinore , duke dhënë një argument mbi përparimin e ngadaltë drejtë arritjes së një barazie efektive përgjatë dekadës së fundit, dhe sesa i adreson strategjia e re çështjet e pazgjidhura më parë.

Jam përqëndruar tek politikat e sigurisë dhe mbrojtjes që sikurse e kam përmendur dhe më parë ishte një nga pikat kryesore të Traktatit të Lisbonës, ku kam trajtuar zhvillimet paralele të intitucioneve dhe politikave të para në këtë këndvështrim,  sfidat që paraqiten dhe zgjidhjet e mundëshme që parashikohen në këto fusha.

Jam përqëndruar në çështjen e daljes së Britanisë nga BE-ja, njohur me termin BREXIT. Ku kam shpjeguar rrjedhjen e ngjarjeve deri në Brexit, një pasqqyrim të rezolutave të propozuara për rindërtimin e BE-së post-Brexit, dhe gjëndja aktuale e BE-së pas ketij ndryshimi.

*Në kapitullin e tretë*, të titulluar Ballkani Perëndimor drejtë zgjerimit në BE, kam trajtuar rrugëtimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor  në procesin e integrimit europian dhe si paraqitet gjëndja aktuale. Kam trajtuar qëndrimin e institucioneve kryesore të BE-së lidhur me zgjerimin në këtë rajon, sikurse dhe politikat e reja për zgjerimin e BE-së drejtë Balkanit Perëndimor.

*Në kapitullin e katërt*, të titulluar risitë dhe problematikat e Traktatit të Lisbonës , kam trajtuar  në formë më të përqëndruar ndryshimet kryesore të sjella nga ky traktat si në aspektin instucional dhe në aspektin e politikëbërjes. Duke adresuar dhe evidentuar problematikat që i shoqëruan.

Pjesa e fundit përqëndrohet tek konkluzionet dhe përfundimet e arritura pas gjithë hulumtimit tim mbi këtë fushë. Ku jam përpjekur të shpreh qartë mendimet e mia si rrjedhojë e leximeve dhe hulumtimeve  të kryera.

Bibliografia po ashtu është bashkëlidhur në fund të këtij punimi në formë të përmbledhur, por  gjëndet e cituar dhe e referuar  përgjatë të gjithë punimit tim.

**KAPITULLI I PARË – Fillesat e Traktatit të Lisbonës**

# Fillesat e Traktatit të Lisbonës

- **Zhvillimet historike që sollën Traktatin e Lisbonës**
- **Nryshimet institucionale si pasojë e këtij Traktati**
- **Sfidat dhe mosmarrëveshjet mbi miratimin e Traktatit të Lisbonës**
- **Politikat kryesore në vijim të Traktatit**
- **Funksionimi i BE-së në terma ekonomike**

Bashkimi Europian filloi rrugëtimin e tij rreth gjysmë shekulli më parë. Drejtuesit vizionarë u mblodhën me qëllim që të krijonin një stabilitet ekonomik dhe politik për të siguruar paqen në Europë. Prej kësaj periudhe shumë drejtues të tjerë që kanë pasuar drejtimin e vendeve anëtare por dhe të BE-së janë përpjekur të vazhdojnë këtë vizion . Hartimi dhe miratimi i traktateve është parë si një rrugë e drejtë në vazhdimësinë e këtij vizioni.

Në vitin 1951, Traktati i Parisit themeloi Komunitetin Europian të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC), i pari i një grupi traktatesh që pasuan më tej me qëllimin e rritjes së bashkëpunimit në Europë. Vendet themeluese në Komunitetin Europian të Qymyrit dhe Çelikut ishin Belgjika, Franca, Gjermania Perëndimore, Italia, Luksemburgu dhe Hollanda.

Pas suksesit të Komunitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC), themeluesit e zgjeruan bashkëpunimin e tyre duke nënshkruar Traktatet e Romës në Mars 1957, duke themeluar Komunitetin Ekonomik Europian (KEE) dhe Komunitetin Europian të Energjisë Atomike (EURATOM). Qëllimi i KEE -së ishte të krijonte një treg të përbashkët bazuar në lirinë e lëvizjes së njerëzve, të mirave e shërbimeve dhe kapitalit.

Në vitin 1968, u futën politikat e para të përbashkëta në lidhje me bujqësinë dhe tregtinë. Krahas KEE-së, EURATOM u krijua për të promovuar përdorimin paqësor të energjisë bërthamore në Europë.

Komunitetet Europiane u stabilizuan në pozicionin dhe rolin e tyre më qartazi nga mesi i viteve ‘60 . Sidoqoftë, udhëheqësit e këtij projekti menduan se Komunitetet kishin mundësi për t’u përmirësuar dhe më tej. Sipas Traktatit të Brukselit, të tre komunitetet u shkrinë në një, të menaxhuara nga Komisioni , Këshilli dhe Asambleja. Ky ishte një hap i rëndësishëm drejt BE-së sikurse ne e njohim atë sot.

Ndërsa Komuniteti Europian u rrit, udhëheqësit e saj e kuptuan se kishin nevojë për të forcuar lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve. Kjo do të ndihmonte komunitetin europian të krijonte të ardhura dhe vende të reja pune. Si pasojë, ata krijuan një treg të vetëm siç përcaktohet në Aktin Unik Europian , duke e parë si një nga arritjet më të mëdha të BE-së. Krijimi i tregut të vetëm hapi rrugën për më shumë konkurrencë, efikasitet dhe çmime më të ulëta.

Traktati i Mastrihtit i nënshkruar më 7 Shkurt 1992, themeloi Bashkimin Europian (BE) mbi bazën e tre shtyllave: Komunitetet Europiane, Politikën e Përbashkët të Jashtme

dhe të Sigurisë , dhe Bashkëpunimin Policorë e Gjyqësor në Çështjet Penale . Ky traktat prezantoi konceptin e shtetësisë europiane, forcoi fuqitë e Parlamentit Europian dhe filloi bashkimin ekonomik dhe monetar (EMU).

Nevoja për zgjidhje dhe problemet e reja që u shfaqën sollën në krijimin e Traktatit të Amsterdamit, i cili solli përsëri ndryshime nga traktatet e mëparshme. Shtetet Anëtare ndjenin nevojën për të zbatuar lirinë e lëvizjes për të rritur ekonominë e BE-së. Kështu, Traktati i Amsterdamit përfshiu dispozita të reja mbi Marrëveshjen e Shengenit në kornizën e BE-së. Në atë kohë, Shengen ishte ende një formë ndërqeveritare e bashkëpunimit midis 5 Shteteve Anëtare.

Traktati i Nicës, i nënshkruar në 2001, rregulloi sistemin institucional në një përpjekje për të ruajtur efikasitetin në përgatitjen për zgjerimin e katërt dhe më të madh në BE.

Pas zgjerimit të pestë, BE u përball me sfida të reja burokratike sikurse vijojnë të shpjeguara me poshtë në këtë punim.

Si rezultat, Traktati i Lisbonës, i nënshkruar në vitin 2007, thjeshtoi praktikat e mëparshme, rregullat e votimit dhe krijoi një President të Këshillit Europian. Gjithashtu traktati krijoi postin e Përfaqësuesit të Lartë për Çështjet e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë. Kjo forcoi rolin e BE-së në sferën ndërkombëtare. Por për të kuptuar më mirë se si erdhi BE-ja deri në këtë pikë është me rëndësi rishikimi i zhvillimeve historike.

| **Viti** | **Traktati** | **Komente** |
|---|---|---|
| 1952 | Traktati themelues i Komunitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut | Komuniteti Europian i Qymyrit dhe Çelikut (ECSC) |
| 1957 | Traktati i Romës | Nënshkruhet Traktati themelues i Komunitetit Europian të Energjisë Atomike, gjithashtu Komuniteti Ekonomik Europian , të dy bashkë njihen si Traktatet e Romës |
| 1965 | Traktati i Bashkimit | Krijimi i një Komision dhe një Këshilli të Vetëm për |

| | | |
|---|---|---|
| | | të tre Komunitetet Europiane |
| 1987 | Akti Unik Europian | Bëhen përshtatje me Traktatin e KE-së me qëllim arritjen e Tregut të Brendshëm Europian |
| 1993 | Traktati i Mastrihtit) | Krijohet Bashkimi Europian<br>Traktati i Mastrihtit ndryshoi dhe emrin nga Komuniteti Ekonomik Europian në Komunitet Europian.<br>Miratohen forma të reja bashkëpunimi midis qeverive të Shteteve Anëtare mbi politikën e jashtme dhe të sigurisë dhe në fushën e çështjeve të brendshme dhe drejtësisë.<br>Traktati i Mastrihtit krijon një strukturë të re me tre shtylla, si në aspektin politik ashtu dhe në aspektin ekonomik. |
| 1999 | Traktati i Amsterdamit | Ndryshohen dhe riorganizohen traktatet e BE-së |
| 2003 | Traktati i Nicës | Pas zgjerimit me 25 Shtete Anëtare, reformohen institucionet me qëllim që Bashkimi të mund të funksionojë në mënyrë eficiente.<br>Traktati i Nicës, Traktati i Bashkimit Europian/Mastrihtit dhe Traktati i Romës bashkohen në një instrument të vetëm të konsoliduar. |
| 2009 | Traktati i Lisbonës | Ky traktat e bën BE-në:<br>më eficiente; më demokratike; më të bashkuar në arenën botërore; më të sigurt. |

**Tabela 1-** Zhvillimet historike që sollën Traktatin e Lisbonës

### I.A. Zhvillimet historike që sollën Traktatin e Lisbonës

Historia e Traktatit të Lisbonës nuk mund të përshkruhet si duhet, pa u rikthyer në Traktatin Kushtetues, i cili përfaqëson sfondin në të cilin u ndërtua Traktati i Lisbonës.

Për këtë arsye kam zgjedhur të ndalem në shpjegimin e Traktatit Kushtetues, për të kuptuar më pas nevojën e një traktati të ri .

Traktati Kushtetues i cili u nënshkrua në Romë më 29 Tetor 2004 nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian (në vitin 2004 BE-ja kishte 25 shtete anëtare), dhe që u ratifikua nga tetëmbëdhjetë shtete , por u refuzua në dy referendumet e mbajtura në Francë dhe Hollandë , krijuan një shteg të ri në rishikimin e Traktatit.[1]

Përpara se palët të kishin rënë dakort në bazë të procedurës që parashikohej në Konferencën Ndërqeveritare, Traktati Kushtetues u diskutua dhe u hartua nga një grupim i madh i përfaqësuesve, jo vetëm të shteteve anëtare, por edhe të Parlamentit Europian, si dhe të Parlamenteve Kombëtare.

Ishte modeli i miratimit të konventave, i përdorur më parë për të hartuar Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian më 7 Dhjetor 2000. Edhe pse ishte rezultat i një procesi të ri të rishikimit të traktateve, Traktati Kushtetues nuk ishte me më pak vlerë se traktatet e mëparshme, si Traktatet e Romës deri në Aktin Unik Europian, ose nga Traktati i Mastrihtit deri në traktatin e Amsterdamit dhe Traktatit të Nicës të cilat i kishin paraprirë më parë.

Sidoqoftë, emërtimi i këtij traktati i referohej një kushtetute dhe përmbante simbole të shtetësisë - siç janë hymni , flamuri dhe moton - e cila sigurisht ndikoj duke ngacmuar euroskeptikët të cilët me kritikat e tyre shprehën frikën se procesi i integrimit europian mund të sillte krijimin e një shteti , apo edhe të një shteti federal.

Emërtimi i një traktati " Një Kushtetutë për Europën" a mund të sillte në fakt krijimin e BE-së si një shtet? Sigurisht që nuk do të sillte këtë. Gjykata Europiane e Drejtësisë e kishte bërë këtë gati njëzet vite më parë dhe askush nuk kishte reaguar negativisht ndaj këtij emërtimi. BE-ja nuk është një shtet, dhe nuk përpiqej të hiqte sovranitetin e shteteve anëtare të saj, e si pasojë nuk mund të themi se ekzistonte mundësia që ky traktat të krijonte një shtet.

Fakti që BE-ja rrjedh nga vullneti i shteteve anëtare do të shprehej në traktat, lidhja midis Bashkimit Europian dhe shteteve të saj anëtare do të përcaktohej më qartë se

[1] Piris,J.(2006) *The Constitution for Europe:A legal analysis.* Shtypi i Universitetit të Cambridge.

kurrë më parë, gjithësesi emërtimi pati ndikimin e tij që me sa duket ishte i tepërt dhe mbase kontribuoi në refuzimin e këtij traktati.

Kështu, me Traktatin e Lisbonës, shtetet anëtare u kthyen në qasjen klasike të rishikimit të Traktatit. Pavarësisht nga fakti se ai kurrë nuk hyri në fuqi, Traktati Kushtetues duhet të dallohet, si një përpjekje e vërtetë për të mbështetur një Bashkim Europian të zgjeruar me një strukturë të thjeshtuar dhe procedura më të thjeshta, si dhe institucionet parashikonin për ta bërë atë funksional në një mënyrë më efikase, duke iu përgjigjur kështu Deklaratës së Nicës dhe mandatit të Këshillit Europian të Laeken.[2]

Në veçanti, Traktati Kushtetues [3] kishte arritur të:

- përmbledhë ligjet ekzistuese (që kanë në përmbajtje rreth 3,000 faqe nga njëzet traktate të ndryshme ) në një dokument të vetëm prej 448 artikujsh (që arrijnë deri në 200 faqe, ose dyfish, me protokollet), duke shfuqizuar traktatet bazë ekzistuese, si dhe traktatet që kishin përfshirë ndryshimet e tyre ndër vite; ky ishte një ndryshim i madh dhe një ndihmesë e konsiderueshme; aq më tepër nëse merret parasysh që gjashtëdhjetë nenet e para të Traktatit Kushtetues tashmë kanë parashikuar një pamje të përgjithshme të objektivave dhe instrumentave të BE-së ;

- përcaktojë qartë për herë të parë sistemin e kompetencave ("kush bën çfarë") në BE;

- rishikojë kornizën institucionale të BE-së për ta bërë atë më demokratike dhe më efikase; dhe thjeshton tipologjinë e instrumenteve juridike dhe llojet e ndryshme të procedurave të vendimmarrjes që ishin në dispozicion;

- ndryshojë konceptin/strukturën e shtyllës, duke i dhënë një entitet të vetëm Bashkimit Europian.

Konferenca Ndërqeveritare e cila hartoi Traktatin e Lisbonës, përgatiti draftin gjatë gjithë semestrit të parë të 2007, duke çuar në adaptimin e mandatit të Konferencës Ndërqeveritare nga Këshilli Europian në Qershor 2007. Presidenca gjermane dha një

---

[2] Presidency Conclusions: European Council meeting in Laeken 14 and 15 December 2001, marrë nga https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/DOC_01_18.

[3] Traktati Kushtetues (i pa ratifikuar), marrë nga https://europa.eu/scadplus/constitution/introduction_en.htm

kontribut vendimtar për suksesin e këtij traktati, që u favorizua edhe nga rrethanat politike që u shfaqën në vitin 2006, pas "periudhës së reflektimit".

Synohej për të patur një traktat të ri në fuqi para zgjedhjeve të ardhshme të Parlamentit Europian, të planifikuar për në Qershor 2009.

Kjo u pasqyrua në "Deklaratën e Berlinit me rastin e pesëdhjetëvjetorit të nënshkrimit të Traktateve të Romës" të 25 Marsit 2007. U parashikua që të paturit një traktat të ri në fuqi nga zgjedhjet e ardhshme të Parlamentit Europian mund të ringjallte interesin e qytetarëve për Bashkimin Europian dhe të rriste pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e Parlamentit Europian, një pjesëmarrje e cila kishte ardhur gjithmonë në rënie që nga zgjedhjet e para që u mbajtën me anë të votimit të drejtpërdrejtë në vitin 1979.

Mendohej që patja e diskutimeve dhe negociatave mbi një traktat të ri të mbyllur para zgjedhjeve të Parlamentit Europian në 2009 do të shmangte çdo rrezik të mbivendosjes midis diskutimeve "kushtetuese" dhe debatit politik mbi "rishikimin afatmesëm" të pikëpamjeve financiare që duhej të zhvillohej në 2008 / 2009. Ishte e qartë për të gjithë që koha ishte shumë e shkurtër dhe një traktat i ri në fuqi 2009 mund të arrihej vetëm nëse nënshkrimi i tij arrihej brenda 2007.

Që në javët e para të vitit 2007, përgatitja, dhe më pas përshtatja e Deklaratës së Berlinit kishte treguar vendosmërinë e presidencës gjermane, dhe interesimin personal të kancelares së vendit Angela Merkel (që gëzon këtë pozicion që prej vitit 2005) drejt arritjes së rezultateve konkrete. Presidenca pati një objektiv të dyfishtë: jo vetëm fillimet e bisedimeve për arritjen e një marrëveshjeje për të hartuar një traktat të ri, por edhe detajimi sa më shumë të ishte e mundur mbi specifikimet e nevojshme në mënyrë që të minimizohej rreziku i rihapjes së diskutimeve dhe nënshkrimi i traktatit të ri sa më shpejtë që të ishte e mundur.

Rezultati i kësaj përpjekje ishte mandati, i miratuar nga Këshilli Europian gjatë orëve të para të 23 Qershorit 2007 [4] i cili çoi në hapjen zyrtare të Konferencës Ndërqeveritare një muaj më vonë, në 23 Korrik 2007, me detyrën ë përcaktuar për hartimin e traktatit të ndryshuar, nga grupi i ekspertëve juridikë midis fundit të Korrikut dhe ditëve të para të Tetorit 2007. Më pas do t'i lihej drejtuesve të shteteve dhe/ose qeverisë, duke u

[4] Këshilli i BE-së, shënimi 14, në aneksin nr.I. Marrë nga https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A12012E%2FTXT

takuar në Lisbonë në 18 dhe 19 Tetor, për të zgjidhur çështjet e pazgjidhura dhe t'i hapin rrugën nënshkrimit të Traktatit të Lisbonës më 13 Dhjetor 2007.[5]

Konferenca Ndërqeveritare që çoi në nënshkrimin e Traktatit të Lisbonës ishte një nga më të shkurtrat në historinë e procesit të integrimit europian. Duhej të ishte e shkurtër, duke pasur parasysh kontekstin tepër delikat në të cilin ndodhi , dhe duke pasur parasysh nevojën për të shfrytëzuar "dritaren e mundësive" politike, e cila kishte hapur.

Por mundi të ishte shpejtë në kohë vetëm falë përgatitjes së plotë, e cila ishte kryer nga presidenca gjermane, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm dhe në mënyrë të veçantë, të Këshilltarit Ligjor të Këshillit, Jean-Claude Piris, autor të cilin e kam cituar disa herë në punimin tim, duke i njohur kontributin e madh në këtë fushë.

Kurrë nuk kishte kaluar një mandat i Konferencës Ndërqeveritare në një nivel kaq të detajuar, duke u mbështetur në gjashtëmbëdhjetë faqe dhe duke përfshirë tekste ligjore të hartuara plotësisht. Asnjëherë më parë negociatat e Konferencës Ndërqeveritare për rishikimin e Traktatit ishin përcjellur dhe mbyllur me sukses në një periudhë kaq të shkurtër kohore.

Sikurse dhe traktatet e mëparshëm, dhe Traktati i Lisbonës mbështeti traktatet e mëparshme të cilat mbetën në fuqi duke u përpjekur të realizojnë përshtatjen e tyre sipas këtij traktati të ri. Traktikani i Lisbonës[6] përmban dy nene , plus dispozitat e zakonshme përfundimtare.

Neni 1 ndryshon në 61 pika Traktatin për Bashkimin Europian, ndërsa neni 2 ndryshon në 295 pika Traktatin për krijimin e Komunitetit Europian, i riemëruar "Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian". Parashikohej që të dy traktatet të kishin të njëjtën vlerë ligjore, Bashkimi Europian të kishte sukses dhe të zëvendësohej Komuniteti Europian, duke krijuar kështu një entitet të vetëm juridik.

Ndoshta Traktati i Lisbonës duhet të konsiderohet më i lexueshëm se traktatet e mëparshme ndryshuese, si me Traktatet e BE-së dhe KE-së dhe me Traktatin Kushtetues , nga të cilat kryesisht merr substancën. Leximi është më i lehtë dhe

[5] Këshilli i BE-së, Procedurat e Konferencës Ndërqeveritare (IGC) që çuan në nënshkrimin e Traktatit të Lisbonës. Marrë nga https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/5/the-treaty-of-lisbon

[6] Traktati i Lisbonës , Lisbonë (Portugali) 13 Dhjetor 2007.

përmban një version më të konsoliduar të traktateve, duke e konsideruar këtë si një ndihmesë të madhe për të gjithë aktorët e përfshirë.

*Përmbajtja e përgjithshme e Traktatit të Lisbonës*

Në thelb, ndryshimet kryesore që Traktati i Lisbonës prezantoi, pasi të ratifikimit kanë të bëjnë me strukturën dhe institucionet e BE; ato korrespondojnë me një në masë të madhe për ndryshimet për të cilat janë rënë dakord në 2004.

Në të vërtetë, nëse simbolet kushtetuese do të liheshin mënjanë, do të kuptonim se thelbi i Traktatit Kushtetues është ruajtur . Por Traktati i Lisbonës përfaqëson pikën e ekuilibrit: mes vendeve anëtare të cilat e ratifikuan Traktatin Kushtetues dhe kishin besim në vlerat e tij (ku sigurisht do të dëshironin që përmbajtja e tij të mos ndryshonte) dhe vendeve të tjera anëtare të cilat vendosën të kërkojnë dhe të marrin parasysh mendimin e qytetarëve të tyre (këto vende do të ishin të kënaqura me cilindo ndryshim që do të arrihej për t'ju larguar ngjyrimeve kushtetuese që përmbante traktati i mëparshëm).

Një vëmendje e veçantë iu kushtua përgatitjes së tekstit të traktatit dhe mandatit të Konferencës Ndërqeveritare për t'iu përgjigjur shqetësimeve të fundit, duke marrë parasysh që risitë kryesore të vitit 2004 do të ruheshin.

Përkatësisht mandati i Konferencës Ndërqeveritare[7]:

- Shprehej që në rreshtat e parë, se "[koncepti kushtetues ... është braktisur;" dhe duke specifikuar disa rreshta më poshtë (me siguri për të shuar çdo keqkuptim të mundshm), që Traktati i Bashkimit Europian dhe Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian nuk do të kenë karakter kushtetues.

- Karakteri kushtetues nga ana tjetër, tregoi qartë se inovacionet që rrjedhin nga Konferenca Ndërqeveritare 2004 do të futeshin në Traktatet ekzistuese, të cilat mbeten në fuqi, në përputhje me teknikën e zakonshme të amendimit.

Duke patur parasysh përmbajtjen e Traktatit Kushtetues, Traktati i Lisbonës hoqi dorë nga simbolet kushtetuese. Ndërsa traktatet e amenduara nga Traktati i Lisbonës[8]:

---

[7] IGC Mandate 2007. Marrë nga https://publications.parliament.uk/pa/cm200708/cmselect/cmfaff/120/12005.htm

[8] Traktati i Lisbonës , Lisbonë (Portugali) 13 Dhjetor 2007.

- nuk do të përmbanin asnjë terminologji që i referohej me emërtimin “kushtetutë”,nuk do të përdorej as vetë termi dhe as emërtimet "ligj" dhe "kornizë ligjore" ,madje as termi Ministri i Punëve të Jashtme të BE-së (i zëvendësuar nga: Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë );

-nuk do të përmendeshin simbolet e BE-së; flamuri, himni, moto, monedhën dhe Dita e Europës -ashtu sikurse ato ishin parashtuar dhe paraqitur në nenin I-8 të Traktatit Kushtetues; sidoqoftë mbetet i paqartë fakti se simbolet vazhduan dhe ende vazhdojnë të përdoren .

- nuk do të përfshinte asnjë dispozitë që pohon - siç bënte neni I-6 i Traktatit Kushtetues - se ligji i Be-së do të ketë epërsi mbi ligjin e shteteve anëtare;

- nuk do të rishkruante Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian të miratuar më 7 Dhjetor 2000;

Sa i përket përmbajtjes, traktatet e ndryshuara nga Traktati i Lisbonës do të sillnin ndryshime të mëdha të cilat të ishin parashikuar brenda Traktatit Kushtetues në 2004. Duke prekur kryesisht ndryshimet në lidhje me institucionet dhe politikat kryesore, sikurse i kam shpjeguar në vazhdimësi te punimit tim si nën-kapituj pasues.

Në lidhje me sistemin institucional, Traktati i Lisbonës siguroi:

- një përbërje të re (numri i eurodeputetëve që nuk duhet të kalojë 751, përfshirë dhe Presidentin) dhe kompetenca më të mëdha për Parlamentin Europian , që vinin si pasoja të zgjerimit të fushë-veprimit mbi procedurat e reja të cilat kërkonin vendimarrje të përbashkët me institucione të tjera, por dhe nga futja e një procedure të re buxhetore, ku Parlamenti do të bashkëvepronte me Këshillin në lidhje me buxhetin;

- shndërrimin e Këshillit Europian në një institucion dhe krijimin e postit të Presidentit, për tu zgjedhur për një mandat dy vjet e gjysëm;

- sistemi i votimit për Këshillin me një shumicë të cilësuar (shteti dhe popullsia),

- një Komision i cili prej 1 Nëntorit 2014, do të përbëhej nga një numër anëtarësh që korrespondojnë me dy të tretat e numrit të shteteve anëtare; dhe rol më të fortë të Presidentit të tij;

- krijimi i zyrës së Përfaqësuesit të Lartë të BE-së  për Punët e Jashtme dhe Politikat mbi Sigurinë, që do të kishte rol të dyfishtë: atë të Kryetarit të Këshillit të Punëve të Jashtme dhe Zëvendëskryetarit të Komisionit;

- Kryesia e Këshillit, që do të mbahej nga grupe të paracaktuara të tre shteteve anëtare, me një rotacion të barabartë, për një periudhë tetëmbëdhjetë mujore.

Përfundimisht, roli i parlamenteve kombëtare është theksuar dhe përmirësuar nga Traktati i Lisbonës.

Në veçanti, parlamenteve vendase  do t'i jepej e drejta për të vlerësuar një projektligj, procedurë e cila mund të sillte dhe bllokimin ose anullimin e ligjit në fjalë. Pra parlamentet vendase nuk u prekën në rolin e tyre brenda shtetit.

Në përfundim të kësaj pjese duhet të theksojmë se të dy traktatet përmbajnë elementë të "forcës"  me qëllim për t'i bërë veprimet e BE-së  më efektive në fushat që prekin çështjet  e mjedisit, ndryshimit të klimës e energjisë, dhe  politikave sociale.

**I.B. Ndryshimet institucionale si pasojë e këtij Traktati**

Traktati i Lisbonës solli ndryshime edhe në aspektin e organizimit të një pjese të konsiderueshme të instutucioneve, sikurse dhe formalizoi një pjesë të tyre.

Institucionet kryesore të cilat mund të përmenden janë si më poshtë:

- Parlamenti Europian,
- Këshilli Europian,
- Këshilli i Bashkimit Europian,
- Gjykata e të Drejtave të Bashkimit Europian,
- Banka Qendrore Europiane,
- Gjykata Revizorëve,
- Komisioni Europian.

Gjithashtu duhet të përmendim edhe trupa të tjerë që veprojnë brenda BE-së :

- Komiteti i Rajoneve,
- Komiteti Europian Ekonomiko-Social,
- Banka Europiane mbi Investimet.

Parlamenti Europian

Ky institucion përfaqëson qytetarët e shteteve anëtare dhe zgjidhet drejtëpërsëdrejti nga to.

Sipas Traktatit të Lisbonës ky institucion përfshihet edhe në krijimin e ligjeve në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave , sikurse merr dhe fuqi të shtuar në aspektin buxhetor. Pra fuqia legjislative dhe fuqia mbi miratimin e buxhetit të BE-së, janë dy pika të rëndësishme që i shtohen këtij institucioni.

Bashkëpunimi mes këtyre dy institucioneve është konsideruar bashkë-vendim, i cili shtrihet dhe në fusha të reja sikurse janë liria, drejtësia dhe siguria.

Këshilli Europian

Ky institucion përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur politikë të shteteve anëtare që kanë eksperiencë .

Ky institucion përpiqet ti japë Bashkimit Europian drejtimin politik dhe prioritetet që duhen zbatuar.

Shtetet anëtare të cilat mbajnë presidencën e BE-së për një periudhë 6 mujore, po ashtu drejtojnë edhe Këshillin Europian.

Pas Traktatit të Lisbonës , Këshilli Europian merr fuqi , dhe tashmë ka rol të percaktuar qartë. Sikurse kemi dhe mirëpërcaktim të rolit të Presidentit të Keshillit Europian, i cili zgjidhet me një mandat 5 vjeçar nga anëtarët e Keshillit Europian. Presidenti i Këshillit Europian ndjek punën e këtij Këshilli, drejton mbledhjet e tij dhe përfaqëson në nivele ndërkombëtare Bashkimin Europian. Gjithashtu ka për detyrë që të bëjë veprimet e ndërmarra nga BE-ja më transparente dhe më të sigurta.

Këshilli i Bashkimit Europian

Ky institucion njihet ndryshe dhe si Këshilli i Ministrave, i cili përbëhet nga ministrat e qeverive të 27 shteteve anëtare. Është një organ vendimarrës i cili ka rol kryesorë në politikën e huaj dhe politikat mbi sigurinë, sikurse dhe koordinon politikat ekonomike.

Sikurse e kam përmendur dhe më lartë ky institucion bashkëvepron ngushtë me Parlamentin Europian në aspektin ligjor dhe buxhetor.

Tashmë nuk kërkohet një votim unanim por një votim prej shumicës, për politikat e propozuara.

Në 2014 , u përdor sistemi i njohur me emërtimin mazhorancë e dyfishtë, sipas të cilit vendimet e marra prej Këshillit duhet të kenë miratimin e 55 % të shteteve anëtare (të cilat përfaqësojnë në fakt 65 % të popullatës europiane). Duke bërë që vendimet të kenë legjitimitet të dyfishtë.

Gjithashtu në vazhdimësinë e Traktatit të Lisbonës, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Europian mbi Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë- ZV.Presidenti i Komisionit , drejtohet nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm, përsa do të shpjegohet më poshtë.

Në fushat e tjera si : financat, bujqësia, energjitika, udhëheqja e Këshillit do të vazhdojnë të mbeten nën drejtimin e ministrit që mban rotacionin 6 mujor të Presidencës, duke bërë kështu presidencën e BE-së më të qëndrueshme dhe efiçente.

Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Europian mbi Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë- ZV.Presidenti i Komisionit

Pjesë e zhvillimeve dhe ndryshimeve që solli Traktati i Lisbonës, ishte dhe krijimi i një pozicionimi të ri të udhëheqjes së përbashkët të Bashkimit Europian mbi çështjet që lidhen me punët e jashtme politikat e përbashkëta të mbrojtjes dhe politikat e sigurisë.

Një hap shumë i rëndësishëm është dhe emërtimi i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Europian mbi Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë, i cili njëkohësisht mban dhe pozicionin e zëvendës Presidentit të Komisionit. Ky post i ri është bashkimi i dy posteve të tjera të mëparshme: Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të përbashkët të Punëve të Jashtme dhe Sigurisë, dhe Komisioneri për Marrëdhëniet me Jashtë.

Drejtuesi i këtij posti emërohet nga Këshilli Europian , i cili drejton me Këshillin e Ministrave të Punëve të Jashme dhe po në të njëjtën kohë mban pozicionin e Zëvendës Presidentit të Komisionit Europian. Drejtuesi i këtij posti bën propozime , zbaton politikën e jashtme sipas orientimeve dhe linjave të Këshillit , sikurse dhe përfaqëson mendimet dhe qëndrimet e BE-së në nivele të larta ndërkombëtare.

Ky post ka një peshë shumë të madhe në ndihmën që i jep BE-së për mbrojtjen e vlerave dhe interesave të saj të shprehura unanimisht , në arenën ndërkombëtare.

Komisioni Europian

Ky institucion është një organ i pavarur prej qeverive të vendeve anëtare, i cili përgjigjet para Parlamentit Europian dhe synon që të pëqrfaqësojë interesat e BE-së si një organ i vetëm.

Ky Komision i jep fuqi politikave të Bashkimit Europian, siguron mënyrën se si implementohet buxheti, merret me mbarëvajtjen e programeve të BE-së, përfaqëson në proceset e negocimeve BE-në, dhe konsiderohet si institucioni që mbron traktatet duke u siguruar për mbarëvajtjen dhe monitorimin e zbatueshmërisë së dispozitave të traktateve në fuqi.

Gjykata e të Drejtave të Bashkimit Europian

Ky institucion është themeluar herët (1952), duke patur si kompetencë që të drejtat të interpretohen dhe zbatohen në mënyrë të drejtë dhe të unifikuar në të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

Gjykata është e përbërë nga një gjykatës i çdo shteti anëtar, dhe kanë secili në varësi tetë avokatë publik. Qëllimi i këtij përfaqësimi është të sigurojë një pasqyrim të të gjithë sistemeve juridike shtetërore, në trajtimet e çështjeve të paraqitura (Çështjet mund të jenë marrëdhënie juridike mes shteteve anëtare, instritucioneve të ndryshme të BE-së, subjekteve juridike dhe personave fizikë).

Gjykata mund të vendosi për të kontrolluar dhe gjykuar, nëse dispozitat e traktateve janë miratuar sipas procedurave përkatëse dhe nëse institucionet si Parlamenti Europian; Këshilli ose Komisioni i kanë zbatuar sikurse duhet funksionet e tyre. Ky është i vetmi institucion i cili me kërkesë të gjykatave vendase/kombëtare, mund të marrë vendime lidhur me interpretimet e marrëveshjeve dhe të së drejtës në vendet e Bashkimit Europian.

Gjykata Revizorëve

Ky institucion i cili gjithashtu i ka fillesat shumë herët (1977) kontrollon dhe monitoron nëse zërat e buxhetit ( të hyrat dhe të dalat) të Bashkimit Europian, janë menaxhuar drejtë dhe nëse shpenzimet janë bërë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Një funksion tjetër shumë i rëndësishëm është ndihma në aspektin buxhetor që Gjykata e Revizorëve mund t'i japi Parlamentit Europian dhe Këshillit , duke i paraqitur një raport informues për çdo vit fiskal, në mënyrë që këto institucione të jenë në dijeni mbi raportet e vlerësimit të çdo situate.

Po ashtu jep mendimin mbi miratimin e normativave financiare që propozohen nga institucionet e tjera përgjegjëse të Bashkimit Europian.

Kjo gjykatë përbëhet nga: një përfaqësues të secilit shtet anëtar me kohëzgjatje mandati 6 vjeçar, të cilët më pas zgjedhin kryetarin e tyre me një mandat 3 vjeçar.

Banka Qëndrore Europiane

Ky institucion është përgjegjës për përcaktimin, implementimin dhe menaxhimin e politikave monetare të Bashkimit Europian dhe Eurozonës. Qëllimi kryesor i këtij institucioni është ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe mbështetja e politikave ekonomike të Bashkimit Europian; menaxhimi i rezervave devizore të vendeve të eurozonës dhe promovimi i funksionimit të sistemit të pagave.

Komiteti i Rajoneve

Është krijuar në vitin 1944 në bazë të Marrëveshjes mbi Bashkimin Europian, dhe është një trup këshillues që përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve lokale dhe të autoriteteve rajonale të propozuara nga vendet anëtare, ndërsa i emëron Keshilli me një mandat 4 vjeçar, të cilët më pas zgjedhin dhe kryetarin e tyre me një mandat 2 vjeçar. Pavarësisht se anëtarët e këtij Komiteti propozohen nga qeveritë e BE-së, puna e tyre është e pavarur politikisht.

Roli i këtij Komiteti është që të paraqesë dhe propozojë qëndrimet / mendimet e autoriteteve lokale dhe rajonale në lidhje me legjislacionin e BE-së. Komiteti i Rajoneve çdo vit organizon dhe mban sesione plenare në të cilat miratohen/analizohen mendimet dhe definohen politikat e përgjithshme.

Gjithashtu me rëndësi është fakti se anëtarët e Komiteteve ndahen në komisione të veçanta nga sfera e politikave territoriale; politikave ekonomike dhe sociale; kulturës dhe arsimit; zhvillimit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm; administrimit në BE dhe politikave të jashtme etj.

Komiteti Europian Ekonomiko-Social

Është krijuar në vitin 1957 në bazë të marrëveshjes së Romës, dhe ka rolin e një trupe këshilluese ku përfaqëson punëdhënësit, konsumatorët, sindikatat, fermerët dhe grupe të tjera të cilët përbëjnë shoqërinë qytetare të organizuar. Ky Komitet mbron interesat e grupeve të përmendura më sipër , në raport me Komisionin Europian, Këshillit dhe Parlamentit Europian. Qëllimi  është bashkëveprimi  i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm ndërmjet BE-së dhe qytetarëve të tij, duke rritur pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre.

Ky komitet është pjesë përbërëse në procesin e vendimarrjes, i cili duhet të konsultohet përpara marrjes së vendimeve që kryesisht kanë karakter ekonomik dhe social.

Anëtarët e Komitet  janë të propozuar nga qeveritë e vendeve të BE-së, por kanë pavarësi të plotë politike. Kanë mandat 4 vjeçar, dhe mund të rizgjidhen, ndërsa kryetarin  dhe nënkryetarin e zgjedhin  vetë çdo dy vjet.

Në përbërje ka gjithashtu nënkomitete,seksione etj.

Banka Europiane mbi Investimet

Është themeluar në vitin 1958 me Marrëveshjen e Romës, dhe ka si mision të saj investimin në projekte që mbështesin dhe promovojnë qëllimet e Bashkimit Europian. Këtë e bëjnë nëpërmjet financimit të projekteve, zhvillimit të rajoneve të caktuara, stimulimin  e konkurencës së bizneseve të vogla.

Nxitja e eurointegrimit, zhvillim i qëndrueshëm dhe i  balancuar, ekonomia inovative dhe kohezioni ekonomiko social, janë disa nga projektet e përzgjedhura.

Banka nuk siguron përfitim dhe nuk ka matje të depozitimeve të kursyera ose llogarive rrjedhëse, ajo financohet nga huatë qe kryhen në tregjet financiare dhe nëpërmjet aksionerëve të Bankës (vendeve anëtare të BE-së) të cilat konsiderohen si  pronarë të përbashkët të kapitalit të saj, ku dhe kontributi i çdo vendi reflekton fuqinë ekonomike që ka.

Vendimet e Bankës  miratohen nga  Këshilli i Guvernatorëve, Këshilli Drejtues  dhe Komiteti i Udhëheqjes. Gjithashtu Banka ka bashkëpunim me institucionet e tjera të BE-së, ku përfaqësues të saj mund të jenë pjesëmarrës në komitetet e ndryshme të Parlamentit Europian, ndërsa kryetari i Bankës mund të jetë pjesëmarrës në mbledhjet e Këshillit.

***Traktati i Lisbonës bën të qartë :***

- ***Cilat fuqi janë të Bashkimit Europian***
- ***Cilat fuqi janë të shteteve anëtare***
- ***Cilat fuqi janë të përbashkëta***

***Pas këtij traktati këto fuqi janë të përcaktuara qartazi, ndryshe nga më parë.***

***Bashkimi Europian mund të ushtrojë vetëm ato fuqi të cilat i janë transferuar me konsensus nga shtetet anëtare, dhe të respektojë të gjitha fuqitë që i përkasin atyre.***

***Përgjegjësia ekskluzive e BE-së shtrihet në fushat si : procedurat dhe rregullat mbi konkurencën,politikat monetare të eurozonës, dhe politikat e përbashkëta tregtare.***

***Ndërsa shtetet anëtare kanë përgjegjësi parësore mbi fushat si : arsimi ,shëndetësia dhe industria.***

***Fushat ku BE-ja dhe Shtetet Anëtare ndajnë kompetencat janë: tregu i brendshëm ,transporti, energjia dhe bujqësia.***




**Tabela 2 –** Skemë mbi procedurat e zakonshme legjislative, marrë nga *Udhëzuesi për Institucionet e BE-së:Si funksionon BE*.

## I.C. Sfidat dhe mosmarrëveshjet mbi miratimin e Traktatit të Lisbonës

Pasi votuesit irlandezë kundërshtuan Traktatin e Lisbonës në një referendum publik më 12 Qershor 2008, udhëheqësit e Bashkimit Europian vendosën megjithatë të vazhdojnë procesin e ratifikimit, me qëllim që të arrinin 26 ratifikimeve nga mesi i Tetorit 2008. Por ky plan dështoi për arsye të një sërë problematikash politike dhe juridike që u shfaqën në disa vende. Përveç refuzimit të saj në Irlandë, ratifikimi i Traktatit të Lisbonës u kontestua në Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë e u përball me disa sfida politike në Republikën Çeke dhe në Poloni.

Në këtë nënkapitull synoj të shpjegoj disa prej sfidave dhe mosmarrëveshjeve të procesit të ratifikimit dhe debatet kombëtare në të katër vendet ku e ardhmja e traktatit u rrezikua : Irlanda, Gjermania, Republika Çeke , Polonia dhe Britania e Madhe.

Traktati i Lisbonës u nënshkrua në 13 Dhjetor 2007 dhe parashikohej të hynte në fuqi më 1 Janar 2009. Ky ishte një synim sikurse dhe shumë ekspertë të BE-së kanë analizuar, shumë ambiciz. I vetmi traktat që është ratifikuar në një kohë të shkurtër ( më pak se 13 muaj) është Traktati i Romës më 1957, po në këtë kohë kërkohej miratimi i 6 vendeve, ndërkohë që tashmë kërkohej miratimi i 27 vendeve anëtare.

Procesi i ratifikimit vazhdoi i qetë deri tek referendumi irlandez i mbajtur më 12 Qershor 2008. Rezultati negativ i votimit në këtë referendum vuri në rrezik traktatin dhe nuk mundi të hynte në fuqi në kohën e parashikuar. Data e parashikuar për hyrjen në fuqi të tij 1 Janar 2009, ishte e pamundur të arrihej sidomos pas mbledhjes së Këshillit Europian më 19-20 Qershor 2008. Në këtë takim u shpreh qartë vendimi për të shmangur pezullimin e procesit të ratifikimit të Traktatit të Lisbonës sikurse kishte ndodhur me Traktatin Kushtetues. Mbledhja e Këshillit Europian e zhvilluar në Qershor 2008 shpëtoi Traktatin e Lisbonës nga ky fat, pasi të gjitha vendet konfirmuan vullnetin për të ndjekur procesin në kohën e duhur. Ideja fillestare e liderëve europianë ishte t'i lejonin Irlandës kohën që i duhej të reflektonte në rezultatin e saj të referendumit, me qëllim që të merrte vendimet e duhura deri në mbledhjen e ardhme të Këshillit Europian që do të mbahej në Tetor. Pritshmëritë e KE-së ishin që deri në këtë takim 26 shtetet e tjera anëtare të kishin përfunduar ratifikimin në vendet e tyre dhe e gjithë vëmendja të përqendrohej tek Irlanda.

Por ky planifikim , nuk shkoi sikurse mendohej. Perveç Irlandës edhe vende të tjera filluan të shfaqnin problematika ligjore ose politike . Suedia nuk pranoi të shpejtojë ratifikimin në Riksdag (Organi Suprem Ligjvënës), duke pretenduar se ky organ kërkon kohën e duhur për aprovimin e dokumentit. Disa sfida ligjore u shfaqën në Gjermani dhe Republikën Çeke . Po ashtu sfida për metodën e ratifikimit të tij u shfaqën dhe në Britaninë e Madhe. Sfidat e një natyre politike u shfaqën gjithashtu në Poloni dhe Republikën Çeke, presidentët e të cilëve për arsye të ndryshme kundërshtuan ratifikimin e shpejtë gjatë verës.

Republika Çeke

Të dy ndarjet e parlamentit Çekë (Dhoma e Deputetëve dhe Senati) ratifikuan traktatin, në Shkurt dhe Maj 2009. Sidoqoftë, Presidenti Václav Klaus ishte kundër ratifikimit të Traktatit të Lisbonës në atë kohë. Ai bëri thirrje që procesi të përfundohej dhe deklaroi se ai nuk kishte nxitim që të ratifikonte dokumentin [9]. Në Shtator 2008, ai kishte deklaruar gjithashtu se nuk do ta nënshkruante traktatin derisa Irlanda ta kishte ratifikuar atë.

Para kësaj, Presidenti Klaus deklaroi se ishte në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me një ankesë të paraqitur nga senatorët kundër disa pjesëve të traktatit. Gjykata e hodhi poshtë këtë ankesë në 26 Nëntor 2008. Më pas , senatorët vazhduan të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që të vlerësojë traktatin në tërësi. Më 29 Shtator 2009 një grup senatorësh paraqitën një ankesë të re në Gjykatën Kushtetuese. Sipas kushtetutës Çeke, traktati nuk mund të ratifikohet derisa të merret një vendim nga Gjykata Kushtetuese[10].

Përveç sfidës kushtetuese, presidenti Klaus, pavarësisht miratimit të traktatit nga parlamenti , kërkoi që të hiqej dorë nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian. Ai u shpreh se dhënia fuqi e kësaj karte do të binte në kundërshtim dhe do të “dekretet e Beneš ”, dhe në veçanti dekretin që konfiskoi, pa dhënë kompensim, pronat e gjermanëve dhe hungarezëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këto dekrete janë ende pjesë e ligjit të brendshëm të Republikës Çeke dhe Sllovakisë . Presidenti Klaus tha që

[9] "EU treaty clears Czech parliament". Marrë nga http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/8035191.stm

[10] Kushtetuta e Republikës Çeke , neni 87 pika 2.

heqja dorë nga kjo kartë është një kusht i domosdoshëm që ai të nënshkruajë dokumentin e ratifikimit të Traktatit të Lisbonës. Në 2002, Komisioni i BE-së kërkoi një mendim juridik mbi pajtueshmërinë e dekreteve me traktatet e BE-së. Në parim u argumentua se, po të ishin miratuar dekretet Beneš sot, ata do të shkelnin traktatet e BE-së, por meqë ato u miratuan në 1945, statusi i tyre do të ishte i paprekur. Në lidhje me këtë temë u bë një deklaratë nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në mënyrë që të shpjegohej se: edhe nëse BE-ja, në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, njeh të drejtën e pronësisë si një të drejtë themelore, traktatet nuk mund të kenë një efekt prapaveprues:

Sipas mendimit të dhënë po nga kjo gjykatë është vërejtur gjithashtu se edhe nëse ato klauzola në lidhje me të drejtat e pronësisë do të ishin të zbatueshme, BE nuk do të kishte ndonjë fjalë për këtë pasi Traktati që themelon Komunitetin Europian shprehet në mënyrë të qartë (neni 295) që[11]:
Ky Traktat nuk do të paragjykojë në asnjë mënyrë klauzolat në Shtetet Anëtare që rregullojnë sistemin e pronësisë dhe pronave.
Kjo klauzolë është riformuluar në Traktatin i Lisbonës në mënyrë që ta referonin atë në traktatet e mëparshme.

Në 2 Tetor 2009, Irlanda votoi pro për traktatin në referendumin e dytë, duke hequr një nga kundërshtimet e mëparshme të Klaus-it ndaj tij. Më pas Presidenti u shpeh se do të priste vendimin e Gjykatës Kushtetuese Çeke , në lidhje me: se sa i përputhshëm ishte ky traktat me Kushtetutën Çeke .Më 3 Nëntor 2009, Gjykata Kushtetuese Çeke miratoi traktatin, duke hapur rrugën që Presidenti Klaus ta nënshkruajë atë. Ratifikimi i Traktatit të Lisbonës, në Republikën Çeke u bë më 13 Nëntor 2009.

Gjermania

Gjermania ratifikoi Traktatin e Lisbonës në Shtator 2009 pasi e kishte lënë pezull për 15 muaj. Bundestag dhe Bundesrat kishin miratuan Traktatin e Lisbonës më 24 Prill dhe 23 Maj 2008, dhe Presidenti gjerman nënshkroi projektligjin e ratifikimit disa muaj më vonë. Sidoqoftë, për ratifikimin kërkohej një nënshkrim tjetër nga Presidenti, proces i cili u mbajt në pritje të një vendimi nga Gjykata Kushtetuese mbi pajtueshmërinë e

[11] Traktati i Romës, Romë (Itali) 25 Mars 1957 , neni 295. Marrë nga https://eur-lex.europa.eu/legal-content/IT/TXT/PDF/?uri=CELEX:11957E/TXT&from=EN

traktatit me kushtetutën e Gjermanisë. Kjo pasoi një sfidë të nisur nga anëtari gjerman i Bundestagut Peter Gauweiler, i cili pohoi se traktati ishte antikushtetues. Peter Gauweiler kishte patur një sfidë të ngjashme me Traktatin Kushtetues në vitin 2005.

Gjykata Kushtetuese zhvilloi seanca dëgjimore më 10 dhe 11 Shkurt 2009. Në vendimin e saj më 30 Qershor 2009, Gjykata deklaroi se ndërsa traktati ishte në përputhje me Ligjin Themelor, një statut shoqërues gjerman, që kishte të bënte me kompetencat e Parlamentit gjerman për të mbikëqyrur mënyrën se si qeveria gjermane votonte , i jepnin kompetenca të pamjaftueshme Parlamentit gjerman. Ratifikimi i traktatit do të kërkojë fuqi më të forta të mbikëqyrjes . Vendimi me 147 faqe përqëndrohej në strukturën e Bashkimit Europian sipas Traktatit të Lisbonës dhe marrëdhëniet e tij në raport me Ligjin Themelor. U arrit në përfundimin se traktati nuk krijonte një shtet federal europian (i cili do të zhvlerësonte Ligjin Themelor) dhe se përmbajtja e autoritetit shtetëror gjerman mbrohet. [12]

Bundestag mbajti një seancë të jashtëzakonshme më 26 Gusht 2009 për të shqyrtuar një projektligj për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare. Më 8 Shtator, projektligji u miratua me 446 vota pro, me 46 vota kundër dhe me 2 abstenime. Pasi Bundesrat dha miratimin e tij unanimisht më 18 Shtator, ligji u nënshkrua dhe hyri në fuqi nga Presidenti gjerman më 23 Shtator 2009 dhe u botua në gazetën zyrtare më 24 Shtator[13]. Presidenti nënshkroi dokumentin gjerman të ratifikimit të Traktatit të Lisbonës më 25 Shtator 2009.

Irlanda

Irlanda ratifikoi Traktatin e Lisbonës më 23 Tetor 2009, pavarësisht se rruga deri në këtë pikë ishte e gjatë. Fillimisht traktati u pa me dyshim nga Irlanda dhe në një referendum të mbajtur në Qershor 2008 u votua kundra miratimit të tij. Irlanda ishte i vetmi shtet anëtar që mbajti një referendum mbi traktatin dhe ky referendum fillestar ishte arsyeja kryesore pse traktati dështoi të hynte në fuqi më 1 Janar 2009 sikurse ishte

[12] "*German Federal Constitutional Court. (2009,Tetor) Act "Approving the Treaty of Lisbon compatible with the Basic Law". Marrë nga* https://web.archive.org/web/20091001215432/http://www.bundesverfassungsgericht.de/pressemitteilungen/bvg09-072en.html

[13] "Germany passes laws that pave the way for Lisbon Treaty". Marrë nga https://www.dw.com/en/germany-passes-laws-that-pave-the-way-for-lisbon-treaty/a-4702776

planifikuar. Një referendum i dytë u mbajt më 2 Tetor 2009 , dhe që solli më pas ratifikimin e tij.

*Arsyetimi që u përdor*

Të gjitha ndryshimet kushtetuese , sipas një vendimi të vitit 1987 në Irlandë kërkojnë miratimin me referendum. Si pasojë e këtij vendimi, Irlanda ka mbajtur referendum për çdo traktat të madh të Bashkimit Europian duke filluar që nga Akti Unik Europian. Vendimi nëse do të zhvillohet një referendum apo jo është çështje për qeverinë irlandeze, duke vepruar në bazë të këshillave të Prokurorit të Përgjithshëm. Do të rishikohej nga gjykatat , nëse do të kishte raste të një vendimi për të mos mbajtur një referendum .
Në Qershor 2007, edhe se traktati ishte akoma në formatin draft të tij , qeveria Irlandeze e kishte bërë të qartë që për miratimin e tij do të mbante një referendum .

*Referendumi i parë*

Në referendumin e parë, fushata pro Traktatit të Lisbonës u mbështet nga të gjithë anëtarët e tre partive qeveritare , ashtu si dhe të gjitha partitë e opozitës , me përjashtim të partisë Sinn Féin, ndërsa anëtarët e Partisë së Gjelbër nuk mbajtën një qëndrim të unifikuar në lidhje me këtë. Shumica e sindikatave irlandeze dhe organizatat e biznesit mbështetën fushatën pro traktatit .

Ndërsa fushata kundra traktatit u mbështet dhe drejtua nga partia politike republikane Sinn Féin, grupi lobues Libertas, Aleanca e Njerëzve përpara Përfitimit dhe Partia Socialiste

Rezultati i referendumit më 12 Qershor 2008 ishte kundra miratimit të traktatit . Rezultatet e votimit ishin 53.4% kundër traktatit dhe 46.6% në favor, në një pjesëmarrje prej 53.1% të popullsisë. Para këtij procesi votimi dhe shpalljes së rezultateve qeveria publikoi një analizë më të thelluar të hulumtimit mbi arsyet që kishin votuesit për të mbështetur ose jo traktatin , dhe u arrit në përfundimin se arsyeja kryesore e refuzimit të tij ishte mungesa e informacionit dhe kuptimi i drejtë i përmbajtjes së këtij traktati.

*Referendumi i dytë*

Në Korrik 2008 u shqaqën shenjat e para për të patur një rivotim në lidhje me Traktatin e Lisbonës. Afati i mandatit të Komisionit Europian aktual do të zgjatej derisa Traktati i Lisbonës të hynte në fuqi , vendet anëtare do të pranonin të mos zvogëlonin numrin e komisionerëve dhe Irlanda do të mbante një tjetër referendum në Shtator ose Tetor 2009 pasi të kishte marrë të gjitha garancitë mbi disa çështje që ishin delikate si taksimi, aborti dhe neutraliteti ushtarak. Më 12 Dhjetor 2008 kryeministri në detyrë i asaj kohe , Brian Cowen konfirmoi se do të mbahej një referendum i dytë, pas një samiti të krerëve të BE –së ku ishte dakortësuar mbi garancitë ligjore të çështeve që ishin kusht nga Irlanda. Ishte vendosur mbajtja e një komisioneri për një shtet anëtar dhe të përfshirja e garancive ligjore mbi abortin, taksimin dhe neutralitetin ushtarak. Referendumi i dytë mbi Traktatin e Lisbonës u mbajt më 2 Tetor 2009. Rezultati përfundimtar ishte 67.1% pro miratimit të traktati dhe 32.9% kundër, me pjesëmarrje prej 59% të popullsisë[14].

*Përfundimi i Ratifikimit*

Ndryshimi i amendamentit të 28-të të Kushtetutës Irlandeze, u nënshkrua nga Presidenti Mary McAleese më 15 Tetor 2009. Oireachtas( që përfaqëson pushtetin legjislativ në Irlandë dhe përbëhet nga presidenti i vendit dhe dy dhomat Dail Eireann dhe Seanad Eireann) vazhdoi me miratimin e ligjit për përfshirjen e traktatit në ligjin irlandez. Më 23 Tetor, Irlanda ratifikoi Traktatin e Lisbonës.

Polonia

Pak pas rezultatit të referendumit të parë të mbajtur në Irlandë në lidhje me Traktatin e Lisbonës, Presidenti polak Lech Kaczyński ishte shprehur se nuk do të kishte vlerë nënshkrimi i ratifikimit të traktatit nga ana e tij, nëse më parë nuk zgjidhej situata në Irlandë. Gjithsesi Presidenti më parë kishte nënshkruar një projekt-ligj parlamentar, që lejonte krijimin e mundësive për të realizuar procesin e ratifikimit nga Polonia. Pas votimit pro mbi traktatin të elektoratit irlandez në referendumin e dytë, Presidenti Kaczyński nënshkroi instrumentin e ratifikimit të Polonisë më 10 Tetor 2009. Instrumenti u paraqit në qeverinë italiane në Romë në 12 Tetor 2009.

[14] Rezultati referendumit të dytë mbi Traktatin e Lisbonës në Irlandë. Marrë nga https://web.archive.org/ëeb/20120503062721/http://www.referendum.ie/archive/display-ballotid%3D79%26page%3D0.php,

Britania e Madhe

Pavarësisht se Britania e Madhe e ratifikoi traktatin në Parlament , nuk mund të themi se ky proces nuk u shoqërua me sfida. Partia Laburiste e mbështeti traktatin ndërsa Partia Konservatore u shpreh kundra tij. Liberal Demokratët e mbështetën traktatin, dhe propozuan mbajtjen e një referendumi mbi anëtarësimin e Britanisë së madhe si një të tërë. Gjithashtu disa deputet Euroskeptik, kërkuan me insistim mbajtjen e një referendumi.

Deputeti i Partisë Konservatore , Daniel Hannan vuri në dukje se Kryeministri i asaj kohe Tony Blair , kishte premtuar mbajtjen e një referendum në lidhje me çështjen, deklaratë për të cilën Kryeministri u shreh se e kishte thënë këtë në lidhje me mbajtjen e një referendumi për Traktatin Kushtetues, dhe jo për Traktatin e Lisbonës, i cili nuk paraqitej si një traktat kushtetues.

Në fillim të Tetorit 2007, Komiteti i Kontrollit Europian i cili është një komitet në Dhomën e Komunëve, të Parlamentit të Britanisë së Madhe u shpreh se traktati i ri kishte në thelb të përmbajtjes së tij , traktatin e mëparshëm( Traktatin Kushtetues).

Në mes të Tetorit 2007, Bill Cash deputet i Partisë Konservatore paraqiti një mocion duke kërkuar një referendum mbi traktatin, ku kishte marrë 47 nënshkrime mbështetëse[15]. Në Janar 2008, një grup prej 20 deputetësh në pozitë të Partisë Laburiste (përfshirë ish ministrat, Kate Hoey dhe Frank Field) depozituan kërkesën për një ndryshim të projekt-ligjit të ratifikimit të traktatit duke pretenduar një referendum mbi traktatin. Ata theksuan se shumica e partive politike kishin premtuar në fushatën zgjedhore të 2005 mbajtjen e një referendumi .

Kryeministri James Gordon Brawn , i cili ishte në detyrë tashmë, refuzoi kërkesat për një referendum, me argumentimin se traktati kishte ndryshim të theksuar nga kushtetuta.

Gisela Stuar, deputete e Partisë Laburise , kërkoi marrjen e një sërë masash që do të bënin të mundur evitimin e një krize të legjitimitetit, si mbajtja e një referendumi mbi traktatin dhe që dokumenti përfunimtarë i ratifikimit të kalohej në të gjitha hallkat e parlamentit duke e trajtuar atë si një dokument shumë të rëndësishëm ligjor.

[15] Mbi mocionin për Traktatin e Lisbonës. Marrë nga: https://edm.parliament.uk/early-day-motion/34018

Gjithashtu Komiteti i Çështjeve të Jashme, hartoi një raport ku theksohej se qeveria Britanike po nënvlerësonte rolin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Çështjet e Jashtme dhe Politikave mbi Sigurinë edhe të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm.[16]

Në mundësinë e dytë që u krijua në dhomën e komunëve u votua në lidhje me Traktatin e Lisbonës ku u morën 362 pro dhe 224 vota kundra. Tre deputetë të Partisë Konservatore votuan në favor të traktatit , ndërsa 18 deputetë të Partisë Laburiste votuan kundra tij.

| **Shtetet që votuan** | **Data e miratimit të Tr.Lisbonës** | **Periudha e votimit brenda institucioneve dhe popullatës** |
|---|---|---|
| Austria | 13 Maj 2008 | 9 Prill - 28 Prill 2008 |
| Belgjika | 15 Tetor 2008 | 6 Mars – 11 Korrik 2008 |
| Bullgaria | 28 Prill 2008 | 21 – 28 Mars 2008 |
| Qipro | 26 Gusht 2008 | 3 – 19 Qershor 2008 |
| Republika Çeke | 13 Nëntor 2009 | 18 Shkurt – 3 Nëntor 2009 |
| Danimarka | 29 Maj 2008 | 24 – 30 Prill 2008 |
| Estonia | 23 Shtator 2008 | 11 -19 Qershor 2008 |
| Finlanda | 30 Shtator 2008 | 11 Qershor- 12 Shtator 2008 |
| Franca | 14 Shkurt 2008 | 7 Shkurt-13 Shkurt 2008 |
| Gjermania | 25 Shtator 2009 | 24 Prill – 8 Tetor 2008 |
| Greqia | 12 Gusht 2008 | 11 Qershor 2008 |

[16] House of Commons Foreign Affairs Committee. (2008, Janar). Foreign Policy Aspects of the Lisbon Treaty : Third Report of Session 2007–08.
Marrë nga https://publications.parliament.uk/pa/cm200708/cmselect/cmfaff/120/120.pdf

| | | |
|---|---|---|
| Hungaria | 6 Shkurt 2008 | 17 -20 Dhjetor 2007 |
| Irlanda | 23 Tetor 2009 | 29 Prill 2008 – 27 Tetor 2009 |
| Italia | 8 Gusht 2008 | 23 Korrik - 2 Gusht 2008 |
| Letonia | 16 Qershor 2008 | 8 – 28 Maj 2008 |
| Lituania | 26 Gusht 2008 | 8 - 14 Maj 2008 |
| Luksemburgu | 21 Korrik 2008 | 29 Maj -3 Korrik 2008 |
| Malta | 6 Shkurt 2008 | 29 Janar 2008 |
| Hollanda | 11 Shtator 2008 | 5 – 10 Qershor 2008 |
| Polonia | 12 Tetor 2009 | 1 – 9 Prill 2008 |
| Portugalia | 17 Qershor 2008 | 23 Prill – 9 Maj 2008 |
| Rumania | 11 Mars 2008 | 4 – 6 Shkurt 2008 |
| Sllovakia | 24 Qershor 2008 | 10 Prill – 12 Maj 2008 |
| Sllovenia | 24 Prill 2008 | 29 Janar – 7 Shkurt 2008 |
| Spanja | 8 Tetor 2008 | 26 Qershor – 30 Korrik 2008 |
| Suedia | 10 Dhjetor 2008 | 20 Nëntor 2008 |
| Britania e Madhe | 16 Korrik 2008 | 11 Mars – 19 Qershor 2008 |

**Tabela 3-** Pasqyrimi i votimit nga shtetet anëtare të Traktatit të Lisbonës

## I.Ç. Politikat kryesore në vijim të Traktatit

Një pjesë e konsiderueshme e politikave të Bashkimit Europian dhe Parlamentit përcaktohen nga vlerat, objektivat dhe parimet që ka BE-ja.

Për shkak se Bashkimi Europian filloi si një bashkësi ekonomike, politikat ekonomike janë ende një pjesë e rëndësishme. Bashkimi Europian gjithashtu konsideron me rëndësi dhe angazhimin në zgjerimin e bashkëpunimit për të mbrojtur mjedisin, duke synuar të promovojë mbrojtjen e pasurive natyrore dhe të ndalojë ndryshimin e klimës në të ardhmen.

Në përputhje me vlerat e saj, Bashkimi Europian kërkon të promovojë mirëqenien, sigurinë dhe interesat e qytetarëve. Ka dëshirë që të mbajë një ekonomi të qëndrueshme dhe konkuruese në krahasim me vendet e tjera të botës. Në mënyrë të vazhdueshme janë bërë përpjekje për të parandaluar mosmarrëveshjet e brendëshme dhe për t'i zgjidhur ato në rastet kur shfaqen  përmes negociatave.

### Politikat ekonomike

Traktati i Lisbonës tregon një angazhim serioz  për të arritur një bashkim, që përveç të tjerash është  dhe bashkim ekonomik e monetar, duke patur euron si  valutë të BE-së.

Kjo monedhë aktualisht përdoret  nga 19 shtete, duke formuar kështu eurozonën.

Bashkimi ekonomik dhe monetar është objektiva kryesore e BE-së, duke e konsideruar këtë bashkim si një  forcë jetike që siguron faktin se Europa është e përqendruar drejtë prosperitetit dhe zgjerimit të vendeve të punës.

Traktati i Lisbonës gjithashtu formalizon  Bankën  Qendrore Europiane , tashmë si një institucion të BE-së , me pozitë dhe rol të mirë përcaktuar.

Qëllimi i politikave ekonomike të Bashkimit Europian është të krijojë një zonë të qëndrueshme dhe të sigurtë të euros. Një monedhë e përbashkët përmirëson konkurrencën e kompanive dhe rrit stabilitetin ekonomik. Banka Qendrore Europiane

rregullon normat e interesit dhe është në gjendje të kontrollojë inflacionin dhe kurset e këmbimit. Bashkimi Europian u paguan shteteve anëtare subvencione të ndryshme, për shembull për projekte zhvillimi. Subvencionet janë krijuar për të përmirësuar standardin lokal/vendor të jetesës dhe shpërndarjen e pasurisë në zonat më të varfra të Europës.

**Politikat tregtare**

Nuk ka tarifa doganore midis vendeve anëtare të BE-së. Gjithashtu, importet nga vendet në zhvillim janë pa taksa ose detyrimet janë të ulura. Kjo është një mënyrë në të cilën BE-ja përpiqet të eliminoje varfërinë. Bashkimi Europian ka një pozicion të rëndësishëm në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Marrëdhëniet tregtare mbahen, veçanërisht, me vendet e Mesdheut, Rusinë, Shtetet e Bashkuara dhe Kinën. Bashkimi Europian kërkon të promovojë marrëdhëniet tregtare dhe interesat e vendeve anëtare të saj në çdo mënyrë që mundet. Shtetet anëtare mund të nënshkruajnë gjithashtu marrëveshje bilaterale tregtare me vendet e tjera për sa kohë që ato nuk bien ndesh me ligjet dhe marrëveshjet e BE-së.

**Politikat mbi Sigurinë dhe Mbrojtjen**

Traktati i Lisbonës shprehet qartazi mbi rolin e BE-së në fushën e punëve të jashtme dhe të politikës së sigurisë të përbashkët. Të gjitha vendimet që i përkasin çështjeve të sigurisë së përbashkët duhet të miratohen unanimisht nga 27 shtetet anëtare.

Jashtë territorit të saj BE-ja ka ndërmarrë misione të ndryshme paqeruajtëse, që kanë shërbyer për të parandaluar konfliktet e mundshme dhe përforcuar sigurinë ndërkombëtare në kuadër të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Roli i BE-së pas këtij traktati, zgjerohet edhe në drejtim të përfshirjes në çështje si : operacione mbi çarmatimet; këshillime dhe ndihmesa ushtarake; përpjekjeve për rikthimin e stabilitetit në rajonet që kanë patur konflikte më parë.

Krijoi një infrastrukturë më të mirë për bashkëpunime mes shteteve anëtare të cilat kanë nevojë të bashkëpunojnë në fushën e mbrojtjes.

Pas këtij traktati, shtetet anëtare mund të vënë në dispozicion për BE-në mundësitë e tyre ushtarake, të cilat nëse do të duhet do të shërbejnë si instrumente për implementimin e politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes. Përcaktohet po ashtu dhe roli i Agjensisë Europiane për Mbrojtje.

Prezantohemi gjithashtu me klauzolën e natyrës vullnetare, mbi reagimet e BE-së kur një shtet anëtar  ëahtë viktimë e një sulmi terrorist, ose fatkeqësie natyrore etj.

Politikat e sigurisë të Bashkimit Europian përqëndrohen kryesisht në punët e brendshme të Europës. Bashkimi Europian ka themeluar një agjenci të përbashkët europiane për zbatimin e ligjit të quajtur Europol . Përmes Europol, autoritetet policore të vendeve të ndryshme mund të bashkëpunojnë dhe zgjidhin krimet ndërkombëtare. Europol është specializuar në parandalimin e trafikut të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore, emigracionit të paligjshëm dhe pastrimit të parave. Bashkëpunimi mes organeve të zbatimit të ligjit, prokurorëve, gjyqtarëve dhe policisë promovohet nga Eurojust. Kryesisht përqëndrohet në krimin e organizuar ndërkufitar, me qëllim që të sjellë kriminelët para drejtësisë sa më shpejt të jetë e mundur.

Një zhvillim i ri në sektorin e sigurisë është mundësia e një politike të përbashkët mbrojtëse. Në veçanti, bashkëpunimi është planifikuar për të parandaluar veprimet  dhe aktet e terrorizmit. Gjithashtu krijimi i Qëndrës së Koordinimit të Veprimeve të Emergjencës (ERCC) ,që mund të dërgohet për të kontrolluar emergjencat ishte një element i rëndësishëm. Ky organ  përbëhet nga trupat e ushtrive të shteteve anëtare, dhe kështu nuk mund të konsiderohet si një ushtri e veçantë Europiane. AEM koordinon proceset e bashkëveprimit dhe i propozon organeve drejtuese të BE-së  misione të ndryshme të ruajtjes së paqes sipas nevojave që paraqiten.

**Politikat Sociale**

Traktati i Lisbonës zgjeron objektivat sociale  të Bashkimit Europian. Përpiqet kryesisht të promovojë rritjen e nivelit të punësimit.

Marrin rëndësi  dhe disa shërbime me karakter social ekonomik si: transporti publik, telekomunikacioni, furnizimi me gas e energji elektrike, shërbimet postare etj.

Sigurisht që në këto shërbime të përmendura më lartë, rolin kryesorë e kanë shtetet anëtare për funsionimin dhe administrimin efektiv të tyre dhe BE-ja  ka një rol më të kufizuar me mendimin se efiçenca dhe efektiviteti realizohet më mirë nëse rolet janë të ndara .

BE-ja duhet të kufizohet nga çdo rol që mund të shihet si potencial për të kufizuar ose cënuar rolet e shteteve anëtare në ofrimin e shërbimeve me interes të përbashkët  si : shërbimet sociale, shëndetësia, policia, shkollat publike.

**Politikat e punësimit dhe çështjet sociale**

Politikat e punësimit kanë një rol të rëndësishëm në strategjinë e Bashkimit Europian. Si rezultat i recesionit ekonomik dhe zhvillimeve në tregtinë botërore, papunësia është rritur në Europë. Bashkimi Europian kërkon të mbajë vendet e punës brenda Europës dhe të ndihmojë të papunët të gjejnë punë. Investime të vazhdueshme bëhen në arsim dhe kërkim. Janë bërë përpjekje për të parashikuar më mirë ndryshimet e mundshme në ekonomi. Bashkimi Europian përpiqet në mënyrë të vazhdueshme që të evitojë dhe në rastet kur shfaqet që të zgjidhë, krizën ekonomike botërore dhe mbi të gjitha të sigurojë që asnjë shtet anëtar i BE-së të mos hyjë në vështirësi financiare.

Masat mbështetëse të marra nga BE-ja ndihmojnë në parandalimin e varfërisë dhe përjashtimit social. Në mënyrë të vazhdueshme ndërmerren hapa për të përmirësuar punësimin. Sistemet e ndërtuara mirë të skemave të pensioneve inkurajohen. Bashkimi Europian miraton ligje që mbështesin të drejtat e punëtorëve. Gjithashtu përpiqet të ndikojë në vendet anëtare për t'i bërë sistemet e tyre të sigurimeve shoqërore të funksionojnë më me efikasitet. Si pasojë e ketyre politikave mund të shprehem se kushtet e punës dhe mirëqenia e punonjësve janë përmirësuar. Trajnimi i vazhdueshëm për të përmirësuar dhe ruajtur aftësitë profesionale të punonjësve në një botë në ndryshim mbetet sërish fokusi i BE-së dhe politikave sociale që ndërmerr.

Bashkimi Europian jep ndihmë financiare për zhvillimin e arsimit dhe kërkimit sikurse jam shprehur dhe më lartë. Në periudha të ndryshme recesioni ekonomik subvencionon projekte të ndërtimeve publike, duke krijuar kështu mundësi punësimi për një numër më të madh njerëzish. Fondi Europian për Investimet mbështet zbulimet e inovacionet e reja dhe projekte pozitive në lidhje me mjedisin, të cilat rrisin mundësitë për zhvillim të tregjeve të së ardhmes.

Përparimet teknologjike, globalizimi dhe ndryshimet demografike vazhdojnë të ndikojnë në mënyrën se si jetojnë dhe punojnë europianët. BE-ja po zhvillon në mënyrë aktive politika dhe propozime legjislative për t’i përballur këto “sfida”.

Duke mbajtur në fokus të drejtat sociale , BE-ja punon për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve duke siguruar:

• Mundësi të barabarta për t’u përshatur në tregun e punës

• Kushtet e drejta të punësimit

• Mbrojtja dhe përfshirja sociale

• Të jetosh dhe të punosh në vendet e tjera të BE-së

Fondet për financim të ofruara nga BE-ja ndihmojnë organizatat publike dhe private, të zbatojnë dhe përmirësojnë politikat e punësimit dhe përfshirjes sociale.

Kuadri ligjor i BE-së për punësimin garanton nivele minimale të mbrojtjes që vlejnë për të gjithë ata që jetojnë dhe punojnë në BE. Rregullat specifike të BE-së gjithashtu synojnë të bëjnë më të lehtë për qytetarët e BE-së të jetojnë dhe punojnë në vendet e tjera brenda BE-së, duke mbrojtur të drejtat e tyre të sigurimeve shoqërore, të tilla si sigurimet shëndetësore dhe pensionet.

**Politikat për të Drejtat e Njeriut**

Traktati i Lisbonës bëri të detyrueshme zbatimin e Kartës të së Drejtave Themelore, duke njohur të drejtat, liritë dhe parimet që përmban kjo kartë.

Si pasojë e këtij detyrimi kur BE-ja propozon ose implementon ligje duhet të respektojë dhe zbatojë të drejtat e parashikuara në këtë kartë. Sikurse dhe shtetet anëtare, kur implementojnë legjislacionin e BE-së duket të respektojnë po ashtu kartën dhe të drejtat që përmban .

Të drejtat mbi mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën për azil , barazinë përpara ligjit, mos diskriminimin, barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e të moshuarve etj, janë të drejta që duhet t'i gezojnë të gjithë . Po ashtu dhe të drejta të tjera sociale si: e drejta për siguri dhe mbrojtje/përkrahje sociale, mospërjashtimi/largimi prej vendit të punës pa të drejtë etj.

Traktati i Lisbonës gjithashtu miratoi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si organe që mbikqyrin dhe mbrojnë zbatueshmërinë e të drejtave të parashikuara në Kartën e së Drejtave Themelore (CFR).

**Politikat e Jashtme**

Më parë, çdo shtet anëtar ishte përgjegjës për politikën e tij të jashtme. Ndërsa tashmë bashkëpunimi midis vendeve rritet në përballjen e problemeve globale, vendet e vogla europiane mund të shprehin mendimet dhe nevojat e tyre në mënyrë më të efektshme përmes hallkave dhe institucioneve që adresojnë këto problematika brenda BE-së. Kjo

është arsyeja pse bashkëpunimi në fushën e politikës së jashtme u rrit me Traktatin e Lisbonës. Një President dhe Ministër i Jashtëm u zgjodhën për Bashkimin Europian i cili mund të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, madje edhe vendet e vogla mund ti japin zë mendimit të tyre midis fuqive të mëdha të botës. Në politikën e tij të jashtme, Bashkimi Europian vazhdon të ndjek vlerat e tij. Nëse është e mundur, të gjitha problemet synohen të zgjidhen përmes negociatave. Bashkimi Europian në qëndrimet e tij në mënyrë të vazhdueshme shprehet se dëshiron të sigurojë paqen dhe të shmangë luftën.

Politika e përgjithshme e Bashkimit Europian është e ndikuar nga tendencat politike në vendet anëtare dhe politikat e ndjekura nga eurodeputetët.

**Politikat mjedisore**

Kërkesat dhe standartet mjedisore të Bashkimit Europian janë më të rreptat në botë. BE e merr seriozisht mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit. Speciet e rrezikuara dhe habitatet e tyre mbrohen nëpërmjet politikave specifike. Theksohet se burimet natyrore duhet të përdoren në mënyrë efikase. Një tjetër objektiv i politikës mjedisore është promovimi i shpikjeve dhe inkurajimi i të gjitha kompanive për të respektuar mjedisin në operimet dhe programet e tyre. Mbështeten produktet dhe veprimtaritë të cilat janë pozitive ose me ndikim sa më të lehtë ndaj mjedisit. Kursimi i energjisë inkurajohet dhe riciklimi është rritur, duke bërë tashmë prej vitesh fushata dhe ligje të cilat ndihmojnë këto procese.

Drejt një Europe më të gjelbër dhe më të qëndrueshme është një moto shoqëruese e BE-së përsa i takon politikave mjedisore.

Shumica e qytetarëve të BE-së përfitojnë nga standardet më të larta mjedisore në botë. BE-ja dhe qeveritë kombëtare kanë vendosur objektiva të qarta për të udhëhequr politikën europiane të mjedisit deri në vitin 2020 dhe një vizion përtej këtij, ku do të jetë deri në vitin 2050, me mbështetjen e programeve të dedikuara kërkimore, legjislacionit dhe financimit:

• të mbrojë, ruajë dhe forcojë kapitalin natyror të BE-së;

• shndërrmi i ekonomisë së BE-së në një ekonomi konkuruese dhe efiçente që përdor me kujdes dhe efikasitet burimet natyrore;

• mbrojtja e qytetarëve të BE-së nga presionet që lidhen me mjedisin dhe rreziqet për shëndetin e mirëqenien.

Punohet në mënyrë të vazhdueshme në shumë fronte për të mbrojtur speciet dhe zonat natyrore të rrezikuara të BE-së, për të siguruar ujin e pijshëm, për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbeturinave dhe për të zvogëluar efektet e kimikateve të dëmshme në natyrë por dhe tek njerëzit.

Mbrojtja e mjedisit dhe inovacioni ndihmojnë në krijimin e fushave të reja të biznesit dhe mundësi më të larta punësimi, të cilat stimulojnë investime të mëtejshme. Rritja e hapësirës së gjelbër është në fokus të politikës së BE-së për të siguruar që rritja ekonomike e europës është e qendrueshme për mjedisin. BE-ja gjithashtu luan një rol kryesor në promovimin e zhvillimit të qendrueshëm në një nivel global.

**Politikat bujqësore**

Qëllimi kryesor i politikave bujqësore të Bashkimit Europian është zhvillimi i fshatit. BE-ja dëshiron të sigurojë prodhimin e vazhdueshëm bujqësor në të gjitha pjesët e Europës. Kontrollohet cilësia e ushqimit, etiketimi i paketave dhe mbrojtja e bimëve. Qëllimi është të sigurohet që produktet e prodhuara në pjesë të ndryshme të Europës të jenë të sigurta, të pastra dhe me cilësi të lartë dhe të kultivuara duke respektuar mjedisin. Këto rregulla ose ligje mbi prodhimtarinë dhe bujqësinë, kufizojnë prodhimin e tepërt por sigurojnë cilësi dhe kohëzgjatje në prodhim.

Në Finlandë, ka shumë diskutime rreth politikave mbi bujqësinë e BE-së. Shumica e qytetarëve që janë interesuar, janë informuar mbi subvencionet dhe direktivat e BE-së në lidhje me politikat bujqësore. Politikat bujqësore ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të njerëzve dhe në mënyrën e të ushqyerit prandaj ka një ndjeshmeri të lartë ndaj këtyre politikave dhe standardeve që propozohen për t'u arritur. Subvencionet e BE-së janë ndihma e drejtpërdrejtë monetare për fermerët në zonat ku bujqësia dhe rritja e bagëtive janë më pak fitimprurëse sesa në pjesën e Europës Qëndrore që konsiderohet më pjellore. Mbështetje gjithashtu mund të kërkohet për: projekte zhvillimi e ndërtimi dhe investime të posaçme që ndihmojnë në zhvillimin e bujqësisë. Edhe pse njerëzit shpesh shqetësohen nga direktivat që propozohen ose aplikohen, ato sigurojnë produkte të sigurta dhe me cilësi të lartë. Për shembull: Konsumatorët në Finlandë janë të kënaqur të shohin që etiketat në paketimet e tyre ushqimore janë gjithmonë në finlandisht, edhe nëse produkti është importuar nga një vend i largët.

Prodhimi botëror i ushqimit duhet të dyfishohet deri në vitin 2050 për të siguruar nevojat që vijnë si pasojë e rritjes së popullsisë dhe evolucionit të mënyrës së të ushqyerit. Prodhimi  përballet me ndikimet e ndryshimit të klimës në biodiversitetin, cilësinë e tokës dhe ujit, si dhe kërkesat e tregut global.

Politika e fermave e BE-së ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme në dekadat e fundit për të ndihmuar fermerët të përballen me këto sfida dhe t'u përgjigjen qëndrimeve dhe prirjeve të ndryshme të njerëzve. Politikat bujqësore të BE-së mbulojnë një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë cilësinë e ushqimit, prejardhjen e produktit, tregtinë dhe promovimin e produkteve bujqësore të BE-së. Bashkimi Europian mbështet financiarisht fermerët e saj dhe inkurajon praktika të qëndrueshme e prozitive ndaj mjedisit dhe gjithashtu investon në zhvillimin e zonave rurale.

Institucionet e BE-së bashkëpunojnë për hartimin e politikave të ushqimit dhe bujqësisë, duke i zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar ato me vëmendje. Autoritetet përgjegjëse të vendeve anëtare  zbatojnë ligjet e dakorduara në nivelin e BE-së. Përmes buxhetit të BE-së, fondet u vihen në dispozicion vendeve anëtare në përputhje me rregullat e përcaktuara në nivelin e BE-së. BE gjithashtu monitoron se si zbatohen ligjet, sa janë efektive dhe koordinon ndryshimet e mundëshme që ndodhin herë pas here.

Si pasojë e  klimës së saj të favorshme, tokës pjellore, aftësive teknike të fermerëve të saj dhe cilësisë së produkteve, BE-ja është një nga prodhuesit kryesorë dhe eksportuesit kryesorë në botë të produkteve bujqësore. Gjithashtu industria dhe shërbimet e lidhura me bujqësinë e ushqimin  përbëjnë një sektor i cili ofron shume vende pune.

| Politikat kryesore | Objektiva të veçanta | Instrumenta të përmirësuar për të realizuar politikat | Kompetenca shtesë të cilat rregullojnë/zgjerojnë fushën e shtrirjes së politikës | Votim me anë të sistemit: Majoritar (me shumicë) |
|---|---|---|---|---|
| Politikat Ekonomike | po | po | po | po |
| Politikat Sociale | po | | po | po |
| Politikat e Jashtme | po | po | | |
| Politikat mbi mbrojtjen dhe sigurinë | po | po | | |
| Politikat në fushën e Energjisë | po | | po | Ligjërisht nuk është e shprehur, por në praktikë veprohet pasi është votuar në shumicë |

**Tabela 4 -** Risitë që solli Traktati i Lisbonës në pesë politikat kryesore

| Politikat : | Më shumë kompetenca rregulluese ? |
|---|---|
| Në fushën e Energjisë | Po, për sa i përket kompetencave të qarta të BE-së (të ndara me Shtetet Anëtare) (më parë BE-ja e kishte politikën e saj të energjisë në dispozitat e përgjithshme të KE . Traktati i Lisbonës sjell fuqi shtesë por dhe legjitimin në kompetencat e mëparshme. |
| Sociale | Po, sjell kompetenca shtesë të fokusuara kryesisht në sigurinë shoqërore të punëtorëve emigrantë e për sigurinë shoqërore të varësve të tyre, dhe mbrojtjen sociale në mënyrë që të garantohen të drejtat themelore të qytetarëve të BE-së për të lëvizur dhe banuar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare . |
| Mbi Mbrojtjen dhe Sigurinë | Jo |
| Politikat e Jashtme | Jo |

**Tabela 5** -Traktati i Lisbonës në këndvështrimin e disa politikave kryesore: Më shumë kompetenca për veprime rregulluese?

***Shënim:*** Në fushat e politikës së jashtme dhe të sigurisë së mbrojtjes , ka hapje shumë të kufizuara në favor të vendimeve me shumicë të kualifikuar të votave. Parimi i unanimitetit mbahet për të gjitha çështjet thelbësore të politikës së jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes.

| Traktati | Politikat Sociale | Politikat në fushën e Energjisë | Politikat e Jashtme | Politikat mbi Mbrojtjen dhe Sigurinë |
|---|---|---|---|---|
| Lisbonës | ●<br>+<br>++ | ●<br>+ | ●<br>*<br>+ | ●<br>*<br>+ |
| Nicës | | +<br>++ | | |
| Amsterdamit | ●<br>+<br>++ | | *<br> | |
| Mastrihtit | ●<br>+<br>++ | + | ●<br>+ | ●<br>+ |
| Akti Unik Europian | ●<br>++ | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Romës | ●<br><br>+ | | | |

**Tabela 6 -** Zgjerimi dhe thellimi i aftësive të politikë-bërjes i parë tek politikat kryesore, duke e krahasuar në disa Traktate .

***Simbolet orientuese të Tabelës 6:***

●Objektiva të reja

*Instrumente të përmirësuara të politikë-bërjes

+Kompetenca të reja të qarta

++Kompetenca pa kërkesë unanimiteti në miratimin e tyre

## I.D. Funksionimi i BE-së në terma ekonomike

### Të ardhurat e Bashkimit Europian

Buxheti i BE-së financohet pothuajse tërësisht nga burimet e veta. Të ardhurat vjetore duhet të mbulojnë të gjithë shpenzimet vjetore. Sistemi i burimeve të veta vendoset nga Këshilli në bazë të unanimitetit, duke marrë parasysh mendimin e Parlamentit Europian, dhe ai duhet të ratifikohet nga Shtetet Anëtare.

Objektivi kryesor në gjenerimin e të ardhurave është për t'i siguruar Bashkimit Europian një autonomi financiare brenda kufijve të disiplinës buxhetore. Ndërkohë që Komuniteti Europian i Qymyrit dhe Çelikut (ECSC) siguroi vetë burimet e saj që prej themelimit të tij, Komuniteti Ekonomik Europian (EEC) dhe Komuniteti Europian i Energjisë Atomike (Euratom) fillimisht u financuan përmes kontributeve të vendeve anëtare. Vendimi i Prillit 1970 i njohu EEC burimet e veta, për të mbuluar ndarjet vjetore të pagesave aktualisht janë të kufizuara në një maksimum prej 1.20% të të ardhurave kombëtare bruto (GNI) të BE. Meqenëse buxheti duhet të jetë gjithnjë i balancuar, shpenzimet shfrytëzohen brenda këtij kufizimi/tavani. Në praktikë, korniza aktuale financiare shumëvjeçare (MFF) 2014-2020 përcakton tavanin e shpenzimeve në rreth 1% të GNI-së së BE-së.[17]

Burimet e veta tipike përbëhen nga taksat doganore, detyrimet bujqësore dhe taksat e sheqerit dhe izoglukozës. Ato u krijuan dhe mblidhen që prej 1970. Përqindja që mund të mbahet nga vendet anëtare për të mbuluar kostot e mbledhjes është ulur nga 25% në 20%. Këto burime referuar si 'tradicionale' përgjithësisht përbëjnë rreth 15% të të ardhurave të veta. Burimet e TVSH-së aktualisht konsistojnë në transferimin e një përqindje të TVSH-së së vlerësuar mbledhur nga shtetet anëtare në Union. Pavarësisht se u parashikua me vendim të posaçëm që prej vitit 1970, ky burim hyri në përdorim vetëm një vit më pas kur u harmonizuan sistemet e TVSH-së së shteteve anëtare. Burimi i TVSH-së zë zakonisht 12% të të ardhurave të burimeve të veta. Burimet e veta bazuar në GNI përbëhen nga një taksë uniforme e përqindjes ndaj GNI së vendeve anëtare përcaktuar në procedurën e buxhetit të çdo viti sipas Vendimit 88/376 / EEC të Këshillit. Fillimisht këto burime duhet të mblidheshin vetëm nëse burimet e veta të tjera nuk i mbulonin plotësisht shpenzimet, por aktualisht ai financon pjesën më të madhe të

[17] Delasnerie, A. (2020, Qershor). *The Union's revenue.* Parlamenti Europian.

buxhetit të BE-së. Burimi i bazuar në GNI është trefishuar që nga fundi i viteve 1990, dhe tani zakonisht përbën rreth 72% të të ardhurave të burimeve të veta. Të ardhurat e tjera përfshijnë taksat e paguara nga stafi i BE-së mbi pagat e tyre, kontributet nga vendet jo anëtare të BE-së në programe të caktuara të saj dhe gjobat e paguara nga kompani që kanë shkelur ligjet e konkurrencës ose ligje të tjera. Nëse ka tepricë, bilanci nga secili vit financiar futet në buxhet për vitin e ardhshëm nën zërin e të ardhurave. Të ardhurat, balancat dhe rregullimet teknike zakonisht përbëjnë më pak se 10% të të ardhurave totale.[18]

Sistemi aktual i burimeve të veta ka për qëllim gjithashtu të korrigjojë pabarazitë buxhetore midis kontributeve të vendeve anëtare. "Zbritja e Mbretërisë së Bashkuar" e rënë dakord në 1984 konsiston në një ulje të kontributit të Mbretërisë së Bashkuar ekuivalent me dy të tretat e diferencës midis kontributit të saj (duke përjashtuar burimet tradicionale të veta) dhe shumës që merr përsëri nga buxheti. (Delasnerie:2020). Kjo zbritje u rregullua në vitin 2007 me qëllim që të përjashtohej gradualisht nga llogaritja e shpenzimeve jo-bujqësore të vendeve anëtare të cilat u anëtarësuan në BE pas vitit 2004. Ky korrigjim financohet nga të gjitha shtetet e tjera anëtare, përveç Gjermanisë, Hollandës, Austrisë dhe Suedisë , të cilat përfitojnë nga një ulje e kontributeve të tyre në financimin e zbritjes për Mbretërinë e Bashkuar. Gjermania, Hollanda, Austria dhe Suedia gjithashtu përfituan nga një normë të ulur të TVSH-së  për periudhën 2007-2013, dhe Hollanda dhe Suedia përfituan nga një ulje në kontributet e tyre bazuar në GNI për të njëjtën periudhë.

Çështje përbën mekanizmi ekzistues korrektues për Mbretërinë e Bashkuar dhe financimi i tij duke qënë se është ende në fuqi; po ashtu dhe normat e zvogëluara të burimeve të veta  bazuar në TVSh, për periudhën 2014-2020 për Gjermaninë, Hollandën dhe Suedinë (0.15%) . Mekanizmat e korrigjimit gjithashtu aktualisht përfshijnë ulje bruto në kontributin vjetor të GNI-së për periudhën 2014-2020 për Danimarkën (130 milion EURO), Hollandën (695 milion EURO) Suedinë (185 milion EURO) dhe për periudhën 2014-2016 për Austrinë (30 milion EUR në 2014, 20 milion EUR në 2015 dhe 10 milion EURO në 2016).[19]

---

[18] Delasnerie, A. ((2020, Qershor). *The Union's revenue.* Parlamenti Europian.

[19] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Qershor). *The Union's revenue.* Parlamenti Europian.

Traktati i Lisbonës përsëriti që buxheti duhet të financohet tërësisht nga burimet e veta dhe të ruajë fuqinë e Këshillit, pas konsultimit me Parlamentin, që të miratojë në unanimitet një vendim për sistemin e burimeve të veta të Unionit. Ai prezantoi mundësinë e krijimit të kategorive të reja të burimeve të veta dhe shfuqizimin e burimit ekzistues. Ai gjithashtu përcaktoi që Këshilli mund të miratojë masa zbatuese për këto vendime vetëm nëse merr pëlqimin e Parlamentit.

Në vitin 2014 u krijua një grup i nivelit të lartë për të ndërmarrë një rishikim të përgjithshëm të sistemit të burimeve të veta në dialog me parlamentet kombëtare. Ai përbëhej nga përfaqësues të Parlamentit, Këshillit dhe Komisionit, kryesuar nga Mario Monti. Ky grup, i quajtur Monti Group, u krijua si rezultat i insistimit të Parlamentit gjatë negociatave për MFF për 2014-2020. Grupi paraqiti raportin e tij përfundimtar në krye të herës së vitit 2017. Për dy vjet, ai reflektoi një mënyrë më transparente, të thjeshtë, të drejtë dhe me përgjegjësi demokratike të financimit të buxhetit europian. Përfundimi kryesor ishte që buxhetit të BE-së i nevoitej një reformim, si në anën e të ardhurave ashtu edhe të shpenzimeve, për të qënë i aftë të adresojë sfidat aktuale dhe të arrijë rezultate të prekshme për qytetarët europianë. (Delasnerie:2020).

Në dokumentin e tij reflektues për të ardhmen e financave të BE-së, të paraqitur në Qershor 2017, Komisioni paraqiti pesë skenarë dhe implikimet e tyre për të ardhurat. Gati një vit më pas, Komisioni bëri propozime për të thjeshtuar burimin e tanishëm të bazuar në TVSH dhe për të prezantuar një shportë të burimeve të veta të reja përbërë nga: 1. 20% e të ardhurave nga Sistemi i Tregtimit të Emetimeve; 2. Një normë shpallje prej 3% e aplikuar në Bazën e re të Përbashkët të Tatimit të Konsoliduar të Korporatës; 3. Një kontribut kombëtar i llogaritur në sasinë e mbeturinave të ricikluesshme të paketimit plastik në secilin vend anëtar (0.80 EUR për kilogram). Komisioni vlerësoi se këto burime të veta të reja do të përbëjnë rreth 12% të buxhetit të përgjithshëm të BE-së dhe mund të kontribuojnë në një nivel të ardhurash deri në 22 miliardë EUR në vit. Komisioni propozoi heqjen e zbritjeve aktuale për një periudhë prej pesë vjetësh, për ti eleminuar të gjitha ato në një kohë të mëvonshme dhe zvogelimin e pjesës së të ardhurave doganore që vendet anëtare mbajnë për të mbuluar kostot e mbledhjes nga 20% në 10%. Ai gjithashtu propozoi një rritje të tavanit në shpalljet vjetore për burime të veta nga niveli aktual prej 1.20% e GNI-së së BE-së në 1.29% për një total të GNI-së në një nivel më të vogël për BE-27, përdorim në rritje të instrumenteve të garantuara

kundër buxhetin e BE-së dhe propozimin për integrimin e Fondit Europian të Zhvillimit në buxhetin e BE-së.[20]

Një sërë rezolutash gjatë viteve të kaluara janë bërë shkak që Parlamenti të nxjerrë në pah problemet me sistemin e burimeve të veta, veçanërisht kompleksitetin e tij. Ai ka parashtruar propozime për të siguruar që Unioni është i pavarur financiarisht dhe ka nxitur reforma për ta bërë mbledhjen e të ardhurave më të thjeshtë, më transparente dhe më demokratike.

Duke u bazuar në dispozitat e reja të Traktatit të Lisbonës, Parlamenti ka thirrur vazhdimisht për një reformë të thelluar të sistemit të burimeve të veta, si rasti i rezolutës për negociatat mbi MFF 2014-2020 në fillimin e vitit 2014.[21]

Në rezolutën e tij legjislative për projektvendimin e Këshillit për sistemin e burimeve të veta në Prill 2014, Parlamenti theksoi rëndësinë e Grupit Monti dhe theksoi se midis të metave të tjera serioze, sistemi aktual i financimit të Unionit ka parandaluar një shumicë të Këshillt buxhetimin e ndarjeve të mjaftueshme të pagesave në buxhetet vjetore për ti lejuar BE-së përmbushjen e detyrimeve të veta ligjore dhe të angazhimeve politike.[22]

Në rezolutën e mesit të vitit 2016 me titull 'Përgatitja e rishikimit pas-zgjedhor të MFF 2014-2020: Kontributi i Parlamentit përpara propozimit të Komisionit', Parlamenti i bëri thirrje Komisionit të paraqesë një paketë legjislative ambicioze për burimet e veta për 2021 deri në fund të vitit 2017, duke u udhëzuar nga priet e thjeshtësisë, drejtësisë dhe transparencës.[23]

Në rezolutën e Parlamentit për rishikimin afatmesëm të MFF 2014-2020 të Tetorit 2016, Parlamenti përsëri theksoi nevojën për të zvogëluar pjesën e kontributeve të GNI dhe

[20] Idem.

[21] Parlamenti Europian. (2014, Prill) *Resolution on negotiations on the MFF 2014-2020: lessons to be learned and the way forward (2014/2005(INI))*. PE Bruksel, Belgjikë.

[22] Parlamenti Europian. (2014, Dhjetor) *Resolution on the proposal for a Council regulation amending Regulation (EC, Euratom) No 1150/2000 implementing Decision 2007/436/EC, Euratom on the system of the European Communities' own resources (COM(2014)0704 — C8-0250/2014 — 2014/0332(NLE)).* PE Bruksel, Belgjikë.

[23] Parlamenti Europian. (2016, Korrik) *Resolution on the preparation of the post-electoral revision of the MFF 2014-2020: Parliament's input ahead of the Commission's proposal (2015/2353(INI))*. PE Bruksel, Belgjikë.

kërkoi që burimi i TVSH-së të reformohet ose të hiqet krejtësisht. Për më tepër, Parlamenti gjithashtu bëri thirrje për krijimin e një ose disa burimeve të reja të veta, si dhe heqjen dorë nga të gjitha format e zbritjes.[24]

Në rezolutën e tij mbi Dokumentin Reflektues për të Ardhmen e Financave të BE-së të Tetorit 2017, Parlamenti përsëriti angazhimin e tij për një reformë të plotë të sistemit të burimeve të veta të BE-së. Ai theksoi se për të arritur financa më të drejta dhe më të qendrueshme të BE-së, çdo sistem i ri duhet të përfshijë një shportë të ekuilibruar të burimeve të reja të BE-së, të dizajnuara për të mbështetur objektivat e politikës së BE-së dhe të jetë e fazuar në mënyrë progresive.[25]

Në rezolutën e tij për reformimin e sistemit të burimeve të veta të Bashkimit Europian të Marsit 2018, Parlamenti renditi arsyet e reformimit të sistemit aktual të burimeve të veta, përfshirë nevojën për të adresuar të metat e tij dhe duke i dhënë mundësi BE-së të financojë politikat e saj dhe të përmbushë sfidat e reja . Parlamenti gjithashtu kërkoi një sistem të pranueshëm dhe të ekuilibruar të burimeve të veta dhe përshkroi parimet dhe supozimet që rregullojnë krijimin e një sistemi të ri, renditi kriteret e përdorura për të identifikuar burimet e veta të reja, dhe propozoi një shportë me burime të reja të mundshme.[26]

Në rezolutën e tij për kornizën shumëvjeçare financiare 2021-2027 të Nëntorit 2018, Parlamenti ftoi Komisionin të marrë parasysh Opinionin Nr. 5/2018 të Gjykatës Europiane të Auditorëve, dhe dha detaje të mëtejshme mbi sugjerimet e tij për futjen e një shporte të burime të veta të reja që janë në përputhje me objektivat thelbësor strategjik të BE-së dhe asnjanëse nga pikëpamja fiskale për qytetarët.[27] Në rezolutën me të njëjtin emër, të një viti më pas, Parlamenti konfirmoi qëndrimin e tij pas zgjedhjeve. Ai kërkoi në veçanti krijimin e një mekanizmi rregullimi të kufirit të qymyrit, me konsideratën se është mënyra më e drejtë për t'iu përgjigjur kërkesave popullore për

---

[24] Parlamenti Europian. (2016, Tetor) *Resolution on the mid-term revision of the MFF 2014-2020 (2016/2931(RSP))*. PE Bruksel, Belgjikë.

[25] Parlamenti Europian. (2017, Tetor) *Resolution on the Reflection Paper on the Future of EU Finances (2017/2742(RSP)).* PE Bruksel, Belgjikë.

[26] Parlamenti Europian. (2018, Mars) *Resolution on reform of the European Union's system of own resources (2017/2053(INI)).* PE Bruksel, Belgjikë.

[27] Parlamenti Europian. (2018, Nëntor) *Resolution on the Multiannual Financial Framework 2021-2027 – Parliament's position with a view to an agreement (COM(2018)0322 – C8-0000/2018 – 2018/0166R(APP)).* PE Bruksel, Belgjikë.

udhëheqje vendimtare në luftën kundër ndryshimit të klimës, duke siguruar një fushë të barabartë të lojës në tregtinë ndërkombëtare ".

Komisioni propozoi në fund të Majit 2020 të huazojë deri në 750 miliardë euro duke lëshuar bono në tregjet ndërkombëtare për llogari të BE-së me afat maturimi nga 3 deri në 30 vjet, në mënyrë që të financojë një MFF të rindërtuar dhe një plan për rimëkëmbjen dhe rezistencën (grante dhe kredi për vendet e BE-së). Për të mbështetur detyrimet që rrodhën nga përpjekja e BE-së për të rimbursuar rritjen financiare të tregut, Komisioni propozoi ngritjen e tavanit të burimeve të veta me 0.6% të GNI të BE-së në mënyrë të përkohshme vetëm për këtë rast. Kjo zbatuar mbi rritjen e propozuar nga 1.2% në 1.4% të GNI-së duke konsideruar kontekstin e ri ekonomik. Sipas mendimit të Komisionit, kjo e fundit forcon çështjen për një reformë thelbësore se si financohet buxheti i BE-së. (Delasnerie:2020).

Përveç një burimi të thjeshtuar të TVSH-së dhe kontributit kombëtar, si dhe burimeve të veta bazuar në mbeturinat e pa ricikluara të paketimit plastik, opsionet për burime të veta të reja përfshijnë: një shtrirje të burimeve të veta bazuar në Sistemin e Tregtimit të Emetimeve, për të përfshirë sektorin detar dhe atë të aviacionit, një mekanizëm rregullimi të kufijve të qymyrit, një burim i vet i bazuar në operacionet e ndërmarrjeve të mëdha dhe një taksë dixhitale për kompanitë me një qarkullim vjetor global më shumë se 750 milion EUR.

Në rezolutën e Majit 2020 për kornizën e re financiare shumëvjeçare, burimet e veta dhe planin e rimëkëmbjes, Parlamenti bëri thirrje për një rritje të menjëhershme dhe të përhershme të tavanit të burimeve të veta, në funksion të rënies së parashikuar të GNI-së pas recesionit të shkaktuar nga kriza, jo vetëm për të paguar interesin dhe ripagimet kryesore të huamarrjes së BE-së për financimin e rimëkëmbjes, por edhe për financimin e një MFF ambicioze, duke nënvizuar se kjo do të ishte lëvizja e nevojshme për mirëmbajtjen e kontributeve të GNI-së së vendeve anëtare në nivelet aktuale nominale.[28]

[28] Parlamenti Europian. (2020, Mars) *Resolution on the new multiannual financial framework, own resources and the recovery plan (2020/2631(RSP))*. PE Bruksel, Belgjikë.

**Shpenzimet e Bashkimit Europian**

Shpenzimet buxhetore miratohen bashkërisht nga Këshilli dhe Parlamenti. Buxheti vjetor i BE-së duhet të respektojë kufijtë buxhetorë të rënë dakord në kuadrin financiar shumëvjeçar (MFF) për programe dhe politika të ndryshme, siç janë ato për kohezionin, bujqësinë dhe marrëdhëniet e jashtme. Instrumentet e fleksibilitetit sigurojnë që BE-ja të mund të reagojë në rast nevojash të papritura. Përdorimi i instrumenteve financiare krijon një efekt leve për shpenzimet e BE-së.

Në zbatim të Neneve nga 6 deri 38 të rregullores për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Unionit, për financimin e politikave të Bashkimit Europian brenda kufijve të rregullimit buxhetor, në përputhje dhe me rregullat dhe procedurat në zbatim, buxheti i BE-së u bindet nëntë rregullave të përgjithshme të unitetit: saktësisë së buxhetit, afatit kohor vjetor, ekuilibrit, njësisë së llogarisë në euro, universalitetit, specifikimeve sipas ndarjeve me shpenzimet e posaçme respektive, menaxhimit financiar dhe transparences.[29]

Rregulli vjetor duhet të përputhet me nevojën për të menaxhuar veprime shumëvjeçare, që marrin më shumë rëndësi brenda buxhetit. Kështu buxheti përfshin ndarje të diferencuara që konsistojnë në: 1. Ndarje të zotimeve, duke mbuluar koston totale gjatë vitit aktual financiar të detyrimeve ligjore të kontraktuara për aktivitete që zgjasin në disa vite; 2. Ndarje të pagesave, që mbulojnë shpenzimet në lidhje me angazhime zbatuese të kontraktuara gjatë vitit aktual financiar ose ato të mëparshme.

Rregulli i unitetit nuk është respektuar plotësisht, duke marrë parasysh që, për shembull, alokimet e Fondit Europian të Zhvillimit (EDF) nuk përfshihen në buxhet. Sidoqoftë, me insistimin e Parlamentit, Marrëveshja Ndërinstitucionale për rregullimin buxhetor mbi bashkëpunimin për çështje buxhetore dhe menaxhimin financiar të Dhjetorit 2013, përcakton që, Komisioni përgatit një raport vjetor që ofron një përmbledhje të pasojave financiare dhe buxhetore të aktiviteteve të ndryshme të Unionit, të financuara nga brenda ose jashtë buxhetit të BE-së. Ky raport përmban informacione për EDF, operacione të ndryshme të huazimit dhe huamarrjes, përfshirë Mekanizmin Europian të Stabilizim-it (ESM) dhe Facilitetin e Stabilitetit Financiar Europian si dhe fondet e

[29] Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. (2018, Korrik). *Financial Regulation applicable to the general budget of the Union.* Komisioni Europian, Bruksel.

besimit të BE-së për veprime të jashtme, të cilat janë rritur në rëndësi si rezultat i situatës së emigracionit. (Milicevic:2020).

Buxheti i përgjithshëm për shpenzimet operative, administrative, buxhetet e veprimtarisë individuale janë të ndarë në 10 seksione, një për secilin institucion. Ndërsa seksionet e institucioneve të tjera përbëhen kryesisht nga shpenzimet administrative, seksioni i Komisionit përbëhet nga shpenzime operacionale për të financuar veprime dhe programe dhe kosto administrative të zbatimit të tyre, si për shembull asistencë teknike dhe burime njerëzore. Në vitin 2020, shpenzimet e përgjithshme administrative korrespondojnë me 6.1% të buxhetit të përgjithshëm prej 168 688.1 milion EUR. Komisioni përdor një nomenklaturë buxheti që paraqet burimet sipas fushës së politikave dhe aktiviteteve, duke e bërë më të lehtë vlerësimin e kostos dhe efektivitetit të secilës politikë të BE-së.[30]

Që nga viti 1988, shpenzimet e BE-së janë vendosur në një kornizë shumëvjeçare, Kuadri financiar shumëvjeçar (MFF), që ndan buxhetin në kapituj që korrespondojnë me fushat e politikave të gjera, me tavanet e shpenzimeve që pasqyrojnë prioritetet kryesore buxhetore për periudhën e mbuluar. Periudha e parë e programimit zgjati pesë vjet dhe së bashku me periudhat pasuese dhe aktuale shkon në shtatë vjet. Buxhetet vjetore duhet të respektojnë kufijtë e përcaktuar në kornizën shumëvjeçare. Politikat bujqësore dhe rurale mbeteten marrin pjesën më të madhe sa i takon alokimit të buxhetit, pasuar nga me politika rajonale.

Në krye të shpenzimeve të programuara për të financuar politikat e BE-së në kuadër të programeve shumëvjeçare, disa mjete financiare janë ruajtur në buxhetin e BE për qëllim të përgjigjes ndaj krizave dhe situatave të papritura. Këto instrumente të veçantë fleksibiliteti mund të përdoren në rast të krizave ekonomike (p.sh. Fondi Europian i Rregullimit të Globalizimit), katastrofave natyrore (p.sh. Fondi i Solidaritetit), emergjencave humanitare (p.sh. Rezerva e Ndihmës së Urgjencës) ose nevoja të tjera të papritura (p.sh. Instrumenti i Fleksibilitetit) për shtetet anëtare të BE-së, vendet

[30] Këshilli Europian. (2020, Qershor). *The EU's annual budget.* Marrë nga https://www.consilium.europa.eu/en/policies/the-eu-budget/eu-annual-budget/

kandidate ose vendet jashtë BE-së. Një financim i tillë lejon që të mbulohen nevoja të kufizuara financiare të jashtëzakonshme.[31]

Sa i takon instrumentave financiar, në formën e kapitalit neto ose kapitalit të rrezikut, garancitë ose aranzhimet e tjera të ndarjes së rrezikut, ato janë përfshirë në një varg programesh të BE-së për të rritur aftësinë e levave të ndihmës financiare të BE-së.

Si pjesë e një pakete masash të miratuara nga Këshilli në Maj 2010 për shtetet anëtare në vështirësi ose ato të kërcënuara nga vështirësi të mëdha, u krijua Mekanizmi Europian i Stabilizimit Financiar për të ofruar ndihmë financiare në formën e një kredie ose një linje krediti të garantuar nga Buxheti i BE-së. Lehtësia e bilancit të pagesave mundëson ndihmë financiare për vendet anëtare, monedha e të cilave nuk është euro. Për më tepër, mund të jepet për të ndihmuar vendet jo anëtare, ndihma makrofinanciare, në formën e huave ose granteve.

Gama e operacioneve dhe instrumenteve është rritur shumë që nga viti 1978, dhe vitet e fundit është rritur dhe më tej, veçanërisht përmes Fondit Europian për Investime Strategjike.[32]

Përpara miratimit të Traktatit të Lisbonës, shpenzimet buxhetore u klasifikuan si të detyrueshme, kur lidhen me një detyrim kontraktual, ose jo të detyrueshme. Ndërsa Parlamenti vendoste për shpenzimet jo të detyrueshme, Këshilli vendoste për shpenzimet e detyrueshme. Parlamenti e kundërshtoi këtë pasi e gjykoi si kufizim të kompetencave të tij.

Traktati i Lisbonës heq dallimin midis shpenzimeve të detyrueshme dhe jokompulsive dhe i jep Parlamentit kompetencat e përbashkëta buxhetore me Këshillin mbi të gjithë buxhetin. Parlamenti ka insistuar në transparencën buxhetore dhe kontrollin e duhur të të gjitha operacioneve dhe instrumenteve dhe ka kërkuar që të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat që rrjedhin nga vendimet e marra nga ose në emër të institucioneve të BE-së, përfshirë operacionet e huazimit, huamarrjes dhe garantimit të huasë, të përmblidhen në

[31] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Qershor). *The Union's expenditures.* Parlamenti Europian.

[32] Milicevic, V. (2020, Maj). *The Union's expenditures.* Parlamenti Europian.

një dokument që aneksohet çdo vit në projektbuxhet, duke siguruar një pamje të përgjithshme të pasojave financiare dhe buxhetore të aktiviteteve të BE-së.

Komiteti i Parlamentit për Kontrollin e Buxhetit mban një takim vjetor me Bankën Europiane të Investimeve (EIB) për të shqyrtuar aktivitetet e tij financiare, dhe përgatit një raport vjetor që vlerëson performancën dhe rezultatet e kaluara të EIB. Komiteti i Parlamentit për Buxhetin dhe Komiteti për Çështjet Ekonomike dhe Monetare ranë dakord për përgatitjen e një raporti vjetor që vlerëson veprimet aktuale dhe të ardhshme të EIB.

Duke konsideruar se instrumentet financiare mund të jenë një mjet i vlefshëm në rritjen e ndikimit të fondeve të BE-së, Parlamenti ka theksuar se ato duhet të zbatohen në kushte të rrepta, duke shmangur rreziqet buxhetore. Për këtë qëllim, janë përfshirë në Rregulloren Financiare rregullat e hollësishme për përdorimin e instrumenteve financiare. (Milicevic:2020).

**Korniza Financiare Shumëvjeçare (MFF)**

Deri më tani, ka pasur pesë korniza financiare shumëvjeçare (MFF). Traktati i Lisbonës e ktheu MFF nga një marrëveshje ndërinstitucionale në një akt ligjërisht të detyrueshëm. Brenda afatit kohor 5-vjeçar, një MFF duhet të sigurojë që shpenzimet e Unionit të zhvillohen në mënyrë të rregullt dhe brenda kufijve të burimeve të veta dhe përcakton dispozita me të cilat duhet të përputhet buxheti vjetor i Unionit, duke parashtruar kështu pikënisjen e rregullimit financiar. Pjesa më e rëndësishme është që rregullorja e MFF përcakton tavanet e shpenzimeve për kategoritë e gjera të shpenzimeve të njohura si 'tituj/zëra'. Në Maj 2018 Komisioni paraqiti propozime legjislative për një MFF të re për periudhën 2021-2027. Dy vite më pas, Komisioni dorëzoi një propozim të përditësuar për MFF së bashku me një propozim për një instrument rimëkëmbjeje, Gjenerata e Ardhme BE, pas pandemisë së COVID-19.[33]

Koncepti i një perspektive shumëvjeçare financiare u zhvillua si një përpjekje për të zvogëluar konfliktin, i cili u krijua në marrëdhëniet midis institucioneve nga një

[33] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Qershor). *Multiannual Financial Framework.* Parlamenti Europian.

mospërputhje në rritje midis burimeve të disponueshme dhe kërkesave aktuale buxhetore, për forcimin e rregullimit buxhetor dhe për përmirësimin e zbatimit përmes një planifikimi më të mirë.

Marrëveshja e parë ndërinstitucionale (IIA) për këtë qëllim u përmbyll më 1988. Ajo përmbante perspektivën financiare për vitet 1988-1992, e cila synonte të siguronte burimet e nevojshme për zbatimin buxhetor të Aktit të vetëm Europian. Në Tetor të 1993 u dakordua një IIA e re, së bashku me perspektivën financiare për 1993-1999, e cila mundësoi që të dyfishohen dhe të rriten burimet e Fondeve Strukturore. IIA e tretë, që mbulonte parashikimin financiar për periudhën 2000-2006, e njohur gjithashtu si Agenda 2000, u nënshkrua në Maj 1999, dhe një nga qëllimet kryesore të saj ishte sigurimi i burimeve të nevojshme për të financuar zgjerimin. IIA e katërt, që përfshin periudhën 2007-2013, u dakordua në Maj 2006.[34]

Traktati i Lisbonës e ktheu kuadrin financiar shumëvjeçar nga një marrëveshje ndërinstitucionale në një akt të detyrueshëm nga pikëpamja ligjore. Përveç përcaktimit të shumave të tavaneve vjetore të ndarjeve të zotimeve sipas kategorisë së shpenzimeve dhe tavanit vjetor të ndarjeve të pagesave, në nenin 312 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian (TFEU) thuhet se MFF gjithashtu përcakton dispozita të posaçme që kërkohen në mënyrë që procedura vjetore e buxhetit të funksionojë pa probleme.[35]

Rregullorja e MFF shoqërohet nga një IIA që mbulon fushat e rregullimit buxhetor, bashkëpunimit për çështjet buxhetore dhe menaxhimin financiar. MFF-ja e pestë, që përfshin periudhën 2014-2020, u miratua në Dhjetor 2013. Kjo MMF ishte e para që u miratua në bazë të dispozitave të reja të Traktatit të Lisbonës, duke cituar se Këshilli, në bazë të një procedure të veçantë legjislative, duhet të miratojë në unanimitet Rregulloren e MFF pasi të ketë marrë pëlqimin e Parlamentit.

Në propozimin e rishikuar, Komisioni parashikoi, për periudhën 2014-2020, të rrisë tavanin për ndarjet e zotimeve në 1 033 miliardë EUR (1.08% të të ardhurave bruto kombëtare të BE (GNI)) dhe atë për ndarjet e pagesave në 988 miliardë EUR (1.03% e GNI të BE-së). Pothuajse një vit më vonë, Presidentët e Komisionit, Parlamentit dhe Këshillit arritën një marrëveshje politike për një paketë MFF e cila uli tavanin e

[34] Ibid.

[35] Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian. (2012). OJ C 326/47

përgjithshëm për ndarjet e zotimeve në 960 miliardë euro (1.00% të GNI të BE) dhe atë për ndarjet e pagesave në 908 miliardë euro (0.95% e GNI të BE).[36] Në rezolutën e tij të Korrikut të vitit 2013 për marrëveshjen politike mbi Kuadrin Financiar Shumëvjeçar 2014-2020, Parlamenti kujtoi se miratimi i Rregullores së MFF-së dhe IIA-së së re lidhej me miratimin e buxheteve të nevojshme për të siguruar ndarje shtesë të pagesave për vitin financiar 2013, me marrëveshjen politike mbi bazat ligjore të programeve përkatëse shumëvjeçare dhe me krijimin e një grupi të nivelit të lartë nga burimet e veta.

Në Nëntor 2013, pas plotësimit të këtyre kushteve, Parlamenti dha pëlqimin e tij për draft rregulloren dhe në Dhjetor 2013 Këshilli miratoi Rregulloren e MFF (Rregullorja e Këshillit Nr. 1311/2013) për vitet 2014-2020. Neni 6 (1) i Rregullores së MFF kërkon që Komisioni të bëjë çdo vit, përpara procedurës buxhetore për vitin n + 1, një rregullim teknik të MFF-së në përputhje me lëvizjet në GNI dhe çmimet e BE-së dhe t'i komunikojë rezultatet në Parlament dhe njëkohësisht dhe Këshill.

Komisioni miratoi rregullimin teknik të MFF për 2020 në përputhje me lëvizjet në GNI të BE-së, sipas Sistemit Europian të Llogarive (ESA 2010), në Maj të vitit 2019. Rezultati i këtij rregullimi teknik solli ndarjet totale të zotimeve për vitin 2020 (168 797 milion EUR) në 0.99% dhe ndarjet totale të pagesave (172 420 milion EUR) në 1.01%, në terma të GNI-së së BE-së. GNI për vitin 2020 është përcaktuar në 16 989 408 milion EUR me çmime aktuale për BE-28. [37]

Sa i takon rolit të Parlamentit Europian lidhur me MFF 2014-2020, ai themeloi në 2010 një komitet të posaçëm për sfidat e politikave dhe burimet buxhetore për një BE të qëndrueshme pas vitit 2013 (SURE), me misionin e përgatitjes së një raporti për MFF-në e ardhshme përpara se Komisioni të paraqiste propozimet e tij. Në bazë të raportit SURE, Parlamenti miratoi një rezolutë gati një vit më pas me titullin "Investimi në të ardhmen: një Kornizë e re Financiare Shumëvjeçare (MFF) për një Europë konkurruese, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse".

---

[36] Këshilli Europian. (2020, Korrik). *Long-term EU budget 2014-2020.* Marrë nga https://www.consilium.europa.eu/en/policies/the-eu-budget/long-term-eu-budget-2014-2020/

[37] Këshilli Europian. (2020, Korrik). *The EU's annual budget.* Marrë nga https://www.consilium.europa.eu/en/policies/the-eu-budget/eu-annual-budget/

Parlamenti dha konfirmimin politik, tre muaj përpara miratimit ligjor të paketës MFF në Nëntor 2013, për marrëveshjen MFF 2014-2020 të arritur nga Presidentët e Parlamentit, Këshilli dhe Komisioni pas një seri bisedimesh, gjatë të cilave Parlamenti siguroi: 1.Fleksibilitet për angazhime dhe pagesa në të gjithë titujt/zërat dhe ndër vite për të lejuar përdorimin e shumave të plota të planifikuara për 2014-2020; 2.Një klauzolë për rishikimin e detyrueshëm që bën të mundur rivlerësimin e nevojave buxhetore gjatë periudhës së MFF-së dhe rregullimin e tyre nëse është e nevojshme, duke lejuar që Parlamenti Europian i sapozgjedhur të luajë rolin e tij, dhe një angazhim për të rishikuar kohëzgjatjen e MFF-ve të ardhshme; një kuptim i qartë mbi një mënyrë të zbatueshme dhe përcaktim kohor për vendosjen e një sistemi të vërtetë të burimeve të veta për BE-në; 3.Fleksibilitet më të lartë për të trajtuar papunësinë tek të rinjtë dhe forcimin e hulumtimit pa zvogëluar burimet për programet e tjera; 4.Fleksibilitet më të madh për të ofruar ndihmë në rast fatkeqësish përmes Fondit të Solidaritetit; 5.Ngritjen e fondeve për projektet me shkallë të gjerë ITER, Galileo dhe Kopernicus me qëllim mbrojtjen e programeve të tjera në rast të tejkalimit të kostove; 6.Unitet dhe transparencë buxhetore, duke siguruar informacion të plotë për qytetarët mbi të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat që vijnë nga vendimet e marra nga, ose në emër të qytetarëve të BE-së, nën kontrollin e duhur parlamentar sigurisht.[38]

Rishikimi afatmesëm (MTR) i MFF 2014-2020 ishte një nga parakushtet e Parlamentit për pranimin e Kornizës. Komiteti i Parlamentit për Buxhetet (BUDG) ishte përgjegjës për përgatitjen e e negociatave të Parlamentit për rishikimin e MFF. Në Qershor 2016, ai lëshoi një raport që përfshinte vlerësimin për vitet e para të funksionimit të MFF, pritshmëritë nga rishikimi i Komisionit dhe elementët kryesorë për MFF pas vitit 2020. Ky raport ishte baza për miratimin e rezolutës së Parlamentit të Korrikut 2016, që përfshinte kërkesat e Parlamentit për MFF aktuale, si dhe konsideratat për MFF e ardhshme. Në Tetor 2016, Parlamenti miratoi një rezolutë në ndjekje të propozimit të Komisioni.

Pas negociatave dhe marrëveshjes së Këshillit të Marsit 2017 për rishikimin e MFF 2014-2020, Parlamenti miratoi një rezolutë për ndryshimin e Rregullores së MFF një muaj më vonë. Në Qershor 2017, Këshilli miratoi MFF e rishikuar për 2014-2020 me një votim unanim. Këshilli dhe Parlamenti ranë dakord për mbështetje shtesë në vlerën

[38] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Qershor). *Multiannual Financial Framework.* Parlamenti Europian.

6 miliard euro (15% rialokime, 85% burime të pa alokuara), duke iu nënshtruar procedurës vjetore buxhetore, e cila vihet në dispozicion për masa të lidhura me emigracionin (3.9 miliardë EUR), vende pune dhe rritje e përjithshme (2.1 EUR miliardë, nga të cilat 1.2 miliardë EUR në nxitje të Nismës së Rinisë për Punësimin). Përforcimi i Instrumentit të fleksibilitetit dhe Rezerva e Ndihmës së Urgjencës do të lejojë që fondet e mëtejshme të zhvendosen më lehtë ndërmjet titujve/zërave të buxhetit dhe viteve, në mënyrë që të jenë në gjendje të reagojnë ndaj ngjarjeve të paparashikuara dhe përparësive të reja që mund të lind nevoja të jepen.[39]

Referuar MMF 2020-2027, në Maj 2018, Komisioni paraqiti propozime e saj legjislative për këtë periudhë kohore. Kjo ishte më vonë nga sa ishte parashikuar në Rregulloren aktuale të MFF për shkak të periudhës së reflektimit për të ardhmen e BE-së. Propozimi i Komisionit arriti shifrën 1 134 583 milion EUR (çmime 2018) në ndarjet e zotimeve, të cilat përfaqësojnë 1.11% të GNI të BE-27. Rritja e buxhetit parashikohet për kontrollin kufitar, mbrojtjen, emigracionin, sigurinë e brendshme dhe të jashtme, bashkëpunimin e zhvillimit dhe hulumtimin, pas fushave të tjera; shkurtimet janë parashikuar kryesisht në politikën e kohezionit dhe politikën bujqësore, por edhe në fusha të tjera. Struktura e përgjithshme do të thjeshtohet dhe shtatë titujt/zërat e rinj do të përfshijnë gjithsej 17 grupime të politikave. Numri i programeve individuale të shpenzimeve do të zvogëlohet nga 58 në 37 për periudhën 2021-2027. Për më tepër, Komisioni propozon një grup të instrumenteve të posaçëm buxhetor jashtë linjave të MFF për të përmirësuar fleksibilitetin në buxhetimin e BE-së, siç është Instrumenti i Fleksibilitetit (1 miliard EUR në vit), Rezerva e Ndihmës së Urgjencës (600 milion EUR në vit), Fondi i Solidaritetit të Bashkimit Europian (600 milion EUR në vit), Fondi Europian i Rregullimit të Globalizimit (200 milion EUR në vit), Fondi Europian i Paqes dhe Funksioni i Stabilizimit të Investimeve Europiane (kredi deri në 30 miliardë EUR për periudhën e MFF). Do të integrohej në MFF dhe Fondi Europian i Zhvillimit (EDF).[40]

Më tej Komisioni propozon përmirësimin e zërave të të ardhurave, me futjen e disa kategorive të reja të burimeve të veta bazuar në të ardhurat e sistemit të tregtimit të

[39] Këshilli Europian. (2020, Korrik). *Long-term EU budget 2014-2020.* Marrë nga https://www.consilium.europa.eu/en/policies/the-eu-budget/long-term-eu-budget-2014-2020/

[40] Fact Sheets on the European Union 2020. (2020, Qershor). *Multiannual Financial Framework.* Parlamenti Europian.

emetimeve të BE-së, një kontribut i vendeve anëtare bazuar në mbeturinat plastike dhe një pjesë nga shuma e përbashkët e konsoliduar e tatim fitimit të korporatave. Parlamenti miratoi dy rezoluta për MFF e 2021-2027, një në Mars dhe një në Maj 2018. Në Nëntor 2018, duke u mbështetur në këto rezoluta, Parlamenti përshkroi më tej mandatin e tij negociues, duke përfshirë ndryshimet në Rregulloren e MFF dhe propozimet e IIA dhe një grup të plotë figurash me një ndarje sipas titujve/zërave dhe programeve. Në veçanti, raporti i përkohshëm i Parlamentit specifikoi sa vijon: Tavani i MFF për angazhimet duhet të rritet nga 1.0% që është parashikuar aktualisht me 28 vende anëtare në 1.3% të GNI të BE-së me 27 vende anëtare, dmth 1 324 089 milion EUR, bazuar në çmimet e 2018, që korrespondon me një rritje prej 16.7% mbi propozimin e Komisionit.[41]

Alokimet për politikën e përbashkët bujqësore dhe politikën e kohezionit duhet të mbeten të pandryshuara në terma reale ndërsa i duhet dhënë përparësi disa fushave të tjera, përfshirë programet e shpenzimeve për tregun e vetëm, inovacionin dhe dixhitalizimin, si për shembull Horizon Europe, për zërin “kohezioni dhe vlerat” dhe për zërin "burimet natyrore dhe mjedisin". Financimi i agjencive të decentralizuara që merren me emigracionin dhe menaxhimin e kufijve duhet të rritet më shumë se katërfish nga rreth 3 miliardë euro parashikuar aktualisht. Kontributi i buxhetit të BE për arritjen e objektivave lidhur me klimën duhet të përcaktohet në minimum 25% të shpenzimeve të MFF për 2021-2027, të përfshihet në fushat përkatëse të politikave dhe të rritet në 30% sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 2027. Rishikimi afatmesëm i MFF duhet të jetë i detyrueshëm dhe të propozohet jo më vonë se 1 Korrik 2023. Parlamenti dhe Komisioni fillimisht synuan të arrijnë një marrëveshje mbi rregulloren e MFF para zgjedhjeve të Parlamentit Europian 2019 për të kapur në kohë programet e ardhshme.

Sidoqoftë, Këshilli është ende duke punuar për një kompromis që të mund të miratohet unanimisht nga të gjitha Shtetet Anëtare. Këshilli publikoi një draft pakete negociatash në 2018-ën, që përfshin tekstin mbi parametrat kryesorë për paketën e përgjithshme financiare, por pa shifra për tavanet dhe alokimet kryesore të shpenzimeve. Përtej parashikimeve që lidhen me Rregulloren e MFF, paketa e negociatave gjithashtu prek

[41] Këshilli Europian. (2020, Korrik). *Long-term EU budget 2021-2027.* Marrë nga https://www.consilium.europa.eu/en/policies/the-eu-budget/long-term-eu-budget-2021-2027/

çështjet horizontale dhe sektoriale në lidhje me provizionet në ngarkim të programeve të shpenzimeve që janë nën procedurën e zakonshme legjislative. (Barslev:2020)

Parlamenti miratoi në Nëntor 2019 një rezolutë për rinovimin dhe përditësimin e mandatit të ekipit të tij negociues, në të cilin i kërkoi Komisionit që menjëherë të fillojë përgatitjen e një plani emergjence për MFF në rast se është e nevojshme të zgjatet periudha e MFF aktuale. Një muaj më vonë, Këshilli paraqiti një paketë negociatash duke përfshirë, për herë të parë, shifrat faktike për Kuadrin Financiar Shumëvjeçar 2021-2027. Sipas këtij propozimi, MFF i ardhshëm do të arrijë vlerën 1 087 miliardë euro në bazë të çmimeve të vitit 2018 sipas ndarjeve në zotime.

Në Dhjetor 2019, Këshilli Europian diskutoi tiparet kryesore të MFF-së dhe caktoi Presidentin e Këshillit Europian të merrej me diskutimet për të. Në fjalën e tij para Këshillit, Presidenti i Parlamentit theksoi se propozimi i Këshillit për MFF ishte shumë poshtë pritjeve të Parlamentit pasi qëllimi duhet të jetë ruajtja e fondeve për politikat tradicionale të BE-së në nivelin aktual në terma realë, nxitjen e programe më të suksesshme dhe sigurimin që Unioni të ketë burime të mjaftueshme për të përmbushur sfidat e reja me të cilat përballet. Presidenti i Parlamentit i bëri thirrje Presidentit të Këshillit Europian dhe Presidentit të Komisionit për të çuar përpara negociatat, për të inkurajuar pajtimin dhe për t'i afruar qëndrimet e institucioneve në një.

Pas zotimit të presidentes së re të Komisionit, Ursula von der Leyen se, do të ndryshonte menjëherë klimën e institucionit dhe si pjesë e Marrëveshjes së Gjelbër Europiane, në Janar 2020 Komisioni paraqiti një propozim për një Fond të Tranzicionit të Drejtë si një element shtesë në paketën e propozimeve të MFF. Fondi do të financohej në shumën prej 7.5 miliardë EUR. Më 20 dhe 21 shkurt 2020, Këshilli Europian mbajti një takim të veçantë për të diskutuar MFF, por nuk ishte në gjendje të arrinte një marrëveshje. Në Maj 2020, Parlamenti Europian kërkoi nga një shumicë e madhe (616 vota pro) që Komisioni të paraqesë, deri në Qershor 2020, një propozim për një plan emergjence mbi MFF, për të garantuar një rrjet sigurie për mbrojtjen e përfituesit të programeve të Unionit.

Pas krizës COVID-19 dhe efekteve serioze ekonomike nga karantinimi i shoqërive europiane, më 27 dhe 28 Maj 2020 Komisioni publikoi propozime për një rishikim të rëndësishëm të MFF 2021-2027. Propozimet përfshijnë një shumë të përgjithshme për

MFF prej 1 100 miliardë EURO për periudhën 2021-2027 dhe një instrument shtesë të rimëkëmbjes, që do të quhet Gjenerata e Ardhme e BE, prej 750 miliardë eurosh sipas çmimeve të 2018, 500 miliardë euro nga të cilat do të të disbursohet në formën e granteve dhe 250 miliardë euro si kredi. Paketa përfshin propozime legjislative për disa instrumente të reja si dhe ndryshime në një numër propozimesh legjislative të paraqitura tashmë për programet nën MFK-në e ardhshme.[42]

Financimi i paketës shtesë do të sigurohet duke marrë hua në tregjet financiare. Për këtë qëllim, Komisioni gjithashtu ka paraqitur ndryshime në vendimin e propozuar të burimeve vetjake, të cilat do të autorizonin huazimin deri në 750 miliardë euro. Një rritje në tavanin e burimeve të veta për pagesa në 1.4% të GNI dhe një rritje të përkohshme shtese nga 0.6% të GNI në 2.00% është propozuar për të garantuar aktivitetin më të lartë të huadhënies. Sipas Komisionit, rimbursimi i kredive do të mbulohej më së miri nga të ardhurat e burimeve të reja të veta. Komisioni njoftoi nisma legjislative për të reformuar sistemin e burimeve të veta me burime të reja, që do të prezantohen në vijim deri në vitin 2024. Si përfundim, paketa e Komisionit përfshin një rritje të tavanit për angazhimet në vitin 2020 në kuadër të MFF, në mënyrë që të mobilizojë mbështetjen që në vitin 2020. Rritja e propozuar në tavanin e zotimit është 11.5 miliardë euro. Pagesat që rezultojnë janë në përputhje me tavanin ekzistues të pagesave parashikuar për vitin 2020.[43]

**Zbatimi i Buxhetit të BE**

Komisioni është përgjegjës për zbatimin e buxhetit në bashkëpunim me vendet anëtare, objekt i një kontrolli politik nga Parlamenti Europian.

Komisioni është përgjegjës për zbatimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit në përputhje me Traktatet, në përputhje me dispozitat dhe udhëzimet e përcaktuara në Rregulloren Financiare, dhe brenda kufirit të ndarjeve të autorizuara. Vendet anëtare bashkëpunojnë me Komisionin në mënyrë që ndarjet të përdoren në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

[42] Këshilli Europian. (2020, Korrik). *The EU's annual budget.* Marrë nga https://www.consilium.europa.eu/en/policies/the-eu-budget/eu-annual-budget/

[43] Barslev, K. (2020, Qershor). *Multiannual Financial Framework..* Parlamenti Europian.

Zbatimi i buxhetit përfshin dy operacione kryesore: angazhimet dhe pagesat. Sa i përket angazhimit të shpenzimeve, merret një vendim për të përdorur një shumë të veçantë nga një linjë specifike buxhetore për të financuar një aktivitet specifik. Pasi të jenë vendosur angazhimet përkatëse juridike (p.sh. kontratat) dhe të jetë bërë dorëzimi i shërbimit, punës ose furnizimeve kontraktuese, autorizohen shpenzimet dhe paguhen shumat e duhura.[44]

Komisioni mund të zbatojë buxhetin në një nga mënyrat e mëposhtme: - Drejtpërdrejt nga departamentet e tij, ose përmes agjencive ekzekutive; - Nën menaxhimin e përbashkët me Shtetet Anëtare; - Në mënyrë indirekte, duke i besuar detyrat e zbatimit të buxhetit subjekteve dhe personave, p.sh. vendeve të treta, organizatave ndërkombëtare etj.[45]

Në praktikë, rreth 76% e buxhetit është shpenzuar në menaxhimin e përbashkët, 22% në menaxhimin e drejtpërdrejtë nga Komisioni ose agjencitë e tij ekzekutive, dhe 2%-shi i mbetur në manaxhimin indirekt. Sistemi i Transparencës Financiare siguron informacion mbi përfituesit e fondeve të menaxhuara direkt nga Komisioni; këtu listohen gjithashtu dhe përfituesit e Fondit Europian të Zhvillimit. (Mathis:2020)

Nga ana tjetër, secili vend anëtar është përgjegjës për publikimin e të dhënave mbi përfituesit e fondeve që administron nën menaxhimin indirekt dhe të përbashkët. Neni 317 TFEU specifikon që Komisioni duhet të zbatojë buxhetin në bashkëpunim me Shtetet Anëtare dhe përveç kësaj rregulloret e bëra në bazë të nenit 322 TFEU duhet të përcaktojnë detyrimet e kontrollit dhe auditimit të Shteteve Anëtare në zbatimin e buxhetit dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej tij. Për më tepër, në një kontekst më të gjerë të zbatimit të legjislacionit të BE-së, nenet 290 dhe 291 TFEU përcaktojnë dispozitat që rregullojnë kompetencat e deleguara dhe ato zbatuese që i janë besuar Komisionit dhe, veçanërisht, kontrollin e ushtruar mbi Komisionin në këtë drejtim nga Shtetet Anëtare , Këshilli dhe Parlamenti Europian.[46]

Sipas nenit 290 TFEU, një akt legjislativ mund t'i delegojë Komisionit fuqinë për të miratuar akte jo-legjislative për të plotësuar disa elemente jo thelbësor të aktit legjislativ. Parlamenti dhe Këshilli kanë të drejtë të revokojnë një delegim të tillë të

[44] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Maj). *Implementation of the budget*. Parlamenti Europian.

[45] Ibid.

[46] Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian. (2012). OJ C 326/47

kompetencave në Komision, ose ta kundërshtojnë atë, duke parandaluar kështu hyrjen në fuqi të tij.

Neni 291 rregullon fuqitë zbatuese që i janë dhënë Komisionit. Ndërsa neni 291 (1) TFEU përcakton që Shtetet Anëtare janë përgjegjëse për miratimin e të gjitha masave të ligjit kombëtar të domosdoshme për zbatimin e akteve juridikisht detyruese të Unionit, neni 291 (2) TFEU parashikon që këto akte t'i japin kompetencat zbatuese Komisionit ose, çështja e Neneve 24 dhe 26 të Traktatit për Bashkimin Europian (TEU), mbi Këshillin, ku "nevojiten kushte të njëtrajtshme për zbatimin e akteve të detyruara ligjërisht të Unionit". [47]Në zbatim të nenit 291 (3) TFEU, Parlamenti dhe Këshilli përcaktojnë, me rregullore, rregullat në lidhje me mekanizmat për kontrollin e Komisionit për ushtrimin e kompetencave zbatuese. Neni 291 TFEU plotësohet me Rregulloren e BE-së Nr. 182/2011 të Parlamentit Europian dhe Këshillit të Shkurtit 2011 që përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me mekanizmat për kontroll nga Shtetet Anëtare të ushtrimit të kompetencave zbatuese të Komisionit. Ky kontroll ushtrohet përmes komisioneve të përbërë nga përfaqësues të vendeve anëtare dhe kryesohet nga një përfaqësues i Komisionit.[48]

Rregullorja përcakton dy lloje të reja të procedurës, të zbatueshme në varësi të fushës së aktit në fjalë: sipas procedurës së kontrollit: Komisioni nuk mund ta miratojë masën nëse komiteti ka dhënë një mendim negativ; sipas procedurës këshilluese: Komisioni është i detyruar të marrë në konsideratë konkluzionet e komitetit, por nuk është i detyruar ta zbatojë. Zbatimi jo korrekt i buxhetit nga vendet anëtare penalizohet përmes procedurës së pastrimit të llogarive dhe kontrolleve të pranueshmërisë, ku faturat e qeverisë kombëtare nga buxheti i BE-së korrigjohen duke konsideruar fondet e paguara padrejtësisht pas kontrolleve të kryera nga Komisioni dhe Gjykata e Auditorëve. Vendimet në lidhje me korrigjimet e tilla merren nga Komisioni në përputhje me procedurat e lartpërmendura për ushtrimin e kompetencave zbatuese. Zbatimi i buxhetit në sektorë të veçantë ka qenë subjekt i kritikave të shpeshta nga Gjykata e Auditorëve. (Mathis:2020).

[47] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Maj). *Implementation of the budget*. Parlamenti Europian.

[48] Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian. (2012). OJ C 326/47

Rregullorja Financiare përmban të gjitha parimet dhe rregullat që drejtojnë zbatimin e buxhetit.[49] Ajo ka një karakter horizontal, i zbatueshëm për të gjithë fushat e shpenzimeve dhe të gjithë të ardhurat. Rregullat e tjera të zbatueshme për vënien në punë të buxhetit gjenden në rregulloret me bazë sektori që mbulojnë politika të veçanta të BE-së. Rregullorja e parë financiare u miratua fillimisht më Dhjetor 1977. Rregullorja e fundit e rishikuar financiare u miratua në vitin 2012 pas një procedure legjislative të iniciuar nga Komisioni në 2010 dhe u parapri nga një konsultim publik në 2009-n.

Ai u ndryshua më pas, në Maj 2014 dhe më pas në Tetor 2015. Në Shtator 2016, Komisioni paraqiti një propozim për një rregullore të re financiare që do të zëvendësonte atë aktuale si dhe ndryshimin e 14 sektorëve të tjerë në rregullore dhe një vendimi, secila prej të cilave përmban në vetëvete rregulla financiare. Objektivat e deklaruar të propozimit ishin të kishin një libër të vetëm rregullash, për të thjeshtuar dhe për t'i bërë më fleksibël rregullat financiare të BE-së.

Komiteti për Buxhetet, së bashku me Komitetin për Kontrollin e Buxhetit ishin komitetet përgjegjëse në Parlament. Procesi legjislativ vazhdoi deri në Korrik 2018 kur Parlamenti miratoi tekstin e dakorduar në seancën plenare të rradhës. Rregullorja Financiare u botua më pas në Fletoren Zyrtare dhe hyri në fuqi një muaj më pas. Sidoqoftë, gati të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje të re në lidhje me zbatimin e ndarjeve administrative të Institucioneve të Unionit janë vënë në zbatim prej Janarit te vitit 2019.[50]

Mjeti kryesor i Komisionit për zbatimin e buxhetit, dhe për monitorimin e zbatimit të tij, është sistemi i kompjuterizuar i kontabilitetit ABAC (kontabiliteti i bazuar në akrual). Komisioni ka ndërmarrë veprime për të përmbushur standardet më të larta të kontabilitetit ndërkombëtar, veçanërisht Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS) krijuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC). Një aspekt i rëndësishëm i zbatimit të buxhetit është respektimi i legjislacionit të BE-së i zbatueshëm për kontratat e prokurimit public.

Së pari, si pjesë e rëndësishme e autoritetit buxhetor, Parlamenti ka ndikim paraprak në zbatimin e buxhetit të BE-së me anë të ndryshimeve të bëra dhe vendimeve të marra në kontekstin e procedurës buxhetore për ndarjen e fondeve. Parlamenti mund të vendosë

[49] Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. (2018, Korrik). *Financial Regulation applicable to the general budget of the Union.* Komisioni Europian, Bruksel.

[50] Ibid.

të përdor mekanizmin rezervë të buxhetit, në qoftë se ka dyshime në lidhje me arsyetimin e shpenzimeve ose aftësinë e Komisionit për t'i zbatuar ato, Parlamenti mund të vendosë që fondet e kërkuara të vendosen në rezervë derisa Komisioni të sigurojë provat e duhura .

Provat e tilla janë siguruar si pjesë e një kërkese për transferimin e fondeve nga rezerva. Nga Parlamenti dhe Këshilli kërkohet të aprovojnë propozime për transferime. Ndarjet nuk mund të zbatohen derisa ato të transferohen nga rezerva dhe në linjën përkatëse të buxhetit.

Së dyti, procedura e shkarkimit i lejon Parlamentit të kontrollojë zbatimin e buxhetit aktual. Megjithëse shumica e pyetjeve të ngritura kanë të bëjnë me periudhën e shkarkimit, shumë prej atyre të bëra para Komisionit nga Komiteti i Parlamentit për Kontrollin Buxhetor, brenda kornizës së procedurës së shkarkimit, i referohen zbatimit të buxhetit aktual. Rezoluta e shkarkimit, e cila është pjesë përbërëse e vendimit të shkarkimit, përmban detyrime dhe rekomandime të shumta drejtuar Komisionit dhe organeve të tjera të përfshira në zbatimin e buxhetit.

Sipas Traktatit të Lisbonës, Parlamenti së bashku me Këshillin është përgjegjës për krijimin e rregullave financiare, të cilat përcaktojnë në veçanti procedurën që do të miratohet për krijimin dhe zbatimin e buxhetit dhe për paraqitjen dhe auditimin e llogarive' (neni 322 (1) TFEU).[51] Për më tepër, në pothuajse të gjitha fushat e politikave, Parlamenti ndikon në zbatimin e buxhetit përmes veprimtarive të tij legjislative dhe jo-legjislative, si rasti me raportet dhe rezolutat ose thjesht duke i adresuar pyetje me gojë ose me shkrim Komisionit.

Gjatë viteve të fundit, Parlamenti ka forcuar kontrollin e tij politik mbi Komisionin duke prezantuar instrumenta të cilat mundësojnë shkëmbimin e informacionit për zbatimin e fondeve dhe shumën e angazhimeve të papaguara. Angazhimet e papaguara mund të bëhen problem nëse akumulohen për periudha të gjata. Për këtë, Parlamenti po e shtyn Komisionin që t'i mbajë këto angazhime nën kontroll.[52]

Janë në zhvillim mjete të reja me qëllim mundësimin e monitorimit më të mirë të procesit të zbatimit të programeve të BE-së dhe përmirësimin e vlerës në para të tyre. Për këtë arsye, Parlamenti bën thirrje për Deklarata Aktiviteti me cilësi të lartë, që

[51] Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian. (2012). OJ C 326/47

[52] Mathis, A. (2020, Maj). *Implementation of the budget.* Parlamenti Europian.

presupozohet të përgatiten nga Komisioni në kontekstin e dokumenteve të saj të punës mbi projektbuxhetin e përgjithshëm paraprak dhe për paraqitjen e rregullt të analizave të kosto-përfitim për programet e BE-së.

**Kontrolli Buxhetor**

Shqyrtimi i buxhetit të BE-së kryhet në secilin institucion të BE-së dhe nga vendet anëtare. Kontrollet e hollësishme kryhen, në nivele të ndryshme, nga Gjykata Europiane e Auditorëve dhe nga Parlamenti Europian. Çdo vit Parlamenti shqyrton zbatimin e buxhetit me synimin për t'i dhënë të drejtën e tërheqjeve Komisionit, institucioneve të tjera të BE-së dhe agjencive të BE-së.

Objektivat e kontrollit buxhetor janë sigurimi i ligjshmërisë, saktësisë dhe menaxhimit financiar të operacioneve buxhetore dhe sistemeve të kontrollit financiar, si dhe menaxhim financiar të buxhetit të BE-së në terma të performancës, referuar dhe rolit të Gjykatës Europiane të Auditorëve dhe Parlamentit Europian, duke siguruar që këto objektiva të arrihen (kriteret e performancës).

Kontrolli fillestar i të ardhurave dhe shpenzimeve kryhet në një masë të madhe nga autoritetet kombëtare. Ata kanë mbajtur fuqitë e tyre, veçanërisht mbi burimet e veta tradicionale, një hapësirë në të cilën ata mund të kryejnë procedurat e kërkuara për të mbledhur dhe verifikuar shumat në fjalë. Në lidhje me këtë, në Maj 2014, Këshilli miratoi një paketë masash legjislative, duke përfshirë një vendim të ri për burimet e veta, që futën ndryshime në sistemin e burimeve përkatëse për periudhën nga 2014 deri në vitin 2020. Rregullat e reja mbi burimet e veta kanë qenë në fuqi që nga Tetori 2016, kur ai vendim hyri në fuqi dhe u kthye në Janar 2014. Mbledhja e burimeve tradicionale të veta është një çështje me rëndësi të madhe për institucionet e BE-së. (Verdins:2020)

Kontrolli buxhetor ushtrohet gjithashtu duke luftuar mashtrimin. Shpenzimet operacionale në bazë të Fondit Europian të Garancisë Bujqësore (EAGF), Fondit Europian Bujqësor për Zhvillim Rural (EAFRD) dhe fondeve të tjera strukturore janë shqyrtuar fillimisht nga autoritetet e vendit anëtar.

Kontrolli në nivelin e BE-së është i 3 llojshëm: i brendshëm, i jashtëm dhe kontroll në nivelin politik.

Në secilin institucion kontrolli i brendshëm ushtrohet duke autorizuar zyrtarë dhe llogaritarë dhe më pas nga auditori i brendshëm i institucionit. Kontrolli i jashtëm

kryhet nga institucionet kombëtare të kontrollit dhe Gjykata Europiane e Auditorëve (ECA), e cila paraqet raporte të hollësishme çdo vit tek autoriteti buxhetor në përputhje me nenin 287 TFEU, që përfshin - "Deklaratën e sigurimit për besueshmërinë e llogarive dhe ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve themelore" (DAS); - Raportin vjetor për zbatimin e buxhetit të përgjithshëm, përfshirë buxhetet e të gjitha institucioneve dhe organeve përreth; - Raporte specifike vjetore për agjencitë dhe organet e BE-së; - Raportin special për çështje specifike (auditime të performancës); - Raportet dhe opinionet e auditimit; - Shqyrtimet që përfshijnë politikat dhe temat e menaxhimit, analizojnë fusha ose çështje që nuk janë audituar ende ose krijojnë një bazë faktike për tema të caktuara. ECA gjithashtu rregullisht harton raporte mbi operacionet e huamarrjes dhe huazimit dhe mbi veprimtarinë e Fondit Europian të Zhvillimit (EDF).[53]

Sa i takon kontrollit në nivelin politik, brenda Parlamentit Europian, Komiteti për Kontrollin e Buxhetit është përgjegjës për përgatitjen e pozitës së Parlamentit dhe veçanërisht për: - Shqyrtimin e zbatimit të buxhetit të BE-së dhe EDF-së; - Mbylljen, prezantimin dhe auditimin e llogarive dhe bilancave të BE-së, institucioneve të saj dhe të çdo organi të financuar nga ajo; - Shqyrtimin e aktiviteteve financiare të Bankës Europiane të Investimeve; - Monitorimin e kosto-perfitimit të formave të ndryshme të financimit të BE-së në lidhje me zbatimin e politikave të saj; - Shqyrtimin e mashtrimeve dhe parregullsive në lidhje me zbatimin e buxhetit të BE-së, marrjen e masave për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive, rritjen e ndjekjeve penale në raste të tilla, si dhe mbrojtjen e interesave financiare të BE-së në përgjithësi. Përgatit gjithashtu vendimet për shkarkimin.[54]

Një herë në vit, me një rekomandim të Këshillit, Parlamenti i jep Komisionit shkarkime në lidhje me zbatimin e buxhetit për vitin n-2, pasi të ketë shqyrtuar raportet e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit, menaxhimin vjetor të Komisionit dhe raportin e performancës, raportin e vlerësimit , raportin vjetor të ECA-së dhe përgjigjet nga Komisioni dhe institucionet e tjera për pyetjet e Parlamentit.[55]

Komiteti për Kontrollin e Buxhetit përgatit qëndrimin e Parlamentit për raportet speciale të ECA-së, që kanë formën e punimeve për të udhezuar raportuesin e

[53] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Qershor). *Budgetary control.* Parlamenti Europian.

[54] Idem.

[55] Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian. (2012). OJ C 326/47

përgjithshëm për shkarkimin. Komisionit dhe institucioneve të tjera u kërkohet të veprojnë sipas vëzhgimeve të bëra nga Parlamenti në rezolutat e shkarkimit . Parlamenti gjithashtu i jep shkarkime çdo vit institucioneve të tjera dhe agjencive. Ajo i jep Komisionit shkarkime të veçanta në lidhje me zbatimin e operacioneve të EDF, përsa kohë ato ende nuk janë përfshirë në buxhetin e përgjithshëm të BE-së.

Vendimi dhe rezoluta e parlamentit për shkarkimin në lidhje me zbatimin e buxhetit të përgjithshëm të BE-së, Seksioni I - Parlamenti Europian, i drejtohet Presidentit të Parlamentit. Si rregull i përgjithshëm, Parlamenti shqyrton raportet e shkarkimeve në një seancë të pjesshme para mesit të Majit (neni 260 i Rregullores Financiare).[56] Kështu, përveç se në rrethana të jashtëzakonshme, votat për dhënien e shkarkimit merren në seancën e pjesshme të Majit ose, në rast të një shtyrjeje, në seancën e pjesshme të Tetorit.

Nëse një propozim për dhënien e shkarkimit nuk kryhet nga një shumicë, ose nëse Parlamenti vendos të shtyjë vendimin e tij për shkarkimin, Parlamenti informon institucionet ose agjencitë në fjalë për arsyet. Këta të fundit u kërkohet të veprojnë pa vonesë për të hequr pengesat për një vendim shkarkimi. Komiteti për Kontrollin Buxhetor më pas paraqet një raport të ri, brenda gjashtë muajve, i cili përmban një propozim të ri për të lejuar ose refuzuar shkarkimin.

Nga viti 1958 deri në 1970, Parlamenti u mbajt i informuar për vendimet mbi shkarkimet e dhëna nga Këshilli pranë Komisionit në lidhje me zbatimin e buxhetit. Në 1971, ajo siguroi fuqinë për të dhënë shkarkime së bashku me Këshillin. Që nga Qershori 1977, kur Traktati i Korrikut 1975 hyri në fuqi, vetëm ai ka fuqinë të lëshojë shkarkime, pasi Këshilli të ketë dhënë rekomandimin e tij. Përmes komisioneve të tij përgjegjëse, Parlamenti gjithashtu mban seancat e caktuara të Komisionerëve, dhe Komiteti për Kontrollin Buxhetor mban seanca dëgjimore për anëtarët e caktuar të ECA, kandidatët e përzgjedhur në listë për postin e Drejtorit të Përgjithshëm të OLAF dhe anëtarëve të Komitetit Mbikëqyrës të OLAF.[57]

Këto postime nuk mund të plotësohen derisa të mbahen dëgjimet. Së fundmi, duhet të theksohet se Drejtori i Përgjithshëm i OLAF emërohet nga Komisioni, pasi këshillohet

[56] Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. (2018, Korrik). *Financial Regulation applicable to the general budget of the Union.* Komisioni Europian, Bruksel.

[57] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Qershor). *Budgetary control.* Parlamenti Europian.

me Parlamentin dhe Këshillin, dhe që anëtarët e Komitetit Mbikëqyrës të OLAF emërohen me marrëveshje të përbashkët nga Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni.

Parlamenti mund të vendosë të shtyjë shkarkimet kur është i pakënaqur me aspekte të veçanta të menaxhimit të buxhetit nga Komisioni. Refuzimi i dhënies së shkarkimit mund të konsiderohet si ekuivalent me kërkesën e Komisionit për të dhënë dorëheqjen. Ky presion u vu në fuqi në Dhjetor 1998: pas një votimi në seancë plenare për të refuzuar mocionin e shkarkimit, u krijua një grup prej pesë ekspertësh të pavarur, i cili raportoi për akuzat për mashtrim, keqmenaxhim dhe nepotizëm kundër Komisionit. Komisionerët atëherë dhanë dorëheqjen nga blloku më 16 mars 1999. (Verdins: 2020).

Në lidhje me zbatimin e buxhetit të përgjithshëm të BE-së nga Komisioni, Parlamenti prezantoi dy karakteristika të reja gjatë procedurave të shkarkimit për 2011 dhe 2012: verifikimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së shpenzimeve, të cilat do duhet të shkojnë paralelisht me një vlerësim të performancës (neni 318 TFEU), dhe provizionin që përcakton që një vendim shkarkimi mund të balancohet nga rezervat në lidhje me fusha të caktuara të politikave.[58] Megjithëse Traktati i referohet vetëm shkarkimit për Komisionin, për arsye të transparencës dhe mbikëqyrjes demokratike Parlamenti gjithashtu u jep shkarkime të veçanta institucioneve dhe organeve të tjera dhe çdo agjencie ose entiteti të ngjashëm.

Në seancën e tij të pjesshme të Prillit 2009, në kuadrin e procedurës së shkarkimit për vitin 2007, Parlamenti shtyu shkarkimin në Këshillin e Ministrave, sepse ky i fundit refuzoi t'i jepte Parlamentit informacion të cilësuar si i rëndësishëm. Që prej kësaj kohe, shkarkimi në Këshill është shtyrë dhe refuzuar. Siç u përmend më sipër, Komisioni, institucionet e tjera dhe agjensitë duhet të raportojnë mbi veprimet e ndërmarra mbi vëzhgimet e bëra nga Parlamenti në rezolutat e shkarkimeve. Vendet anëtare duhet të informojnë Komisionin për masat që kanë marrë në përgjigje të vëzhgimeve të Parlamentit, dhe Komisioni duhet t'i marrë ato parasysh në raportin e tij të rradhës.[59]

Komitetet e specializuara të Parlamentit gjithashtu ndihmojnë për të siguruar që fondet e BE-së shpenzohen në mënyrë efikase në interesin më të mirë të taksapaguesit të BE-së. Anëtarët e Komisionit për Kontrollin e Buxhetit kanë zhvilluar, në shumë raste,

[58] Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian. (2012). OJ C 326/47

[59] Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. (2018, Korrik). *Financial Regulation applicable to the general budget of the Union.* Komisioni Europian, Bruksel.

diskutime me përfaqësuesit e komiteteve ekuivalente në parlamentet e vendeve anëtare, me autoritetet e auditimit kombëtar dhe me përfaqësuesit e agjencive doganore. (Verdins:2020).

Kërkimet në vend janë realizuar edhe nga anëtarët e veçantë për të vërtetuar fakte që paraqesin probleme të veçanta. Në Dhjetor 1995, për herë të parë, Parlamenti ushtroi të drejtën e tij sipas Traktatit për të ngritur një komitet hetimi, duke raportuar më pas për pretendimet e mashtrimit dhe keqadministrimit.[60] Traktati i Lisbonës forcon rregullimet e kontrollit që përqendrohen në rezultatet e arritura nga programet e BE-së dhe kërkon që Komisioni, si pjesë e procedurës vjetore të shkarkimeve, t'i paraqesë Parlamentit dhe Këshillit, duke marrë parasysh rekomandimet që ata kanë bërë, një raport gjithëpërfshirës vlerësimi.

**Lufta kundër mashtrimit**

Veprimi i Bashkimit Europian në fushën e kontrollit buxhetor bazohet në dy parime: të siguruarit që buxheti i BE-së të shpenzohet në mënyrën e duhur, dhe mbrojtjen e interesave financiare të Unionit dhe luftimin e mashtrimit.

Që qytetarët të jenë të sigurt se paratë e tyre po përdoren siç duhet, Bashkimi Europian duhet të mbrojë interesat e tij financiar. Është gjithashtu e rëndësishme të monitorohet dhe mbikëqyret puna e Zyrës Europiane kundër Mashtrimit (OLAF) dhe të mbështeten veprimet e saj për të luftuar mashtrimet dhe parregullsitë në zbatimin e buxhetit të BE-së.

Në Dhjetor 1995, Parlamenti për herë të parë ushtroi të drejtën e tij sipas Traktatit për të krijuar një komitet hetimi, i cili raportoi për akuzat e mashtrimit dhe keqadministrimit në sistemin e tranzitit në Komunitet. Rekomandimet e komitetit morën mbështetje të gjerë në atë kohë. Vitet e fundit është rritur numri i akteve legjislative dhe rekomandimeve për mbrojtjen e interesave financiare të Unionit.[61]

Këto akte në thelb synojnë të arrijnë objektivat e mëposhtëm: - Përmirësimin e qeverisjes së OLAF dhe forcimin e masave mbrojtëse procedurale në hetime - duke krijuar gradualisht një Zyrë Europiane të Prokurorit Publik (EPPO); - Reformimin e

[60] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Qershor). *Budgetary control.* Parlamenti Europian.

[61] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian 2020. (2020, Qershor). *Combating fraud and protecting the EU's financial interests*. Parlamenti Europian.

Eurojust dhe përmirësimin e mbrojtjes së interesave financiare të Unionit; - Garantimin e mbrojtjes së këtyre interesave me anë të ligjit penal dhe hetimeve administrative, përmes një politike të integruar për të mbrojtur paratë e taksapaguesve dhe përmes strategjisë së Komisionit kundër mashtrimit.

Me rëndësi ishin dhe komunikimet e 2012-13 që përfshinin: - Një plan veprimi për të forcuar luftën kundër mashtrimit tatimor dhe evazionit fiskal; - Mbrojtje të buxhetit të Bashkimit Europian për të përfunduar vitin 2012 (një vit më vonë); - Zbatimi i korrigjimeve neto financiare të Shteteve Anëtare për bujqësinë dhe politikën e kohezionit. Më tej u miruatuan gjithashtu 2 direktiva të 2013 që lidheshin me: - Sistemin e përbashkët të TVSH-së në lidhje me zbatimin opsional dhe të përkohshëm të mekanizmit të tarifës së kundërt në lidhje me furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të vlerësuara si të ndjeshme ndaj mashtrimit; dhe - Një mekanizëm të shpejtë reagimi kundër mashtrimit me TVSH-në. Tekste të tjera të rëndësishme përfshijnë: - Një propozim për një direktivë për luftën kundër mashtrimit për interesat financiare të Unionit me anë të ligjit penal; - Raportin e Komisionit Kundër Korrupsioni të BE-së; - Komunikimin e Komisionit në Prill 2016 për një plan veprimi mbi TVSH-në.

Kohët e fundit, për shkak të kornizës së re financiare shumëvjeçare (2021-2027), Komisioni miratoi një propozim për një program të ri anti-mashtrim të BE-së, i cili në thelb është krijuar për të replikuar dhe përmirësuar programin Hercule III (2014 -2020), dhe për ta kombinuar atë me Sistemin e Informacionit Anti-Mashtrim (AFIS) dhe Sistemin e Menaxhimit të Parregullsive (IMS), të cilat tashmë manaxhohen nga OLAF.

Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF) ka fuqinë për të kryer hetime administrative në mënyrë të pavarur nga Komisioni. Në Maj 1999, me qëllim ndjekjen e rregulloreve të hetimeve të OLAF, Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni nënshkruan një marrëveshje ndërinstitucionale për hetimet e brendshme. Kjo marrëveshje përcaktonte që çdo institucion duhet të krijojë rregulla të përbashkëta të brendshme për të siguruar zhvillimin e duhur të hetimeve të OLAF.[62]

Një pjesë e këtyre rregullave, të pasqyruara tashmë në Rregulloren e Stafit të Zyrtarëve të Bashkimit Europian, kërkojnë që stafi të bashkëpunojë me OLAF, dhe të sigurojë një shkallë mbrojtjeje për zyrtarët që zbulojnë mashtrimin ose korrupsionin e mundshëm. Reforma e OLAF fillojë të veprojë në vitin 2003. Më në fund, pas rreth 10 vite

[62] Idem.

diskutimesh dhe bisedimesh, palët e interesuara të trilogut (Parlament, Këshill dhe Komision) ranë dakord për një kompromis me përmirësime të konsiderueshme që e bëjnë OLAF të jetë efektive, efikase dhe e përgjegjshme, duke i ruajtur asaj pavarësinë hetimore. Në Nëntor 2008, Parlamenti miratoi raportin Gräßle me një shumicë dërrmuese. Ky raport ndryshoi në mënyrë thelbësore propozimin origjinal të Komisionit, duke çuar më pas në miratimin e rregullores aktuale të 2013, rishikuar në Korrik 2016.[63]

Teksti i ri bën përmirësime thelbësore, veçanërisht duke siguruar një përcaktim më të qartë të kornizës ligjore për hetimet kundër mashtrimit. Ai gjithashtu përfshin përkufizime të "parregullsisë", "mashtrimit, korrupsionit dhe çdo aktiviteti tjetër të paligjshëm që prek interesat financiare të Unionit", dhe konceptin e "operatorit ekonomik". Rregullorja gjithashtu përmban referenca të qarta për masat specifike hetimore sipas rregulloreve të tjera të BE-së (duke përmirësuar kështu koordinimin midis instrumenteve juridikë në fushën në fjalë), si dhe referenca të Kartës së të Drejtave Themelore. (Mathis:2020).

Të drejta të tjëra që mbrohen gjithashtu nga rregullorja gjatë hetimeve të OLAF përfshijnë: të drejtën për mbrojtje dhe garanci procedurale të personave të interesuar nga një çështje nën hetim nga OLAF, të drejtat e dëshmitarëve dhe njoftuesve, dhe të drejtat e qasjes në procesverbal dhe dokumentacione të tjera përkatëse. Për më tepër, ka dispozita të posaçme për kërkesa specifike për vendet anëtare, të tilla si kërkesa për të ndarë informacione të rëndësishme me OLAF për rastet e mashtrimit që përfshijnë fondet e BE-së.

Si përfundim, u krijua një procedurë e re ndërinstitucionale e cila lejon të gjitha institucionet të zhvillojnë diskutime transparente mbi praktikat më të mira, rezultatet dhe çështjet e pazgjidhura që minojnë efektivitetin e operacioneve kundër mashtrimit. Kjo do të thotë që për herë të parë Parlamenti mund të diskutojë luftën kundër mashtrimit në Shtetet Anëtare me Këshillin. Parlamenti gjithashtu ka bërë thirrje për përmirësime në qeverisjen e OLAF përmes rishikimit dhe konsolidimit të vazhdueshëm të proceseve të tij thelbësore hetimore.

[63] Mathis, A. (2020, Qershor). *Combating fraud and protecting the EU's financial interests.* Parlamenti Europian.

Neni 325 i TFEU kërkon bashkëpunim të ngushtë dhe të rregullt midis Shteteve Anëtare dhe Komisionit, dhe gjithashtu lejon që masa specifike të Këshillit të sigurojnë mbrojtje ekuivalente dhe efektive të interesave financiare të BE-së në vendet anëtare.[64]

Forcimi i mekanizmave me kërkesë të Parlamentit, Komisioni miratoi nisma të mëdha për masat strategjike kundër mashtrimit.(Mathis:2020). Sidoqoftë, duke marrë parasysh shkallën e mashtrimit, shmangies së taksave dhe korrupsionit në BE, Parlamenti ka bërë thirrje për një qasje të integruar, përfshirë strategjitë për luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit përmes masave ligjore efektive në të gjithë Bashkimin, veçanërisht në një kohë me kufizime buxhetore . Parlamenti ka mbështetur gjithashtu Planin e Veprimit të Komisionit për të forcuar luftën kundër mashtrimit tatimor dhe evazionit fiskal, duke insistuar se Komisioni dhe vendet anëtare duhet të vazhdojnë t'i japin përparësi absolute kësaj lufte.

Kjo do të thotë zhvillimin e një strategjie për bashkëpunim dhe koordinim të përmirësuar dhe shumëdimensional midis vetë vendeve anëtare, si dhe marrëdhënies së tyre në raport me Komisionin. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet gjithashtu zhvillimit të mekanizmave për parandalimin, zbulimin e hershëm dhe monitorimin e tranzitit doganor. Kjo e fundit është një zonë ende e prekur nga nivelet e larta të korrupsionit sistematik në Europë. (Mathis:2020).

Parlamenti ka kuptuar më në fund se aktorët kryesorë europianë duhet të jenë më aktivë ndërkombëtarisht dhe të punojnë për të vendosur standarde të bashkëpunimit mbështetur kryesisht në parimet e transparencës, qeverisjes së mirë dhe shkëmbimit të informacionit. Parlamenti gjithashtu ka nënvizuar se transparenca më e madhe lejon kontrollin e duhur, dhe kështu është thelbësore për zbulimin e mashtrimit. Disa vite më parë ajo i kërkoi Komisionit të ndërmarrë veprime për të siguruar transparencë të plotë për të gjithë përfituesit e fondeve të BE-së në vendet anëtare duke publikuar një listë me të dhëna për ta në faqen e internetit të Komisionit. Ai gjithashtu u ka bërë thirrje vendeve anëtare të bashkëpunojnë me Komisionin dhe të japin informacion të plotë dhe të besueshëm për përfituesit e fondeve të BE-së që ata menaxhojnë.[65]

---

[64] Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian. (2012). OJ C326/47

[65] Mathis, A. (2020, Qershor). *Combating fraud and protecting the EU's financial interests.* Parlamenti Europian.

Korrupsioni duhet të konsiderohet se është mashtrim sipas nenit 325 (5) të TFEU përsa kohë ka një ndikim në interesat financiare të BE-së sipas mendimit të Parlamentit dhe të përfshihet në raportin vjetor të Komisionit për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Europian dhe luftën kundër mashtrimit.[66] Në fillim të vitit 2019, Gjykata Europiane e Auditorëve theksoi se BE-ja duhet të forcojë luftën e saj kundër mashtrimit dhe se Komisioni duhet të marrë një rol udhëheqës në këtë drejtim dhe të rishqyrtojë rolin dhe përgjegjësinë e zyrës së saj në këtë fushë.[67]

Komisioni paraqiti një strategji të re në Prill 2019, që synon përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe koordinimit më të mirë në luftën kundër mashtrimit midis departamenteve të ndryshme të Komisionit. Kjo strategji gjithashtu hap rrugën për më shumë masa sipas analizës së të dhënave të mbledhura në vite kundra mashtrimit për një manaxhim më të mirë në vitet e ardhshme. Ajo plotëson Qeverisjen e Komisionit, miratuar në Nëntor 2018 dhe cakton OLAF si shërbimin kryesor në hartimin dhe zhvillimin e një politike europiane kundër mashtrimit. Parlamenti mirëpriti përparësitë e reja të kësaj strategjie, siç ishin përmirësimi i të kuptuarit të modeleve të mashtrimit, profilizimi i mashtruesve dhe dobësive sistematike lidhur me mashtrimet që ndikojnë në buxhetin e BE-së.

Shteteve Anëtare ju kërkua që të zbatojnë Direktivën (BE) 2017/1371 ( ndryshe PIF) për luftën kundër mashtrimit për interesat financiare të Unionit përmes përkthimit të ligjit penal në ligjet e tyre kombëtare në Korrik 2019. Rregullat e reja rrisin nivelin e mbrojtjes së buxhetit të BE-së duke harmonizuar përkufizimet, sanksionet dhe periudhat e kufizimit të veprave penale që prekin interesat financiare të Unionit.

Jo vetëm që Direktiva është një instrument thelbësor për harmonizimin e ligjit penal të shteteve anëtare mbi krimet kundër buxhetit të Unionit, por gjithashtu vendos themelet për Zyrën e Prokurorit Publik Europian,  i cili do të hetojë, ndjekë penalisht dhe do të sjellë në gjykim krimet kundër buxhetit të BE-së.

Rregullat që rregullojnë krijimin e Zyrës së Prokurorit Publik Europian janë të detajuara në nenin 86 të TFEU, në të cilin citohet se: 'për të luftuar krimet që prekin interesat financiare të Unionit, Këshilli , me anë të rregulloreve të miratuara në përputhje me një

[66] Versioni  i Konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian. (2012). OJ C326/47

[67] Fact Sheets on the European Union 2020. (2020, Qershor). *Combating fraud and protecting the EU's financial interests.* Parlamenti Europian.

procedurë të veçantë legjislative, mund të krijojë një Zyrë të Prokurorit Publik Europian nga Eurojust.' Rregullorja për krijimin e Prokurorisë Publike Europiane u miratua në procedurën e zgjeruar të bashkëpunimit në Tetor 2017, dhe hyri në fuqi një muaj më pas.[68]

Aktualisht, ka 22 vende pjesëmarrëse. Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Çekia, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Hollanda, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Spanja dhe Sllovenia. Zyra e Prokurorit Publik Europian do të jetë një zyrë e decentralizuar e prokurorisë së Bashkimit Europian me kompetencë ekskluzive për hetimin, ndjekje penale dhe gjykim kundër krimeve ndaj buxhetit të BE-së. Ai do të ketë fuqi unike hetimore në të gjithë Bashkimin bazuar dhe integruar në sistemin e ligjit kombëtar të vendeve anëtare.

Gjithashtu është në ngritje Zyra e Prokurorit Publik Europian me qëllim që ai të bëhet funksional në fund të vitit 2020. Selia e Zyrës së Prokurorit Publik Europian do të jetë në Luksemburg. Në Shtator 2019, Parlamenti dhe Këshilli ranë dakord të caktojnë Znj Laura Codruta Kövesi si Kryeprokuroren e parë Europiane.[69] Ajo do të zë këtë post për një afat jo të rinovueshëm prej shtatë vjet.

Komiteti i Kontrollit Buxhetor të Parlamentit zhvillon seanca dëgjimore për anëtarët e caktuar të Gjykatës së Auditorëve, si dhe kandidatët në listën për postin e Drejtorit të Përgjithshëm të OLAF. Këto shpallje nuk mund të plotësohen pa seancat dëgjimore parlamentare. Drejtori i Përgjithshëm i OLAF emërohet nga Komisioni, pas konsultimit me Parlamentin dhe Këshillin, ndërsa anëtarët e Komitetit Mbikëqyrës të OLAF emërohen me marrëveshje ndërmjet Parlamentit, Këshillit dhe Komisionit.

## KAPITULLI I DYTË - Çështjet më të diskutuara në raport me politikat kryesore të BE-së pas Traktatit të Lisbonës

[68] Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian. (2012). OJ C 326/47

[69] Mathis, A. (2020, Qershor). *Combating fraud and protecting the EU's financial interests.* Parlamenti Europian.




**II.A. Edukimi dhe punësimi në BE sfiduar nga kultura dhe teknologjia**




2020 ishte viti i finalizimit të shumë programeve mbi të cilat u ndërtuan të tjera, parimisht, më solide, të qëndrueshme dhe efektive drejt një unifikimi që siguron përfshirjen sociale dhe rritjen ekonomike. Programet me ndikim më të lartë në arsim, kërkim dhe kulturë, përkatësisht Erasmus + 2021-2027, Horizon Europe dhe Creative

Europe, u lançuan në dy vitet e fundit, duke vendosur rrugën drejt së cilës mund të parashikohet e ardhmja e rinisë. Në këto programe dimensioni ndërkufitar vlerësohet si qasja ndaj qytetarëve europianë të cilët ndjekin zhvillimin intelektual dhe kulturor përtej përfitimeve personale, duke kontribuar për komunitetin dhe shoqërinë duke e bërë kapitalin njerëzor më të punësueshëm dhe më të avantazhuar në terma të konkurrencës.

Ndryshe nga politikat që lidhen me legjislacionin dhe sigurinë, politikat që kanë të bëjnë me arsimin janë të vështira për t'u imponuar, sepse nga njëra anë ata mbështeten në vullnetin dhe përgjegjësinë e qytetarëve dhe subjekteve qeverisëse zgjedhur nga ata për të përmirësuar veten dhe nga ana tjetër efekti i tyre në afatshkurtër rëndon individët dhe rrethin e tyre (familja dhe komuniteti). Sfida aktuale është me grupin që presupozohet më aktiv dhe më i suksesshëm i popullatës (rinia) potenciali i të cilit kushtëzohet nga shkalla në të cilën shfrytëzohet kapaciteti njerëzor. Për këtë arsye, edukimi dhe punësimi marrin një vëmendje të veçantë sepse përgjithësisht janë të përqendruara në këtë periudhë jetësore.

Ky nënkapitull përpiqet të dëshmojë se si kultura dhe teknologjia, si ndikuesit kryesorë të ndryshimit social-politik-ekonomik, kanë sfiduar arsimin dhe punësimin e të rinjve, për të pasur një këndvështrim më të qartë për mundësinë e vërtetë të programeve për të pasur sukses.

Liria e lëvizjes është parimi themelor i Bashkimit Europian (BE). Konkretisht lëvizja e lirë e fuqisë punëtore është një nga katër parimet kryesore përveç lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Për ta siguruar atë, duhet të ketë një lloj standardizimi për të lehtësuar lëvizjen, në drejtim të aftësisë njerëzore. Ky standardizim duhet të interpretohet në këtë kontekst si emërues i zakonshëm ose një matës i vetëm i njësisë për mundësinë e lëvizjes së lirë.

BE e pranon arsimin si një instrument shumë të rëndësishëm për arritjen e këtyre parimeve dhe bashkimin e Europës. Të gjitha problemet e hasura në dekadën e fundit, veçanërisht krizat (financiare dhe e migracionit) sollën përsëri në pah se sa e rëndësishme është të frymëzohen të rinjtë për të qënë qytetarë të përgjegjshëm dhe përfaqësues për sa i përket aftësive, jo vetëm për përfitim ekonomik. Kështu që rritja, lëvizshmëria dhe punësueshmëria marrin një fokus të veçantë kur diskutohet për rininë.

Duke qenë se politikat e arsimit vendosen në nivelin e Shtetit Anëtar, BE lehtëson bashkëpunimin midis anëtarëve, duke mbështetur njohjen e ndërsjellë të diplomave dhe nxitur lëvizshmërinë. (Salm & Klugman: 2017)

*II.A.1. Edukimi: sa të punësueshëm dhe sa punësohen të rinjtë në BE*

Arsimi duhet të kuptohet si një proces për të arritur një qëllim përfundimtar, jo vetë qëllimin përfundimtar në vetëvete. Vetë qëllimi përfundimtar, kur nuk është kënaqësia e arritjes së një niveli më të lartë intelektual dhe kulturor në aspektin personal, është qëllimi për të zënë punë dhe për të kënaqur nevojën e të siguruarit përtej aspektit personal.

Është vendimi personal i secilit njëri, ndonjëherë zgjidhja, për të marrëë vendimin se si të vazhdohet në rrugën e jetës si një qenie aktive dhe e aftë njerëzore. Bërja e zgjedhjes së një arsimimi dhe / ose punësimi të pështatshëm- të drejtë-të përgjegjshëm- të përballueshëm, ndikohet nga mjedisi dhe mundësitë ndaj të cilave një person është i ekspozuar.

Arsimi merr forma të ndryshme, ku më të zakonshmet janë: formale, informale dhe joformale ose nga një këndvështrim tjetër, akademik dhe jo-akademik. Por arsimi fillon në një fazë shumë të hershme të zhvillimit të një qenie njerëzore. Sfida është të paturit e aftësive të mira themelore (shkrim-lexim, numeracion dhe shkencë) së bashku me të menduarit kritik dhe krijimtarinë dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve në mënyrë që të shkoni në nivele më të larta të arsimit/punësimit. (Katsarova: 2017).

Kjo e fundit varet nga arsimtarët dhe trainerët e mirë. Këta duhet të jenë individë që vijnë nga një bazë e fortë e aftësive themelore, të cilët ndërthurin mirë njohuritë teorike dhe praktike dhe sistemi duhet të sigurojë që transmetimi-asimilimi i njohurive është i efektshëm, i vërejtur në aftësinë e studentëve për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës.

Punimi me temë "Të mësuarit e karrierës në BE: Pse djemtë nuk duan të jenë mësues?", adreson vështirësinë për të zhvilluar programe që përgatisin plotësisht mësuesit për profesionin në praktikë dhe domosdoshmërinë për të ngritur statusin dhe atraktivitetin e profesionit mësimor që aktualisht është duke hasur probleme si popullsia e mësuesve në plakje, mungesa e mësuesve, pak mësues të rinj dhe pabarazitë e rëndësishme gjinore në personel në nivele të ndryshme të arsimit për shkak të konstruksionit shoqëror të feminitetit dhe maskilitetit, pagës së ulët dhe punës stresuese, jo tërheqëse, nevojë për

më shumë durim, tipare që lidhen më shumë me rolin e nënave. Zgjidhjet e dhëna për këtë problem janë pranimi më shumë nga shoqëria e mësuesve, investimi në to dhe pajisja e tyre me aftësi TIK, aftësi sipërmarrëse dhe teknika arsimore gjithëpërfshirëse në përputhje me zhvillimet e fundit, pagesa dhe kushte pune më të mira, trajnime të mëtejshme dhe më shumë mbrojtje nga dhuna dhe ngacmimet në institucionin arsimor. (Katsarova: 2020).

Lidhur me shkrim-leximin, në studimin e Kërkimit për Komitetin CULT - Shkenca dhe Shkrimi- Leximi Shkencor si Sfidë Arsimi, u deklarua se BE është e kërcënuar nga përhapja e keqinforminit, dezinformimi dhe pseudo-shkenca. Zgjidhja për të përgatitur qytetarë të shkolluar shkencërisht u parashtrua në 6 pika: 1. Konceptualizimi i arsimimit shkencor në kornizat e kurrikulës dhe kompetencave, 2. Adresimi i kërcënimeve që lidhen me përhapjen e keqinformimit dhe dezinformimit, 3. Mbështetja e inovacionit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës në arsimin shkencor, 4. Hartimi i instrumenteve adekuat për vlerësimin e arsimit (shkrim-leximit) shkencor, 5. Ndërtimi i kapaciteteve në mësues për të nxitur arsimin (shkrim-leximin) shkencor, 6.Promovimi i hulumtimeve pjesëmarrëse dhe shkencës së hapur. (Siarova & Starnadel & Szonyi: 2019).

Mësimi joformal konsiderohen programet që ofrojnë aftësi themelore, zgjidhin çështje të caktuara, trainojnë për një punë specifike, ndërthurin teori me praktikë ose specializohen në fushë specifike. Ato mund të jenë në formën e kurseve të shkurtra, workshopeve dhe seminareve. Përdoren kryesisht për të siguruar qasje në arsim të lartë zyrtar për të rritur. Problemi që i bën ata jo shumë të ndjekur është vlefshmëria e tyre, për pasojë ato nuk njihen me të njëjtin seriozitet të një kursi për shembull të shprehur në kredite. Nga ana tjetër, vlerësimi do të ketë nevojë për bashkëpunim të tregut të punës, sistemit arsimor dhe organizatave të përfshira me këto aktivitete OJQ.[70]

Punësueshmëria është matja cilësore e një pune sa i përket aftësive, qëndrimeve dhe atributeve që të punësohen dhe të funksionojnë me sukses në rolet e kërkuara.[71]

Për personat që nuk vazhdojnë arsimin e lartë klasik, një mundësi e dytë është arsimi dhe aftësimi profesional. Por kjo përsëri është një proces dhe kështu që duhet të

[70] Chircop, D., Clarós, E. (2018, Dhjetor). *Infographic Lifelong Learning*. *Non-Formal Learning: Access and Validation.* Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE *630.331*

[71] Yaqoob, N. (2016, Korrik) Employment vs Employability. Marrë nga https://fromtheresearchdesk.ëordpress.com/2016/07/10/employment-vs-employability/

azhurnohet në mënyrë të vazhdueshme për të vazhduar me dinamikën e kërkesave të tregut të punës. Në lidhje me këtë ajo nuk mund të shihet si vetëm një mundësi e dytë për personat më pak akademikë, por edhe si një domosdoshmëri trainimi gjatë gjithë jetës. Sa më pak zhvillohen aftësitë e punës, aq më e madhe është mundësia për të humbur vendin e punës. Edhe pse këtu lind një problem: shpërndarja e padrejtë e fuqisë punëtore që krijon punë të nën dhe mbikualifikuar e cila mund të kanalizohet përmes mekanizmave më të mirë të monitorimit në një nivel kombëtar në rekrutim, kontakte afatshkurtra etj.

Kërkesa për aftësi realizohet nga: dixhitalizimi, globalizimi, ekonomia e gjelbër dhe tendencat demografike.[72] Duke qenë se dixhitalizimi deri më tani nuk ka provuar të automatizojë punën deri në pikën e zvogëlimit të kërkesës për punë, është e qartë se ai nxit drejt një furnizimi shumë të aftë dhe të kualifikuar pune, punë të reja (veçanërisht punë të kujdesit), rritje në vitet aktive të punës. Globalizimi nga ana tjetër është duke e zhvendosur ekonominë industriale në ekonominë e dijes.

Problemi i krijuar këtu është tek ata që nuk arrijnë nivelin e mjaftueshëm të kualifikimit arsimor dhe lënë arsimin dhe aftësimin dhe nuk mund të kapin dinamikën e mjedisit të punës. Zgjidhja mund të jetë që të azhornohen aftësitë vazhdimisht gjatë gjithë jetës, të ofrohen mundësi për ta bërë këtë dhe të kenë stimuj / inkurajim për të ndërmarrë aktivitete të tilla.

Duke promovuar studime jashtë vendit dhe duke lehtësuar lëvizshmërinë (mobilitetin), të rinjtë kanë provuar të zhvillojnë aftësi të reja si rritje të shanseve për punësim, përshtatje dhe fleksibilitet, njohuri të gjuhëve dhe kulturave të ndryshme, të përkthyera në kompetenca ndërkulturore, rritje të vetë-efikasitetit / besimit / ndërgjegjësimit. Sidoqoftë, ndërsa politikat e arsimit vendosen në nivelin e Shteteve Anëtare, roli i BE-së mbetet lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve, ndërsa mbështet njohjen e ndërsjellë të diplomave dhe nxitjen e lëvizshmërisë. (Salm & Klugman: 2017).

Sipas studimit mbi "Zhvillimin e aftësive dhe punësimi" për Komitetin e Punësimit dhe Punëve Sociale, format kryesore të zhvillimit të aftësive për të rritur punësueshmërinë e

[72] Hogarth, T. (2019, Shtator). *Skills for the labour market: EU policies for VET and upskilling*. Parlamenti Europian, Departamenti i Policisë për Politikat mbi Ekonominë, Shkencën dhe Cilësinë e Jetës. Bruksel, Belgjikë. PE 638.431

qytetarëve në një treg pune vazhdimisht në ndryshim janë: praktika (si një formë e VAT), stazhet (intership-et) dhe vullnetarizmi.[73]

Bashkimi Europian ka zhvilluar struktura dhe politika të veçanta për të mbështetur aktivitetet e AAP(Arsimi dhe Aftësimi Professional). CEDEFOP (Qendra Europiane për Zhvillimin e Aftësimit Profesional) që mbështet zhvillimin dhe zbatimin e politikave të AAP. Fondacioni Europian i Trajnimit që mbështet reformimin e arsimit dhe sistemeve të trajnimit. Përgjatë kësaj, politikat kryesore përfshijnë: Kornizën Europian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin dhe Trajnimin Profesional, kompetencat kryesore të kurrikulave të AAP dhe trajnimit gjatë gjithë jetës, Garanti i Rinisë, Korniza e Cilësisë për Praktikim dhe Korpuset e Solidaritetit Europian etj., Ku më të rëndësishmet janë Arsimi dhe Trajnimi 2020, Shtylla Europiane e të Drejtave Sociale dhe Axhenda e Aftësive të Reja.

Axhenda është një paketë masash për të sjellë përmirësime në tre fusha: 1. Kompetencat themelore, 2. Dukshmërinë dhe krahasueshmërinë e kompetencave, 3. Tregun e punës dhe inteligjencën e aftësive për të lehtësuar vendimet efektive të karrierës në fushat e arsimit, trajnimit dhe (pa-) punësimit.[74] Ai i kushton vëmendje të veçantë orientimit të punësimit përmes 'aftësive të menaxhimit të karrierës' për të kanalizuar më mirë aftësitë, interesat dhe mundësitë për arsim dhe punësim. Sigurimi efektiv i drejtimit gjatë gjithë jetës kërkon programe dhe politika në një këndvështrim të kryqëzuar, si dhe në secilën nga fushat përkatëse: 1. arsimin (shkollat), 2. arsimin dhe aftësimin profesional, 3. arsimin e lartë, 4. edukimin e të rriturve, 5. punësimin ( për njerëzit që punojnë, punëtorët e moshuar dhe të papunë) dhe 6. përfshirja sociale (p.sh. lënia dhe braktisja e hershme e shkollës, papunësia afatgjatë ose paaftësia), 7. lëvizshmëria (mobiliteti) ndërkombëtare në arsim dhe punësim (p.sh. ERASMUS, EURES, Euroguidance) (Kraatz:2017). Aftësitë e menaxhimit të karrierës dëshmojnë se parandalojnë braktisjen

[73] Broek, S., Hogarth, T., Baltina, L., Lombardi, A. (2017, Prill). *Skills Development and Employment: Apprenticeships, Internships and Volunteering* (studim i plotë) Drejtoria e Përgjithshme për Politikat e Brendshme-Departamenti i Policisë A: Politika Shkencore dhe Ekonomike.

[74] Kraatz, S. (2017, Shtator). *New Skills Agenda for Europe: State of implementation*. Parlamenti Europian, Departamenti i Policisë për Politikat Shkencore dhe Ekonomike. Bruksel, Belgjikë. PE 607.334

e shkollës, rrisin arritjen arsimore, rrisin vetëdijen për marrjen e vendimeve të bazuara mbi arsimin dhe pas arsimit, në karrierë.[75]

Punësimi nga ana tjetër është përplasja e forcave shoqërore dhe politike, nga të cilat një biznes përpiqet të arrijë qëllimin e tij kryesor: maksimizimin e fitimit.

Ndryshimet në strukturën e punësimit mund të japin një pasqyrë mbi zhvillimin e aftësive. Teknologjia dhe globalizimi sollën polarizimin e punësimit (rritje të hendekut midis të kualifikuarve të lartë dhe të kualifikuarve të ulët) dhe kosto të ulët të punës që ul kompensimin.[76]

A është detyra e institucionit qeverisës të pozicionohet për të identifikuar se ku ka nevojë për të ndërhyrë për të riaftësuar apo azhornuar aftësite. BE ka mbështetur vendet me politika në lidhje me këtë, por megjithatë sistemet e AAP-së duhet të funksionojnë në një nivel kombëtar për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive me forcë pune të trajnuar ndaj ndryshimeve të tregut të punës.

Intervali midis arsimit dhe punësimit ofron një platformë të mirë për të dëshmuar potencialin dhe vullnetin për të zgjidhur problemet që lidhen me pjesën më aktive dhe performuese të shoqërisë, rinisë dhe punonjësve.

Gjatë konsiderimit të këtij intervali është e rëndësishme për të adresuar disa çështje: plakja e qëndrueshme e popullsisë së BE-së, cilësia dhe relevanca e arsimit zyrtar, më pak të rinjtë me përvojë të papunësuar, për pasojë pagesa të ulëta, vështirësia për të punuar gjatë arsimimit, pozicioni i tregjeve kombëtare të punës, karakteristikat strukturore të tregjeve të punës, pabarazitë sociale. (Katsarova: 2016)

Pavarësisht nga dispozitat e BE-së për aftësimin profesional, shkëmbimin e të rinjve dhe angazhimin në bashkimin europian në lidhje me lirinë dhe të drejtat e gjithësecilit,

---

[75] Kraatz, S. (2017, Tetor). *Skills development and employment: the role of career management skills*. Parlamenti Europian, Departamenti i Policisë për Politikat Shkencore dhe Ekonomike. Bruksel, Belgjikë. PE 607.359

[76] Hogarth, T. (2019, Shtator). *Skills for the labour market: EU policies for VET and upskilling*. Parlamenti Europian, Departamenti i Policisë për Politikat mbi Ekonominë, Shkencën dhe Cilësinë e Jetës. Bruksel, Belgjikë. PE 638.431

politikat veçanërisht ato që lidhen me edukimin zbatohen përmes koordinimit me metodën e hapur, që do të thotë se BE-ja nuk imponon politika.[77] Sidoqoftë, iniciativat e Unionit për punësimin e të rinjve janë të shumta: Strategjia e Rinisë e BE-së, Strategjia e Europës 2020 (shkalla e braktisjes së shkollës me më pak se 10% dhe 40% e 30-34 vjeç që kanë një diplomë të arsimit të lartë), ET 2020, Rinia në Lëvizje, Paketa e Punësimit të Rinisë që themeloi Garantuesin e Rinisë e financuar përmes Iniciativës së Punësimit të Rinisë, Aleanca Europiane për Mësimdhënie, Korniza e Cilësisë për Praktikime, Rrjeti i Shërbimeve të Punësimit Publik, Pakti Europian për Rininë, Trupat e Solidaritetit Europian dhe të fundit, por jo më pak të rëndësishmet, Horizon Europa, Erasmus 2021-2027 dhe Europa Kreative.

Një kategori në këtë interval që kërkon vëmendje të veçantë janë NEET. NEETs është akronimi i përdorur për t'u referuar të rinjve që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim ose të papunët (ata që nuk mund të gjejnë punë) dhe joaktivët (ata që nuk kërkojnë punë). (Lecerf: 2017). Studimet i kanë kategorizuar ato në më shumë nën-grupe për të dhënë një panoramë më të qartë të përbërjes së NEET.

Dallimi në përbërjen e NEET midis vendeve mund të ndihmojë në identifikimin e problemeve më lehtësisht dhe adresimin e tyre në mënyrë korrekte, duke punuar me politika më efikase. Faktorët që shkaktojnë këtë ndryshim janë përgjithësisht demografikë: gjinia (më shumë femra në NEET se meshkujt), mosha (rritja e NEET me moshën), arsimi (më pak të arsimuar në NEET). Punësimi ndikohet nga përgjegjësitë e familjes, paaftësia dhe dekurajimi nga papunësia afatgjatë.[78]

*II.A.2. Edukimi dhe kultura në BE*

Fjalori anglisht i Oksfordit e përcakton kulturën si "artet dhe manifestimet e tjera të arritjeve intelektuale njerëzore të konsideruara në mënyrë kolektive" ose "idetë, zakonet dhe sjelljet shoqërore të një populli ose shoqërie të caktuar". Si e tillë, kultura zë vendin më të rëndësishëm në një diskutim për arsimin, veçanërisht për BE-në dhe shoqëritë e saj multikulturore.

---

[77] Katsarova, I. (2016, Mars). *The EU's youth initiatives: Closing the gap between education and employment*. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 579.085

[78] Lecerf, M. (2017, Mars). NEETs: *Who are they? Being young and not in employment, education or training today*. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 599.360

Më herët në këtë nënkapitull, përmendëm rëndësinë e të menduarit kritik dhe krijimtarisë dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve, për të përparuar në arsim dhe punësim. Kultura është instrumenti më i mirë për ta lehtësuar këtë. Nëpërmjet teknologjisë, sot individët kanë qasje në kulturë dhe art por prapëseprapë ai duhet të edukohet gjithashtu i rregulluar dhe strukturuar nga institucionet arsimore. Mësimi informal dhe joformal mund të përdoren për këtë.

Edukimi kulturor dhe artistik në kurrikulat shkollore të detyrueshme, kur mësohet në mënyrë të barabartë me lëndët e tjera dhe i qasemi në mënyrë eksperimentale, u ofron fëmijëve një zonë për eksplorim dhe mësim përmes përvojës dhe vetë-shprehjes (Pasikoëaska-Schnass:2017).

Shoqëria nga ana tjetër vepron në kushte të civilizimit, që do të thotë se ajo gjithmonë shtyn të përparojë më lart në zhvillimet kulturore dhe shoqërore, gjithnjë në respekt të demokracisë, qytetarisë dhe diversitetit. Ajo ka nevojë për një ndjenjë të përkatësisë, por gjithashtu duhet të përvetësojnë ndryshimet në mjedisin mësimor dhe atë të punës.

Programi Europa për Qytetarët është platforma më e rëndësishme për të adresuar dhe promovuar qytetarinë që tejkalon statusin ligjor dhe të drejtën zgjedhore. Objektivat e EfC janë thelbësore për forcimin e qytetarisë dhe demokracisë në BE dhe për këtë arsye është e rëndësishme që vendimmarrja në lidhje me elementet thelbësore të programit të kryhet në aktin themelor për të siguruar legjitimitetin demokratik të vendimmarrjes. Një studim për Komitetin CULT - Europa për Qytetarët: Drejt gjeneratës së programeve të tjera, rekomandoi veprime të mëtejeshme për të rritur kohezionin tematik dhe thjeshtësinë e programit që objektivat e tij të përmbushen të gjitha së bashku. Për këtë u rekomandua që të programohet në mënyrë sa më konsistente rreth qytetarisë, pjesëmarrjes dhe demokracisë që janë temat thelbësore të programit. (Makinen: 2018).

Një çështje tjetër e komunikimit ndërkulturor është gjuha. Gjuha është mënyra kryesore që një vend shpreh kulturën dhe autonominë e saj për sa i përket identitetit. Një gjuhë e vetme për Europën nuk është e mundur sepse përparësia është ruajtja e demokracisë, transparencës dhe llogaridhënies.[79] Sidoqoftë, shumëgjuhësia është një hap përpara për të kapërcyer kufijtë (pengesat), për të zgjeruar kulturën, për të qenë më pranues,

[79] Katsarova, I. (2019, Shtator). *Multilingualism: The language of the Bashkimi Europian*. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 642.207

mirëkuptues, tërheqës për sa i përket konkurrencës, një shoqëri më e arsimuar dhe kulturuar që ende ruan diversitetin.

BE promovon shumëgjuhësinë përmes qëllimit për qytetarë që janë të aftë në gjuhën amtare, plus 2 gjuhë të tjera. Por arritja e këtij qëllimi ka hasur në shumë pengesa nëse konsiderrojmë tregun e vetëm dixhital, sepse gjuhët më të vogla nuk mund të arrijnë teknologjitë gjuhësore. Për këtë BE lançoi në 2015 Axhendën Strategjike për Tregun e Vetëm Multilingual Dixhital që kishte në programin e tij kryesor shërbimet e teknologjisë gjuhësore.[80]

*II.A.3. Edukimi dhe teknologjia në BE.*

Dixhitalizimi dhe teknologjia kanë revolucionarizuar të gjithë aspektet e jetës, nga ekonomia tek kultura dhe politika. Arsimi merr një rëndësi të veçantë këtu sepse është një proces, siç theksohet më herët në këtë nënkapitull, dhe kështu ecën paralel me zhvillimet. Referuar arsimit që çon në individë të aftë që reagojnë në mënyrë efikase ndaj ndryshimeve veçanërisht në aktivitetet që do të sigurojnë jetesën (punësimi-tregu i punës), ekspozimi dixhital është thelbësor. Fitimi i aksesit dixhital kushtëzohet nga aftësia e vetë personave për të arritur këtë gjë. Sidoqoftë, mosha, niveli i arsimimit dhe aftësive, teknologjia dhe infrastruktura në mjedisin e të mësuarit / punës ushtrojnë presion ndaj vendimit për arsim dhe punësim.[81]

Kalimi nga aftësitë *hard skills* në aftësitë *soft skills* erdhi si një domosdoshmëri për t'iu përshtatur tregut të punës dhe qytetarisë së mëtejshme europiane. Në lidhje me këtë, arsimi është i vetmi instrument për të siguruar një përgatitje të mirë të nxënësve të çdo moshe, të cilët më pas shkojnë të kërkojnë punë. Vlerat europiane të dinjitetit dhe të drejtës së njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë dhe sundimit të ligjit mund të futen përmes teknologjisë së integruar në një arsim gjithëpërfshirës shoqëror. Duke theksuar rëndësinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, edukimi informal dhe joformal përmes arsimit dixhital mund të ofrojë një formim adekuat të nxënësve, mësuesve, punonjësve që performojnë shumë dhe kompensohen në mënyrë të drejtë për përpjekjen e tyre, duke kontribuar në të njëjtën kohë edhe në shoqëri. Avantazhi i diferencimit që krijon çdo

[80] Pasikowska-Schnass, M. (2018, Shtator). *Languages and the Digital Single Market*. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 625.197

[81] Chircop, D., Claros, E. (2019, Tetor). *Adult learners in a digital world*. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 640.141

person apo aktor në këtë nivel, do të çojë në një konkurrencë më të drejtë, për sa i përket punësueshmërisë, që përkthehet në rritjen ekonomike dhe rritjen e standardit të jetës.

Një studim i Njësisë së Parashikimit Shkencor, konkretisht Paneli për të Ardhmen e Shkencës dhe Teknologjisë, me temën "Rishikimi i arsimit në epokën dixhitale", identifikoi 4 palë të interesuara në epokën e arsimit dixhital: hartuesit e politikave dhe administratat publike, studentët, edukatorët, biznesin dhe punëdhënësit. Gjithashtu rekomandoi 4 instrumente gjithëpërfshirëse që krijuesit e politikave në BE mund të zgjedhin në mënyrë që të rregullojnë arsimin duke iu përgjigjur ndryshimeve të shpejta teknologjike: përfshirjen e arsimit në epokën dixhitale në kornizat e kërkimit ekzistues dhe të ardhshëm për të promovuar më tej politikën e bazuar në prova, duke mbështetur krijimin e një platformë të shkëmbimit të njohurive për arsimin në epokën dixhitale, duke thjeshtuar dhe harmonizuar njohjen dhe vlefshmërinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, dhe duke ofruar një zgjidhje të harmonizuar, e megjithatë të gjithëanshme për sigurimin e burimeve arsimore (të hapura) me cilësi të lartë. (Braun, Marz, Mertens të & Nisser: 2020).

Përfitimet që teknologjia dhe zhvillimi i saj i kanë sjellë shoqërisë janë të pamohueshme dhe mund të dallohen lehtësisht. Sidoqoftë, ajo gjithashtu ka dëshmuar se ka efekte negative në një nivel individual, veçanërisht në 2 drejtime: shëndetin (varësia) dhe kulturën dhe shoqërinë.[82] Në një studim tjetër të Njësisë së Parashikimit Shkencor, konkretisht Panelit për të Ardhmen e Shkencës dhe Teknologjisë, mbi "Përdorimin e dëmshëm të Internetit Pjesa I & II", u identifikuan 3 probleme shëndetësore: varësia e përgjithësuar nga interneti, varësia nga lojërat në internet, varësia nga lojërat e fatit në internet. Sa i përket problemit në drejtimin shoqëror dhe kulturor janë identifikuar 8 efekte të dëmshme: varësia nga interneti, cënimi i zhvillimit njohës, mbingarkesa e informacionit, efektet e dëmshme në njohuri dhe besim, cënimi i kufijve publik / privat, cënimi i marrëdhënieve shoqërore, cënimi i komuniteteve, demokracisë dhe qytetarisë demokratike. Këto përveç llojeve / aspekteve të tjera të cënimit, si cënimi i intimitetit, siguria kibernetike, krimi kibernetik etj.

[82] Brey, Ph., Gauttier, S., Milam, P., Njësia e Parashikimit Shkencor. (2019, Janar). *Harmful internet use. Part II: Impact on culture and society*. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 624.269

Nga i njëjti studim ka rezultuar se adoleshentët e arsimuar dhe meshkujt e rinj ishin më të predispozuar për të zhvilluar një varësi dhe për të shkaktouar cënim në një mjedis që favorizon dukshëm komorbidetin (prania njëkohësisht e dy sëmundjeve kronike tek i njëjti pacient). Dhe trajtimi i provuar që rezulton më efektiv është terapia njohëse e sjelljes dhe mbështetja e familjes. Politikat për të parandaluar dhe zbutur këto efekte shkojnë nga politika e "mos veprimit" në përdorimin e internetit si një mjet dhe instrument edukativ dhe më tej në krijimin e subjekteve për të adresuar problemet dhe ofruar mbështetje.

**II.B. Dalja e Britanisë nga BE (BREXIT):**

Anglia u largua nga Bashkimi Europian në mesnatën e 31 Janarit 2020, të Premten. I ashtuquajturi Brexit tronditi themelet e Unitetit. Sidoqoftë, ai pati këtë efekt pozitiv, përveç që në analizën përfundimtare është thjesht shfrytëzimi i një mundësie që ofron hapësira legjislative e BE-së, ai e bëri Bashkimin Europian më vigjilent, të vëmendshëm dhe të përqendruar për të mos lejuar asgjë të rrëshqasë në çarjet e krijuara.

Ky nën kapitull shtjellon rrjedhën e ngjarjeve deri në Brexit, për ta kuptuar në mënyrë që të parashikohet integrimi i mëtejshëm, një version zgjidhjesh për rivendosjen e BE-së Post-Brexitit dhe gjendjen aktuale të Bashkimit Europian pas Brexit.

BREXIT (dalja britanike) është emri që iu dha procesit të tërheqjes së Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Europian. Edhe pse mediat dhe mbështetësit e BE-së u kujdesën të sigurojnë të dhëna bindëse mbi pasojat e daljes, veçanërisht në aspektin ekonomik, Mbretëria e Bashkuar u bë zyrtarisht një vend i tretë nga 1 Shkurti 2020.

*II.B.1. Rrjedha e ngjarjeve deri në Brexit,*

Më 23 Qershor 2016, Anglia mbajti një referendum për largimin nga BE, një manifest i Partisë Konservatore. Rezultatet e referendumit, me 52% votim pro dhe 48% votim kundër largimit nga BE, bënë që qeveria në pushtet të njoftojë tërheqjen e saj nga Bashkimi në Mars 2017. Këtu filloi procesi i Brexit.

Procesi i Brexit prodhoi dy dokumente shumë të rëndësishëm që shkojnë së bashku: Marrëveshja e Tërheqjes dhe Deklarata Politike, përkatësisht akte detyruese dhe jo detyruese. Marrëveshja hyri në fuqi më 31 Janar 2020 dhe përcaktoi një periudhë tranzicioni deri më 31 Dhjetor 2020.

Bazuar në nenin 50 të Traktatit të Lisbonës për procedurën që një vend anëtar të largohet nga BE, u hartua, negociua dhe dakordua Marrëveshja e Tërheqjes, në mënyrë që të vendoseshin kushtet e një largimi siç duhet ose " në mënyrë të rregullt". Gjatë negociatave të marrëveshjes, të cilat zgjatën disa kohë, BE ishte me të vërtetë e vendosur në lidhje me përparësitë e saj që përfshinin: Një qasje në faza duke siguruar një tërheqje të rregullt, Mbrojtjen e qytetarëve që kanë ndërtuar jetën e tyre në bazë të të drejtave që rrjedhin nga anëtarësimi i Mbretërisë së Bashkuar në BE, Sigurimi që Unioni dhe Mbretëria e Bashkuar bashkarisht të respektojnë detyrimet financiare që vijnë nga e gjithë periudha e anëtarësimit të Mbretërisë së Bashkuar në Bashkim dhe Vazhdimi në mbështetje të qëllimit të paqes dhe pajtimit të parashikuar në Marrëveshjen e së "Premtes së Mirë", dhe për të mbështetur dhe mbrojtur arritjet, përfitimet dhe angazhimet e procesit të paqes mbi ishullin e Irlandës.[83]

Marrëveshja përfshin 6 fusha kryesore të strukturuara në pjesë:

- Pjesa 1: Dispozitat e përbashkëta-Përcaktimi i klauzolave ndërlidhëse për kuptimin dhe funksionimin e duhur të Marrëveshjes së Tërheqjes
- Pjesa 2: Të drejtat e qytetarëve-Mbrojtja e zgjedhjeve të jetës së mbi 3 milion qytetarëve të BE-së në Mbretërinë e Bashkuar, dhe mbi 1 milion shtetas të MB në vendet e BE-së, duke mbrojtur të drejtën e tyre për të jetuar, punuar ose studiuar në vendin e tyre pritës.
- Pjesa 3: Çështjet e ndarjes-Sigurimi i një tërheqje të rregullt, veçanërisht përmes një përmbarimi të qetë të procedurave dhe aranzhimeve të zbatueshme në vijim në fund të periudhës së tranzicionit.
- Pjesa 4: Zgjidhja financiare-Sigurimi që Mbretëria e Bashkuar dhe BE respektojnë të gjitha detyrimet financiare të ndërmarra së bashku duke qenë se Mbretëria e Bashkuar ishte një Shtet Anëtar.
- Pjesa 5: Tranzicioni - Sigurimi i një periudhe tranzicioni, deri në fund të vitit 2020, e cila mund të zgjatet një herë, deri në një ose dy vjet; Sigurimi i zbatimit të vazhdueshëm të ligjit të BE-së brenda dhe mbi Mbretërinë e Bashkuar gjatë kësaj periudhe (por pa pjesëmarrjen e MB në institucionet e BE dhe strukturat qeverisëse); Sigurimi i kohës së nevojshme për administratat, bizneset dhe qytetarët për t'u përshtatur.

[83] Komisioni Europian. (2019, Tetor). *The revised EU-UK Withdrawal Agreement EXPLAINED.* Bruksel, Belgjikë.

- Pjesa 6: Qeverisja-Sigurimi i menaxhimit, zbatimit dhe zbatimit efektiv të marrëveshjes, duke përfshirë një mekanizëm efektiv të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Përveç kësaj, Marrëveshja përfshin tre Protokolle (në Zonat Bazë Sovrane (SBAs) në Qipro, në Irlandë dhe Irlandën Veriore dhe në Gjibraltarin) dhe nëntë shtojca që rregullojnë aspekte të veçanta të procedurave për të mbështetur zbatimin (koordinimi i sigurimeve shoqërore, dispozitat e ligjit të Bashkimit referuar në nenin 41 (4), afatet kohore për situatat ose procedurat doganore të përmendura në nenin 49 (1), listën e rrjeteve, sistemeve të informacionit dhe bazat e të dhënave të përmendura në nenet 50, 53, 99 dhe 10, Euratom, listën e procedurave të bashkëpunimit administrativ të përmendur në nenin 98, listën e akteve / dispozitave të përmendura në nenin 128 (6), rregulloren e procedurës së komitetit të përbashkët dhe komiteteve të specializuara, rregullat e procedurës).[84]

Deklarata Politike, siç u përmend më herët, është një dokument juridik jo detyrues, që megjithatë shoqëron Marrëveshjen po me të njëjtën rëndësi, parashtron konsensusin mbi Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me tarifa zero dhe kuota midis BE dhe MB. Të dy palët duhet të tregojnë angazhime në një nivel të barabartë për të "siguruar një marrëdhënie të ardhshme bazuar në konkurrencë të hapur dhe të drejtë". Niveli i barazisë duhet të mbajë standardet e larta të zakonshme të përdorura në fushat e: - ndihmës shtetërore, - konkurrencës, - standardeve sociale dhe të punësimit, - mjedisit dhe ndryshimit të klimës, - çështje të rëndësishme tatimore, në mënyrë që të shmanget avantazhi i padrejtë konkurrues qoftë për BE ose për MB. (Takimi special i Këshillit Europian (neni 50), 17 Tetor 2019).

Gjatë periudhës së tranzicionit pritet që Mbretëria e Bashkuar dhe BE të zbatojnë dispozitat e marrëveshjes dhe të negociojnë të ardhmen e marrëdhënies së tyre politike ekonomike. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, Mbretëria e Bashkuar do të konsiderohet ende si një Shtet Anëtar përsa i përket përfitimeve dhe detyrimeve, përveç të drejtës së përfaqësimit dhe vendimmarrjes. Që nga data e daljes, përfaqësimi i saj në të gjitha institucionet dhe organet e BE-së, dhe të drejtat e saj të vendimmarrjes dhe të

[84] Marrëveshje për tërheqjen e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore nga Bashkimi Evropian dhe Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike, Bashkimi Evropian dhe Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda Veriore, 12.11.2019, Informacion Nga Institucionet, Organet, Zyrat dhe Agjencitë e Bashkimit Evropian, C384 I /.

pjesëmarrjes në mbledhjet e institucioneve dhe agjencive të BE-së do të limitohet. Ajo gjithashtu do të humbasë aksesin në të gjitha rrjetet, bazat e të dhënave dhe sistemet e informacionit të BE-së, nga fundi i periudhës së tranzicionit, përveç nëse parashikohet ndryshe. (Cirlig: 2019). Periudha e tranzicionit duket të jetë shumë e intensive, duke kujtuar sërish kur Boris Johnson, i emëruar në Korrik 2019, dha përparësi përgatitjeve përfundimtare për të lënë BE-në pa marrëveshje më 31 Tetor 2019, deri sa BE-ja të hiqte dorë nga 'ndarja' në Protokoll; por duhet t'i besohet zotësisë së BE-së që çdo negociatë të përfundojë në një marrëveshje në mënyrë të rregullt.

Për të siguruar zbatimin e duhur të Marrëveshjes, duhet të ketë një mekanizëm të veçantë për të koordinuar aktivitetet në lidhje me këtë në nivelin kombëtar dhe në nivelin e Unionit. Për këtë u krijua një strukturë e veçantë "Task Forca për Marrëdhëniet me Mbretërinë e Bashkuar". Struktura përgatiti një inventar me masat për zbatim dhe adresoi institucionet që ndikojnë në këto masa dhe do të vazhdojë të bashkërendojë punën me Komisionin dhe Shtetet Anëtare për të zbatuar planin e masave. Fushat me kërkesë më të lartë, sa i takon punës dhe kohës, do të jenë: krijimi i një komiteti të përbashkët për të mbikëqyrur zbatimin e Marrëveshjes së Tërheqjes, i cili do të përbëhet nga përfaqësues nga dhe bashkë-kryesues nga BE dhe Mbretëria e Bashkuar; krijimin e mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ose paneleve të arbitrazhit, siç parashikohet në Marrëveshjen e Tërheqjes; zbatimin e Protokollit për Irlandën / Irlandën Veriore, i cili kërkon marrëveshje të pashembullt në një numër fushash përpara përfundimit të periudhës së tranzicionit. Kjo përfshin, për shembull, angazhime praktike për mbikëqyrjen e BE-së mbi autoritetet doganore të MB në tokë në Irlandën Veriore, dhe operacionalizimin e përjashtimeve tarifore për disa mallra të importuara në Irlandën Veriore; zbatimi i dispozitave për të drejtat e qytetarëve, të cilat gjithashtu kërkojnë monitorim të ngushtë nga Komisioni Europian. ("Zbatimi i Marrëveshjes së Tërheqjes": 2010).

Meqenëse pjesa më e mirë do të vijë pas periudhës së tranzicionit, ekzistojnë disa aspekte të rëndësishme mbi të cilat ndrehet diskutim: krijimin e institucioneve kryesore të BE-së dhe ndikimin e drejtpërdrejtë në integrimin e ardhshëm të Unionit.

Një studim i Departamentit të Politikave për të Drejtat e Qytetarëve dhe Çështjet Kushtetuese në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikat e Brendshme të Unionit mbi *"Ndikimin e tërheqjes së Mbretërisë së Bashkuar në krijimin institucional dhe dinamikën politike"*, arriti në përfundimin se: "Bilanci i përgjithshëm ndërinstitucional

duket se u jep një peshë relativisht më të madhe Shteteve të mëdha Anëtare në Këshill, dhe shteteve më të vogla në Parlament, ndërsa - disi në mënyrë indirekte - barazia e Shteteve Anëtare, në veçanti edhe e shteteve më të vogla, është e garantuar në përbërjen e Komisionit por Brexit nuk do të ndikojë në këtë. Sipas rregullit të shumicës së kualifikuar të përforcuar (neni 238 (2) dhe (3) (b) TFEU), Brexit do të rrisë autoritetin e votimit të të gjitha Vendeve Anëtare në proporcion me ndryshimet në madhësinë e popullsisë, Shtetet Anëtare më të mëdha që fitojnë më shumë autoritet sesa Shtetet Anëtare më të vegjël."

Në një raport të Komitetit të AFCO-s për "*Ndikimin e tërheqjes së Mbretërisë së Bashkuar në integrimin Europian"*, u shqyrtua pozita e MB në "nxitjen ose pengimin" e integrimit europian gjatë periudhës së anëtarësimit, përballë 5 fushave të politikave: tregu i brendshëm; politika sociale, fusha e lirisë; siguria dhe drejtësia; bashkëpunimi i jashtëm, siguria dhe mbrojtja; dhe Eurozona. I njëjti raport tregoi se, përgjithësisht gjatë kohës së saj si vend anëtar, Mbretëria e Bashkuar qe një partner 'i pavëmendshëm' që vendos interesat nacionale përpara, por që me siguri me Brexit ajo ka ndikuar në ekuilibrin e Unionit dhe drejtimin e integrimit të tij. Ai arriti në përfundimin se efekti i Brexit në integrimin e mëtejshëm të Unionit do të përcaktohet duke balancuar dy palët: suksesin ose dështimin e MB-së jashtë BE-së dhe aftësinë e BE-së për të menaxhuar këtë situatë dhe provuar aspiratën europiane.

*II.B.2. Një version zgjidhjesh për rindërtimin e Post-Brexitit të BE-së,*

Ajo që në anglisht quhet *real estate* ('statusi i vërtetë' nga latinishtja), në shqip quhet *pasuri e paluajtshme*. Të jetosh në një ndërtesë me dhjetëra kate dhe qindra apartamente kërkon administrim dhe koordinim të mirë. Edhe pse të gjitha hyrjet kanë pronarin e tyre, për të hyrë në pronën private duhet kaluar në pronën e përbashkët dhe shfrytëzuar infrastruktura.

Çdo e drejtë private është e kufizuar aty ku fillon e drejta tjetër private. Sidoqoftë, civilizimi ka parashtruar të gjitha opsionet e ofruara nga zhvillimi për të mos e bërë këtë ndarje kaq të mprehtë, por për të promovuar filozofinë e komunitetit ku shkëmbimi zhvillohet në harmoni.

Ndoshta ky paralelizëm ka disa kufizime sepse ekziston një ndryshim midis pasurisë së kombit dhe pasurisë së individit ose qeverisë apo biznesit, por megjithatë vizualizon

diagramin e një bashkimi. Dhe këtu koncepti europian i pasurisë nuk duhet të anashkalohet, veçanërisht ai ballkanik.

Anglia po braktis ndërtesën dhe po mban apartamentin.

Kjo do të kërkojë rivendosje në aspektin legjislativ, organizativ, strukturor dhe institucional; për të dy, Anglia nga njëra anë dhe BE nga ana tjetër. Këtu kujtoj se Anglia u bashkua me Komunitetin Ekonomik Europian të 1957 në 1973, kështu që është pothuajse 50 vjet bashkëegzistencë / bashkëjetesë, në kohë të mira dhe të këqija, për më të mirën dhe më të keqen.

Sidoqoftë, duke pasur parasysh se Anglia është ende në ndërtesë, Europa duhet të merret me këtë çështje. Ndoshta kjo rrjedhë e punës është gjithashtu arsyeja pse BE-ja u kthye nga ndërvepruese në reaktive.

Në një studim të fundit (Maj 2020) nga Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane, me titull *"Zhbllokimi i potencialit të traktateve të BE-së: Një artikull nga analiza e artikullit për qëllimin e veprimit*", paraqiti një mënyrë për të zgjidhur këtë situatë, përmes themelimit ligjor të BE-së, që është Traktati i Lisbonës. Duke marrë parasysh rezultatet e Eurobarometrit të vitit të kaluar mbi pritjet e publikut europian, korniza e institucioneve europiane mund të përcaktohet lehtësisht, dhe 'duke përmbushur pritjet e tilla, brenda kornizës së Traktatit, kontribuon në forcimin e legjitimitetit demokratik të BE-së'. Duke pasur parasysh se 'procedura e zakonshme për rishikimin e Traktateve është e lodhshme, dhe se procedura e thjeshtuar nuk mund të përdoret për të zgjeruar kompetencat e BE-së, ekziston nevoja, për momentin, të paktën, përqëndrimi në zhbllokimin e potencialit ekzistues të Traktateve siç janë aktualisht.

Gjithashtu ka disa aspekte jo juridike të veprimtarisë së BE-së përmes të cilave ajo mund të kanalizojë përpjekjet e saj. Këtu përfshihen: zhvillimi i rregullave të zakonshme, rritja e aftësive ekzekutive përmes parashikimit të kapacitetit administrativ plotësues, implementim më i mirë përmes zbatimit të shpërndarjes, synim i financimit përmes rritjes së tij për çështje të caktuara dhe rritje të efikasitetit përmes harmonizimit për të thjeshtuar lëvizjen e lirë.[85]

[85] Members' Research Service of the Directorate-General (2020, Maj). *Unlocking the potential of the EU Treaties.* Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. PE 651.934

*II.B.3. Gjendja aktuale e Bashkimit Europian pas procedurave të Brexit.*

Inicimi i një bashkëpunimi midis vendeve europiane pas Luftës së Dytë Botërore, u pa si zgjidhje për të demonstruar vullnetin e mirë për paqen, që sigurisht duhej të kapitalizohej në një iniciativë përtej ekonomike, duke shtuar aspektin politik, "Komuniteti Europian për Qymyrin dhe Çelikun". Në vitet në vazhdim, ajo do të zhvillohej në Komunitetin Ekonomik Europian dhe Tregun e Përbashkët dhe më tej në Njësinë e Tregut të Vetëm dhe Doganave.

Europa ka punuar shumë që unifikimi të respektojë të drejtat themelore të njeriut, duke këmbëngulur në liri. Kështu, shtyllat kryesore të BE-së, apo "Katër Liritë", u formuan: lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve, punës dhe kapitalit. Liria mund të veprojë vetëm mbi një themel të fortë, atë të demokracisë, që përsëri mund të bëhet e matshme përmes ekonomisë, në drejtim të rritjes dhe standardeve të larta të jetesës. BE-ja luftoi për të stimuluar institucionalizimin e vlerave më të larta të secilit komb, për të koordinuar, krijuar linja komunikimi dhe bashkëveprimi, pa rënduar mbi sovranitetin dhe pavarësinë e vendeve.

E gjithë kjo, jo nga frika e shkeljes së lirisë, por për të luftuar këtë frikë përmes civilizimit, që shkon me të gjitha zhvillimet e kohës, posaçërisht teknologjinë dixhitale, globalizimin, ndërkombëtarizimin etj., në të ardhmen premtuese.

Brexit tronditi këtë themel. Ajo presionoi shumë marrëdhënie dhe nivele të ndryshme. Në analizën horizontale: marrëdhënien me të vetët (Irlanda, Irlanda Veriore dhe Skocia), marrëdhënien me SHBA, marrëdhënien me BE. Dhe e gjithë kjo gjatë diskutimeve mbi presionin nga Kina dhe Rusia, por kjo është një temë më vete. Në analizën vertikale: aspektet politike, ekonomike dhe sociale.

Në këtë panoramë, për të parë të ardhmen, krijon frikë dhe kthen mbrapa shumë vite përpjekje, ku me siguri nuk mund të diskutohet lufta apo paqja, për shkak të historisë që mbart Europa, por pengon bashkëpunimin dhe këtë frymë jokonstruktive, terheq vendet në Bashkim, duke krijuar hapësirë (në aspektin e unitetit) dhe boshllëqe që në rast krizash (si emigracioni, financa) ofrojnë akses më të lehtë ndaj fenomeneve si nacionalizmi ose populizmi. Kjo është sfiduese në shtimin dhe rritjen e vlerave më të larta të Europës dhe nga lufta për territorin thellohet një luftë më e egër, ajo e pushtetit, domethënë interesi personal përpara interesit të përbashkët (këtu: të interpretohet sipas interesit të kombeve).

'Shtetet e Bashkuara të Europës', siç i referohen disa, që ishte parashikuar të rriste konkurrencën me SHBA dhe pjesën tjetër të botës, dhe rrjedhimisht të rriste standardin e jetesës, e bëri BE-në të përballet me domosdoshmërinë për të menaxhuar daljen e parë të një vendi nga Unioni, në këtë rast Anglia.

Gjatë periudhës së tranzicionit (31 Janar - 31 Dhjetor 2020), Mbretëria e Bashkuar duhet të respektojë: Marrëveshjen e Tërheqjes dhe Deklaratën Politike. Dhe nëse Britania e Madhe vendos ta zgjasë këtë periudhë, ajo duhet të shprehet brenda Qershorit 2020, por politika aktuale nuk duket se dëshiron ta bëjë këtë. Gjërat që do të arrihen gjatë kësaj periudhe kohore janë: marrëveshja tregtare me BE, zgjedhja midis BE / SHBA, marrëdhëniet me Irlandën Veriore dhe Skocinë (të cilët dëshirojnë të qëndrojnë në BE), bashkimin doganor dhe pjesëmarrjen e Irlandës Veriore në tregun e vetëm, bashkëpunimin për sigurinë, terrorizmi, arsimi dhe shkenca, politikat e migracionit (lëvizja e lirë kundrejtë të drejtave të punëtorëve).[86]

Kjo do të thotë një ndikim në zhvillim, tregti, vende të punës dhe rrjedhimisht politika të jashtme dhe të sigurisë së të gjithë Europës.[87] Të gjitha vendet duhet të merren me këtë ndikim, për të mos llogaritur efektin bullies të SHBA-së (Trump) si në rastin e NATO-s, ku ai bëri SHBA-në, sikurse i referhet profesori Ëalt në artikullin "E ardhmja e Europës pas Brexitit po duket e frikshme", të "mbetet vetëm zyrtarisht në organizatë si mbrojtës në zgjidhjen e fundit, por jo si vendi që i jep drejtim i pari". SHBA duket se e ka joshur Anglinë ta shoh veten si një urë për tregun europian (përsëri në konceptin e fuqisë së përmendur më parë). Ose të tundohet të zgjerojë E3 ose të forcojë marrëdhëniet me Kanadanë dhe Japoninë.[88]

Mënyra se si BE do të trajtojë Brexit dhe do të menaxhojë efektin e saj do të jetë një mësim shembull për vendet e tjera anëtare në procesin e mëtejshëm të integrimit dhe në një mënyrë do të vendosë të ardhmen e BE-së (nëse BE do të bashkohet ose ndahet). Mësimet që Z. Blockmans propozon, në një artikull të vitit 2020 duke folur për pasojat e Brexit, për të shërbyer si matje e unifikimit të bashkimit janë: ekziston forca në unitet,

---

[86] Sandford, A. (2020, Dhjetor). *Post-Brexit Guide: Where are we now – and how did we get here?* Instituti Brexit.

[87] Amadeo, K. Berret-Johnson, J. (2020, Mars) *Brexit Consequences for the U.K., the EU, and the United States.* https://www.thebalance.com/brexit-consequences-4062999 Instituti Brexit.

[88] Raines, T. Von Ondarza, N. Greco, E. & Blockmans, S. (2020, Janar). *Brexit Is Here: The EU and UK Must Brace for the Consequences*. Council of Councils global. PE, Bashkimi Europian. Bruksel, Belgjikë.

ndërvarësia nuk mund të mohohet dhe debatet e BE-së fitohen ose humben në nivel kombëtar.

Ndikimet e Brexitit në Europë përcaktohen nga rëndësia e pozitës së MB-së brenda BE-së në raport me shtetet e tjera anëtare, natyrën ose gjendjen e marrëdhënieve bilaterale midis Mbretërisë së Bashkuar dhe shteteve të tjera anëtare dhe kapacitetit të MB për të ndikuar në politikën e tyre të jashtme dhe rezultatet përfundimtare të negociatave në vazhdim. Shkalla në të cilën Brexit prish të ardhmen e BE-së që çon në pasoja varet nga ndurtësia e saj: në një Brexit të butë nuk do të ketë kaq shumë ndikim mbi të ardhmen e BE-së dhe anasjelltas. (Ababakr: 2019).

Sidoqoftë, fokusi duhet të jetë në demokraci. Në recesionin demokratik që po ndodh në Europë mund të qëndrojë gjithashtu zgjidhja për problemet që po kalon BE-ja. Të imagjinuarit e formave të ndryshme të angazhimit dhe transnacionalizimi i praktikave demokratike mund të adresojë zhvendosjen dhe keqvendosjen e demokracisë, si dhe mangësitë në legjitimitetin, përgjegjshmërinë dhe proceset e vendimmarrjes së saj. Krahas parandalimit të një Brexit kaotik me të gjitha pasojat e tij në politikën e brendshme dhe ndërkombëtare, e ardhmja e Europës kërkon gjithashtu një mendim krijues për rinovimin e demokracive të sj në nivel lokal, kombëtar dhe organizata ndërkombëtare pjesëmarrëse. (Balfour: 2010).

Një pikë tjetër e rëndësishme për të tërhequr vëmendjen kur trajtohet Brexit është zgjerimi i BE-së, veçanërisht në drejtimin e Ballkanit Perëndimor. Mbretëria e Bashkuar ka mbështetur gjithnjë zgjerimin e BE-së sepse e konsideroi zgjerimin si mbrojtjen më të mirë kundër përpjekjeve të anëtarëve të tjerë për të ndjekur integrim më të madh politik. (Lindsay: 2018). Dhe kur bëhej fjalë për Ballkanin Perëndimor, edhe pse Mbretëria e Bashkuar nuk kishte ndonjë interes të fortë, ajo ndërhyri për të ndikuar që Ballkani të anëtarësohej në BE. Mbështetja gjithsesi u ndërpre për shkak të Brexit. Kjo jep tregues që shqetësimit të vendeve në bashkim që thellojnë autoritetin e tyre politik nëse zgjerimi nuk do ndodhte, Anglia ju përgjigj me tërheqje. Ajo demonstron gjithashtu realizimin se imperativi strategjik i projektimit të interesit të BE-së ishte më i rëndësishëm sesa procesi dhe metodologjia e zgjerimit. (Cavaski: 2020). Ideali europian duhet të theksohet për ta bërë aspiratën për t'u anëtarësuar në BE dhe atë për të kontribuar edhe më të fortë.

**II.C. Barazia Gjinore:**

- Një argument mbi përparimin e ngadaltë drejtë barazisë efektive në dekadën e fundit
- Sa i adreson strategjia e re çështjet e pazgjidhura të së kaluarës

**Barazia Gjinore**

Vlera themelore e Bashkimit Europian (BE) është barazia midis kombeve; kjo për sa i përket dinjitetit dhe të drejtës së njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë dhe sundimit të ligjit.

Dokumenti kryesor që kornizoi qasjen e politikave dhe aktivitetet për barazinë gjinore në BE ishte "Angazhimi Strategjik për Barazi Gjinore 2016-2019" dhe para tij "Strategjia për barazi midis grave dhe burrave 2010-2015". Më 5 Mars 2020, Komisioni Europian prezantoi një "Strategji të Barazisë Gjinore të Bashkimit Europian 2020-2025", duke premtuar angazhim maksimal, për të siguruar që ky prioritet kryesor i presidencës aktuale të komisionit, të pasqyrohet në politikat e BE-së.

Ky nen kapitull synon të japë një argument mbi përparimin e ngadaltë drejt barazisë efektive në dekadën e fundit dhe nëse strategjia e re adreson çështjet e pazgjidhura të së kaluarës, duke konkluduar se çdo pabarazi që ekziston në vende të ndryshme të kulturave të ndryshme (rrjedhimisht e normave të ndryshme shoqërore) sheshohet nga politikat dhe ligjet në lidhje me barazinë gjinore dhe pabarazinë, duke marrë parasysh që variacioni i demografisë siç duket ndikon veçmas meshkujt dhe femrat.

*II.C.1. Një argument mbi përparimin e ngadaltë drejtë barazisë efektive në dekadën e fundit,*

BE manifeston barazinë gjinore në të gjitha politikat dhe institucionet e saj, përmes promovimit të pavarësisë së barabartë ekonomike për gratë, duke u përpjekur të ngushtojë deri në mbyllje hendekun gjinor të pagave, duke promovuar përfaqësimin e grave në vendimmarrje, duke i dhënë fund dhunës me bazë gjinore, jo vetëm si një vlerë thelbësore por edhe si frymëzim për rritje, sociale dhe / ose ekonomike që mund të jetë.

Por shtrirja dhe thellësia e këtyre masave për të qënë efikase për secilin vend, duke marrë parasysh asimilimin e pabarabartë të politikave dhe ndryshimin në performancë, për sa i përket kushteve të BE-së, direktivave, rekomandimeve, çon në një logjikë që mbështetet në strukturat shoqërore.

BE ka bërë të gjitha përpjekjet për të promovuar barazinë midis gjinive. Megjithatë, është një synim që po merr kohë të arrihet, veçanërisht në dekadën e fundit, që për shkak të zhvillimit të teknologjisë, midis zhvillimeve të tjera, pritej të ishte më e lehtë për t'u arritur.

Ka shumë argumente për të justifikuar përparimin e ngadaltë drejt barazisë gjinore: plakjen e popullsisë, zvogëlimin e popullsisë në moshë pune, çështje që lidhen me pjesëmarrjen e grave, ekspozimin joproporcional ndaj dhunës, diskriminimi, imigrimi, arsimi, teknologjia dhe reagimet kundër barazisë gjinore.[89]

Të gjitha sa më sipër shtyjnë drejtë zgjidhjeve në lidhje me legjislacionin dhe veprimet për të përmirësuar, modernizuar dhe zbatuar ato, të cilat, në fazën përfundimtare, pengohen nga aftësia e kombeve për të zbatuar dhe integruar më tej.

Politika e kohezionit është një bazë e mirë për të vëzhguar peshën e dhënë për dimensionin gjinor dhe cilësinë gjinore në planin e politikave të BE-së. Përmes instrumenteve kryesore të tij (fondeve), si Fondit Europian për Zhvillimin Rajonal dhe Fondi Social i Europës, kanë gjetur mbështetje çështjet që lidhen me gjininë. Sidoqoftë, efikasiteti i këtyre fondeve varet nga vendimet e marra nga rajonet dhe shtetet anëtare në strategjitë e tyre të programimit dhe zbatimit, si dhe nga aftësia e tyre për të zbatuar ndërhyrje që marrin parasysh dimensionin gjinor. Në lidhje me këtë, për periudhën e programimit post-2020 rekomandimet përfshijnë: 1. futjen e kërkesave të detyrueshme për barazinë gjinore në të gjitha OP-të pas vitit 2020 me masa specifike dhe transversale të barazisë gjinore në të gjitha fondet, si dhe detyrime specifike (p.sh. në kriteret e përzgjedhjes dhe sistemet e monitorimit), dhe udhëzimet detyruese për të përmirësuar pajtueshmërinë; 2. ruajtja e kërkesës së mëparshme të zhvillimit të strategjive kombëtare për barazinë gjinore për të përmirësuar sinergjitë dhe për të përmirësuar efektivitetin dhe vlerën e shtuar të CP; 3. mbështetja e krijimit të partneriteteve efektive me përfaqësuesit e barazisë gjinore nga shoqëria civile. 4. zhvillimi i mjeteve, udhëzimeve dhe programeve  të trajnimit lidhur me gjininë, të përshtatura për fushat specifike të politikave të adresuara nga CP, me shembuj konkret se si të zbatohet një perspektivë gjinore; 5. krijimin dhe / ose forcimin e koordinimit, monitorimit dhe organeve të asistencës teknike për barazinë gjinore për të mbështetur integrimin gjinor në të gjitha fushat e politikave të Politikës së Kohezionit dhe të gjitha fazat e programit; 6. Sigurimi i një angazhimi të fortë politik për barazinë gjinore në nivelin europian dhe kombëtar / rajonal, në mënyrë që të përfshijë vëmendjen dhe angazhimin e palëve të interesuara të politikës së kohezionit kombëtar dhe lokal. (Samek Lodovici, Drufuca, Ferrari, Patrizio, Pesce, De Silvis dhe Moja: 2018).

[89] Prpic, M. Shreeves, R. Dobreva, A. (2019, Qershor). EU policies-delivering for citizens: Promoting equality between women and men. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europian. Bruksel, Belgjikë.  PE 628.272

Në përpjekjen për të matur mbështetjen që barazia gjinore merr në BE, financat ofrojnë matësin më të drejtë për ta bërë këtë. Një studim mbi "Buxhetimi në BE në përgjigje të barazisë gjinore: përditësim i studimit "Buxheti i BE-së për barazi gjinore" dhe rishikim i konkluzioneve dhe rekomandimeve të tij" të Departamentit të Politikave për Çështjet Buxhetore në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikat e Brendshme të Unionit, zbuloi se që nga studimi i fundit, ai i vitit 2015, ka pasur pak përparim në buxhetimin gjinor në BE. Të njëjtat çështje vazhduan në të dy studimet: përkushtim i ndryshëm ndaj parimit të barazisë gjinore dhe integrimit gjinor, çështjeve gjinore (varfërisë, dhunës gjinore, emigracionit) që shtypin edhe politikat që pasqyrojnë një angazhim të fortë për barazinë gjinore, mospërputhje midis kapitujve të ndryshëm që adresojnë barazinë gjinore në buxhetin vjetor të BE-së, angazhimi i dobët në Kuadrin Financiar Shumëvjeçar 2021-2027. Për këtë u rekomandua përsëri një veprim juridik për të monitoruar respektimin e parimit të barazisë gjinore në hartimin dhe zbatimin e politikave, buxhetit dhe shpenzimeve të BE-së. Angazhimi politik kolektiv dhe veprimi legjislativ formojnë Komisionin, Parlamentin dhe Këshillin e Europës.[90]

Për shkak të natyrës delikate të çështjes, diskutimi mbi barazinë midis burrit dhe gruas, bie nën nivelin financiar gjithnjë duke vënë në dyshim kompensimin e pabarabartë për të njëjtën punë të kryer. Një instrument i rëndësishëm si masë për të balancuar këtë pabarazi është transparenca detyruese e pagave. Përparësitë e saj janë adresimi i hendekut të pajustifikuar ose diskriminues të pagave, por disavantazhet janë kostot administrative për punëdhënësit dhe shqetësimet për konfidencialitetin e pagave, edhe pse vetë punonjësit e mbështesin këtë iniciativë.[91] BE po përgatit një propozim legjislativ për këtë.

Roli që struktura sociale luan në politikat e barazisë gjinore në BE mund të tregohet edhe përmes përparimit në këtë aspekt të bërë nga vendet e mbetura jashtë bashkimit, veçanërisht vendet e Ballkanit Perëndimor. Përparimi i këtyre vendeve drejt barazisë gjinore u ndikua nga regjimi shoqëror, ekonomik dhe politik dhe gjithashtu popullsia

[90] Chengiz, F., Schratzenstaller, M., Franceschelli, N., Gonzales, M., (Blomeyer and Sanz). (2019, Shkurt). *Gender responsive EU Budgeting Update of the study 'The EU Budget for Gender Equality' and revieë of its conclusions and recommendations.* Departamenti i Policisë D për Ceshtjet e Buxhetit në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikat e Brenshme, PE. Brussels.

[91] Hofman, J. Nightingale, M. BruckMajer, M. Sanjurjo, P. (2020, Shkurt). *Equal pay for equal work.* Departamenti i Policisë për Politikat mbi Ekonominë, Shkencën dhe Cilësinë e Jetës Drejtoria e Përgjithshme për Politikat e Brendshme. Bruksel, Belgjikë. PE 642.379

kryesisht rurale që nxiti privimin dhe cenueshmërinë sociale. Mbështetja legjislative nga BE, posaçërisht përmes procesit të pranimit, u sigurua, por në një këndvështrim social dhe njerëzor, këto vende, që aspirojnë për një të ardhme në BE, kanë nevojë për veprime konkrete për zbatimin e duhur të ligjeve (që adresojnë çështje të tilla si ato socio- ekonomike, dhuna ndaj gruas (VAW) dhe Shëndeti Seksual dhe Riprodhues dhe të Drejtat (SRHR) dhe e drejta LGBTI), për t'u konsoliduar në terma të politikave që lidhen me barazinë gjinore.[92]

Integrimi i çështjeve gjinore ka në thelb gruan, veçanërisht përfaqësimin e saj në pozicionet vendimmarrëse. Aq shqetësuese sa tingëllon, është fakti se gruaja ende ngre diskutim për shkak të nën-përfaqësimit në pozicione drejtuese. Promovimi i fuqizimit të grave mund të jetë zgjidhja për angazhimin e barabartë gjinor në hartimin dhe zbatimin e politikave. Këtu ia vlen të përmendet referenca e hulumtimit të Shreeves, Prpic dhe Claros të vitit 2019 për "Gratë në politikë në BE: Situata Aktuale", që dallon dy lloje të përfaqësimit që pritet të arrihen përmes masave të barazisë gjinore: përshkruese dhe thelbësore, me njërën që llogarit numrin e përfaqësimit dhe tjetrën që llogarit efektin e përfaqësimit.

*II.C.2. Sa i adreson strategjia e re çështjet e pazgjidhura të së kaluarës.*

Dy strategjitë e fundit për barazinë gjinore, që mbulojnë një periudhë kohore nga 2010-2019 (2010-2015 dhe 2016-2019), ndoqën të njëjtin drejtim, duke u përqëndruar në dhunën ndaj grave dhe duke paguar transparencën / boshllëkun e pagave gjinore, përfshirë këtu njëkohësisht edhe balancën jetë-punë. Pavarësisht, progresi ishte i ngadaltë dhe i ndryshëm në secilin vend pavarësisht nga të kuptuarit se trajtimi i këtyre dallimeve do të sjellë atmosferë më të mirë socio-ekonomike dhe politike.

Strategjia e re për 2021-2025 është në proces. Ky proces ka kaluar dy fazat e para: konsultimet publike (Mars-Maj 2019) dhe udhërrëfyesin (Shkurt 2020). Kështu që puna më e madhe është bërë duke marrë parasysh që udhërrëfyesi përshkruan çështjen, përcakton objektivat, arsyeton ndërhyrjen e BE-së përmes politikës, përshkruan opsionet e politikave dhe përshkruan tiparet kryesore të strategjisë së konsultimit.[93] Në

[92] Duhacek, D. Brankovic, B. Mirazic, M. (2019, Janar). *Women's rights in Western Balkans. Departamenti i Policisë për të Drejtat e Qytetarëve dhe Çështjet Kushtetuese*. Drejtoria e Përgjithshme për Politikat e Brendshme. Bruksel, Belgjikë. PE 608.852

[93] Komisioni Europian. *Planifikimi dhe propozimi i Ligjeve*. Marrë nga https://ec.europa.eu/info/law/law-making-process/planning-and-proposing-law_en#how-their-scope-is-defined

listën e re të fokusit është shtuar balanca gjinor në bordet e ndërmarrjeve dhe çështjet gjinore që lidhen me ndryshimin e klimës dhe inteligjencën artificiale.

Kujdes i duhur duhet t'i kushtohet asaj që dëshmohet nga përvojat e kaluara si e dobët në procesin e zbatimit të ligjeve. Ashtu si rekomandimet e parlamentit, strategjia e re duhet të përfshijë standarde konkrete dhe një buxhet të dedikuar për matjen dhe arritjen e përparimit; një kombinim i veprimit të synuar dhe integrimit gjinor; masa për të adresuar diskriminimin e shumëfishtë dhe nevojat e grupeve të ndryshme të grave; dhe koordinim më i mirë me strategjitë ndërkombëtare dhe ato të BE-së, përfshirë Axhendën e Kombeve të Bashkuara 2030, Europa 2020, Semestrin Europian dhe Kuadrin Financiar Shumëvjeçar; si dhe të konsiderojë seriozisht reagimet nga palët e interesuara që bën thirje ndër të tjera për integrim më të mirë gjinor dhe buxhetim në të gjitha fushat e politikave, një qasje kryqëzuese për të trajtuar kombinimin e bazave të ndryshme të diskriminimit dhe mbështetjes për organizatat e shoqërisë civile që punojnë për barazi më të madhe gjinore. (Shreeves: 2020).

**II.Ç. Siguria dhe Mbrojtja:**

*II.Ç.1. Zhvillimet institucionale dhe politike*

Demokracia, paqja dhe siguria nuk mund të kuptohen pa një politike të mirë mbrojtjeje dhe sigurie. BE është angazhuar seriozisht në këtë, në linjë dhe me politika të tjera si fqinjësia e mirë, punët e jashtme, tregëtia dhe politika të tjera që lidhen me kufinjtë (doganat).

Por vitet e fundit kanë dëshmuar rritje të dhunës dhe terorizmit duke e rrezikuar paqen dhe sigurin, duke ndikuar stabilitetin, gjë që kërkon unifikim të përgjigjeve ndaj këtij risku. Çështja është që kjo mbetet ende një përgjegjësi e vetë vendeve anëtare, më shumë se BE.

Traktati i Lisbonës, në vijim  të një procesi të përgjithshëm institucionalizimi, solli ndryshime dhe në këto dy fusha, sigurinë dhe mbrojtjen, duke theksuar rëndësinë e një bashkëpunimi më të kordinuar dhe strukturuar që punon për një qëllim më të madh të përbashkët.[94]

Disa arritje mund të listohen në aspektin e politikave dhe institucioneve qe prodhoi përpjekja për sigurimin e stabilitetit në aspektin e mbrojtjes dhe sigurisë. Politika e Mbrojtjes dhe Sigurisë së Përbashkët (CSDP) në 2013, Politikat e Përbashkëta të Jashtme dhe të Sigurisë CFSP),  Strategjia Globale e BE (EUGS-2016), Plani i Veprimit për Mbrojtjen në Europe, Fondi Europian për Mbrojtjen (EDF), Planifikimi Ushtarak dhe Kapaciteti Përcjellës (MPCC), PESCO, CARD, PADR, mobiliteti ushtarak, Objekti i Nërlidhjes Europiane (CEF) nën MFF, Objekti Europian i Paqes  (EPF) etj,

*II.Ç.2. Sfida dhe zgjidhje që parashikohen në këto fusha.*

Të diskutosh çështjet për mbrojtjen brenda një unioni është sfiduese pasi BE është bashkim i disa vendeve me politika të jashtme, që në fund të fundit synojnë mos cënimin e sovranitetit të tyre dhe përmbushjen e qëllimeve respektive për mbrojtjen dhe sigurinë.

Brexit nga ana tjetër, pavarësisht se levizi themelet e Unionit, nuk përben rrezik sa i takon sigurisë pasi duket se qasja e UK ndaj BE është të ofrojë eksertizën e saj në

[94] Lazarou, E.  Dobreva, A.  (2019, Qershor).  *Security and defence.*  Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 635.533

përmirësimin e politikave në këtë fushë, duke kujtuar së Anglia në fakt ka qënë element kyç në pjesën më të mirë të politikave për sigurinë dhe mbrojtjen në Europë.[95]

Tjetër aspekt i rëendesishëm kur diskutohet për sigurinë është kibernetika. Së fundmi, sidomos dhe me situatën e pandemisë, rëndësia e saj është shtrirë në parametra të pa menduar më parë. Vëmendje kanë marrë zhvillimi i armëve të reja dixhitale, eksporti i teknologjisë me përdorim të dyfishtë dhe lufta kibernetike.[96] Megjithatë është e rëndësishme të diferencohen konceptet e sigurisë kibernetike, mbrojtes kibernetike, diplomacise kibernetike dhe kibernetikes dekurajuese/kërcënuese. Të gjitha veprojnë në atë që konsiderohet hapësira kibernetike. BE ka zhvilluar atë që quhet paketa e mjeteve të diplomacisë kibernetike dhe njëhohësisht ka ndërmarrë një seri angazhimesh multilaterale dhe bilaterale për të rritur sigurinë në hapësirën kibernetike.[97] Tjetër zhvillim në këtë vijë është teknologjia biometrike dhe ku diskutim ngre përplasja e saj me të drejtat dhe liritë e njeriut.[98]

Ky nënkapitull mbështet qëndrimin se ajo çfarë e pengon BE-në të arrijë objektivat strategjike lidhur me sigurinë është vullneti politik i vendeve anëtare si dhe mungesa e një kulture të përgjithshme strategjike, zgjidhje për të cilat mund të jetë kordinimi i punës, bashkëpunimi dhe dialogu.[99]

Përsëri sikurse përmendur dhe më herët në këtë punim, edhe kjo fushë dëshmon për aspekte/dispozita të pashfrytëzuara të Tratatit të Lisbonës. Ndoshta në këto dispozita mund të gjendet zgjidhja më e mirë e përplasjeve kryesisht politike por që kanë efekt në "qetësine" e Unionit.

Për rëndësinë që po marrin pajisjet dhe teknologjia në mbrojtjen dhe sigurinë, sikurse duket të jetë dhe prirja e BE, Fondi për Mbrojtjen në Europe duhet të mobilizohet për më shumë mbështetje për kërkim shkencor dhe zhvillim (R&D) në këtë fushë pasi BE duhet të shërbejë si institucion udheheqës i vlerave të përbashkëta, jo reaktiv ndaj

[95] Latici, T. (2019, Prill ). *What role in European defence for a post-Brexit United Kingdom?* Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 637.941

[96] Latici, T. (2020, Maj). *Understanding the EU's approach to cyber diplomacy and cyber defence.* Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 651.937

[97] Ibid.

[98] Van Woensel, L. Nevil, N. (2019, Mars) *What if your emotions were tracked to spy on you?* Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 634.415

[99] Besch, S. Legrand, J. Asplund, E. (2020, Janar) EU's Institutional Framework regarding Defence Matters Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 603.484

risqeve.[100] Reagimi ndaj risqeve, duke prodhuar kërkim shkencor, duhet të jetë funksion i sistemeve të konsoliduara, që kanë aftësi dhe të parashikojnë risqet përpara së ato të ndodhin dhe të ofrojnë të dhëna për reagimin e sistemit.

Barazia gjinore në punët e jashtme dhe sigurinë ndërkombëtare mbetet ende e pa balancuar, pavarësisht Qasjes Strategjike të 2018 ndaj Axhendës së Gruas, Paqes dhe Sigurisë (WPS-2000) apo studimeve që tregojnë se angazhim me i madh i gruas në jetën sociale, veçanërisht në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, garanton sukses të programeve, stabilitet, mirëqënie dhe rritje ekonomike.[101]

Një zgjidhje për të ardhmen në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes, në vazhdën e zhvillimeve me Amerikën, Kinën, Rusinë apo risqeve të tjera si migrimi, Brexit, siguria kibernetike, është kanalizuar përmes veprimtarise së: NATO, në manaxhimin e dialogut transatlantic për sfida geo-strategjike dhe teknologjike; OSCE, në sferat që konsiderohen si 'soft security' (mbikëqyrja e zgjedhjeve, pjesëmarrja politike, të drejtat e minoriteteve, lirinë e fjalës dhe sigurinë e gazetareve njëhohësisht dhe sigurinë dhe mbrojtjen kibernetike; Aktin Reformues Të Kontrollit Amerikan për Eksportet (ECRA), që theksoi rëndesinë e diferencimit të teknologjisë themelore dhe asaj në zhvillim për të siguruar inovacion dhe rritje ekonomike ndërkombëtarisht apo Fondit Europian të Mbrojtjes (EDF) që është një bashkim i kërkimit shkencor (PADR) dhe kapacitetit/aftesisë (EDIDP) për të siguruar inovacion dhe konkurrencë në bazën industriale dhe teknologjike të mbrojtjes.

Natyra jo detyruese e politikave mbi mbrojtjen mund të rrezikojë thellimin e diferencave midis vendeve brenda Unionit apo atyre që aspirojnë atë. Ndoshta normimi i politikave në akte detyruese do ti angazhojë vendet e BE të rrisin bashkëpunimin duke kordinuar punën për mbrojtjen dhe sigurinë në mënyrë të atillë që të gjithë të gëzojnë të njëjtin standard ose me saktë të integrohen me kushtë të barabarta.

Rregulla strikte dhe rritje të kostove të prodhimit të produkteve kibernetike do të ishte një zgjidhje për të manaxhuar rrymat në hapësirën kibernetike dhe për të diversifikuar këtë risk që ka sjellur përfitime në aspektin ekonomik dhe social por ka krijuar dhe

---

[100] Kononenko, V. (2018, Tetor). *Establishing the European Defence Fund*. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 627.121

[101] Lazarou, E. Braden, F. (2019, Shtator) *Women in foreign affairs and international security Contours of a timely debate*. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane. Bruksel, Belgjikë. PE 640.159

tension politik (rasti i Amerikës dhe Kinës). Gjithashtu solidariteti midis anëtarëve të Unonit duke tërhequr njëri tjetrin në luftën për të mundur këto risqe përmes ndarjes së eksperiencave dhe dialogut më të mirë është një zgjidhje tjetër.

**KAPITULLI I TRETË - Ballkani Perëndimor drejtë zgjerimit në BE**

# Ballkani Perëndimor drejtë zgjerimit në BE

Rrugëtimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor për në integrimin Europian dhe gjendja aktuale

Qëndrimin e institucioneve kryesore të BE lidhur me zgjerimin e vendeve të Ballkanit Perendimor

Politikat e reja për Ballkanin Perëndimor mbi zgjerimin në BE

Në mbledhjen e Tetorit 2019 të Këshillit Europian, ku u konfirmua qëndrimi pozitiv ndaj hapjes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, 3 shtete, konkretisht Danimarka, Franca dhe Hollanda, e kundërshtuan këtë qëndrim. Më tëj, Franca propozoi një document për reformimin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Pas kësaj, në Shkurt të 2020, Komisioni Europian parashtroi dokumentin "Përmirësimi i procesit të anëtarësimit - Një perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor", që synonte forcimin e procesit dhe rritjen e besueshmërisë së tij.

Ky kapitull përpiqet të ndërtojë një kronologji të ngjarjeve, nga traktati i Lisbonës e në vijim, sa i takon rrugëtimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor për në integrimin Europian dhe gjendjes aktuale të tyre, qëndrimin e institucioneve kryesore të BE lidhur me zgjerimin e vendeve të Ballkanit Perendimor dhe politikat e reja për Ballkanin Perendimor mbi zgjerimin në BE. Kjo, me qëllim qartësimin e pozitave dhe për pasojë pritshmërive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që apirojnë integrimin, në perspektivën europiane.

Traktati i Lisbonës erdhi si domosdoshmëri për një rregullim juridik më të konsoliduar se dy traktatet e mëparshme, Traktati i Romës dhe Traktati mbi Bashkimin Europian apo njohur ndryshe si Traktati i Mastrihtit. Ky 'projekt kushtetues', që më parë konsistonte në politika mbi komunitetin Europian, sigurinë dhe çeshtjet kriminale, e njohu BE-në si një entitet të mirëfilltë ligjor.

Krahas punimeve normale të Unionit, pranimi i anëtarëve të rinj, mbetet ende ndër funksionet kryesore. Nga periudha e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës (Dhjetor 2009) dhe deri më tani, zgjerimi, ka prekur vetëm një vend, që pas pranimit të dhjetëshes së fundit në 2004, duke e çuar numrin aktual të anëtarësimeve në 27.

Perspektiva e zgjerimit te BE shtrihet në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Duke qënë se bisedimet për këtë të fundit janë pushuar, ky kapitull do të fokusohet vetëm në Ballkanin Perëndimor.

Për të kuptuar zgjerimin në këto vende, duhet parashtruar rrugëtimi i secilit vend në rend kronologjik dhe njëkohësisht mënyra e funksionimit të institucioneve të Unionit.

Mëtej të shtjellohen politikat, për një interpretim sa më të bazuar të të ardhmes. Kapitulli do të përqëndrohet në këtë dhe pak në adresimin e disa pikave që mund të jenë bërë pengesë për zgjerimin.

Kriza financiare dhe ajo e emigrimit, e zhvendosën vëmendjen e institucioneve të BE-së nga anëtarësimet e reja në përmbushjen e nevojave për t'ju pergjigjur krizave, për ti manaxhuar ato. Kjo zhvendosje evidentoi disa problematika si krijimi i grupimeve brenda Unionit, politika individuale mbi ato të Unionit, diskutimi i aftësisë së Unionit për të pranuar anëtarë të rinj dhe frustrim në vendet aspirante. Megjithatë të shpjeguarit e përmbajtjes se politikave te reja, në rastin në fjalë, të metodologjisë së re të zgjerimit, si dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre, do ti japë kuptim dhe qartësi sjelljes ndaj vendeve në pritje për anëtarësim.

### III.A. Rrugëtimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor për në integrimin Europian dhe gjendja aktuale

Qëllimi kryesor i BE, në raport me Ballkanin Perendimor, është ndërtimi i një perspektive integrimi të tillë që promovon paqe, stabilitet dhe zhvillim ekonomik. Për këtë, BE përdori një sërë instrumentash duke filluar nga Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit (MSA) tek procesi i hyrjes në BE e më tej kooperimi rajonal dhe udhëtimi pa viza.[102]

Integrimi i Ballkanit Perëndimor në BE duket të jetë konceptuar i fazuar. Kështu, nga 7 vende vetëm një i është bashkuar BE (Kroacia), katër janë kandidatë zyrtar (Serbia, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipëria) dhe dy janë kandidatë të mundshëm (Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova).

Republika e Maqedonisë së Veriut aplikoi për anëtarësimin në BE në 2004, Mali i Zi në 2008, Shqipëria dhe Serbia në 2009, Bosnja dhe Hercegovina në 2016. Ndërkohë, Kosova ende nuk e ka bërë këtë. Katër vende fituan statusin kandidat, konkretisht Maqedonia e Veriut në 2005, Mali i Zi në 2010, Serbia në 2012 dhe Shqipëria në 2014.

[102] The Western Balkans: Fact Sheets on the European Union. (2019, Dhjetor). Marrë nga https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/168/the-western-balkans

Mali i Zi dhe Serbia zyrtarisht hapën negociatat për anëtarësim, respektivisht në vitin 2012 dhe vitin 2014.

Kosova, e cila e fitoi pavarësinë e saj në Shkurt të 2008, ende nuk njihet nga 5 vende anëtare të BE (Qipro, Greqia, Rumanai, Sllovakia dhe Spanja) dhe MSA është një marrëveshje vetëm me EU që hyri në fuqi në Prill të 2016. Kosova nuk gëzon rregjimin e lirë të vizave në zonën Shengen megjithëse plotësoi kriterin e fundit, sipas Udhërrefyesit të Liberalizimit të Vizave, në mesin e 2018.[103]

E ardhmja e Serbise dhe Kosovës në BE kushtëzohet nga dialogu i nivelit të lartë midis vendeve, lehtësuar nga BE, për njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe konflikte te tjera lidhur me çështje të tregëtisë, energjisë dhe kalimeve ndërkufitare.[104]

Bosnja dhe Hercegovina duhet të rregullojnë situatën kombëtare parlamentare për rregullat e procedurës që qeverisin mbledhjet me Parlamentin Europian, mbledhje të munguara që prej Nëntorit 2015 (De Munter: 2019).

Ecuria sa i takon pajtimit në Ballkanin Perëndimor dëshmon që po ecën me ritme shumë të ngadalta, duke qënë se në raportin e 2018 të Komisionit Europian mbi zgjerimin, Serbia, Bosnje Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi ngrejnë shqetësim për qasjen ndaj denimit të krimeve të luftës, pa nënvleresuar arritjet si marrëveshja e Prespës apo zhvillimi i Zyrave Rajonale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO).[105]

Republika e Maqedonise së Veriut dhe Shqipëria pritet të hapin negociatat për anëtarësim përpara Samitit të Zagrebit (Maj 2020)[106], takim që u shty në një datë të mëvonshme për shkak të pandemisë së koronavirusit. Qëndrimi pozitiv u shpreh hapur,

---

[103] 'Schengen visa liberalisation for Kosovo' (2020, Shkurt 20). Marrë nga https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/E-9-2020-000787_EN.html

[104] Perchoc, P. & Lilyanova, V., (2019). Reconciliation in the Ëestern Balkans: The difficulty of emulating the EU model. Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Europiane, PE 637.964.

[105] Ibid.

[106] EU - western Balkans relations (2020, Mars) Marrë nga https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/eu-western-balkans-relations_en.pdf

nga Këshilli Europian dhe Komisioni Europian[107] dhe nga Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme[108], si në mbledhjen e 24 Marsit dhe në video-konferencën e 26 Marsit 2020 dedikuar Covid 19, pavarësisht se nuk u caktua një datë për këtë.

Serbia dhe Mali i Zi mund ti bashkohen BE në 2025, në një vlerësim të pavarur në bazë të meritës dhe ecurisë së arritur në përmbushjen e kushteve të vendosura.[109]

**III.B. Qëndrimi i institucioneve kryesore të BE lidhur me zgjerimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor pas Traktatit të Lisbonës**

Traktati i Lisbonës hyri në fuqi me 1 Dhjetor 2009. Ajo i njohu BE 'personalitet të plotë ligjor'. [110] Sipas tij Parlamenti Europian mund të propozojë amendime, sikurse mund të bënte që herët Këshilli, Komisioni dhe Qeveritë e vendeve anëtare. Këshili Europian u be zyrtarisht institucion dhe presidenca e tij, me një sistem rotacioni 6-mujor, u zëvendësua me presidencë 2.5 vjecare, të rinovueshme, për të siguruar stabilitet politik. Që pas Traktatit, Këshilli mban 4 takime formale çdo vit dhe është rritur roli në sistemin politik të BE si përcaktues i axhendës dhe manaxhues i risqeve (Anghel&Drachenberg:2020). Megjithatë, disa prej ndryshimeve pas Traktatit kërkojnë rregullime me të qendrueshme pa qënë nevoja për amendime për çdo zgjerim.[111]

Vendi që aspiron aderimin në BE, aplikon sipas kritereve të Kopenhagenit dhe një sistemi të bazuar në meritën dhe progresin e vetë vendit aplikant, në Këshillin Europian, i cili vendos në unanimitet mbi dhënien e statusit kandidat, hapjen e negociatave për anëtarësim apo hapjen e kapitujve të rinj të negociatave për anëtarësim. Komisioni Europian paraqet opinionin dhe rekomandimet e tij pas aplikimit, dhe përpara

[107] Council of European Union: Council Statement on the integrity and autonomy of its work. Marrë nga https://www.consilium.europa.eu/media/43068/council-and-commission-statements.pdf

[108] 'Video conference of ministers for European affairs' (2020, Mars 24). Marrë nga https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/gac/2020/03/24/

[109] European Commission: A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, COM(2018) 65 final.

[110] Fact Sheets on the European Union: The Treaty of Lisbon (2020, Shkurt). Marrë nga https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/5/the-treaty-of-lisbon

[111] The Enlargement of the Union: Fact Sheets on the European Union (2019, Dhjetor). Marrë nga https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/167/the-enlargement-of-the-union

negociatave, vlerëson, nëpërmjet nje raporti, çdo pikë të acquis communautaire. Kur progresi vlerësohet i mirë, Komisioni rekomandon mbylljen e përkohshme të kapitullit. Vetëm pasi negociatat për të gjithë kapitujt përfundohen, termat dhe kushtet përfshihen në traktatin ndërmjet Vendeve Anëtare të BE dhe Vendit të Pranuar. Parlamenti Europian njoftohet që në aplikim dhe mbas miratimit të tij, pos unanimitetit të Këshillit, Vendi i pranuar mund të firmosi Traktatin e aderimit në BE. Miratimi i Parlamentit nevoitet që tek zbatimi i MSA dhe Parlamenti ndikon shumat e alokuara për Instrumentin e Asistencës Para-Anëtarësimit, që nevoiten si ndihmë ekonomike për reformimin në përgjigje të kritereve për anëtarësim. Përmes rezolutave vjetore, në përgjigje të raporteve vjetore të vendeve candidate apo potenciale hartuar nga Komisioni, Parlamenti Europian shpre qëndrimin e tij ndaj zgjerimit. Qëndrim që reflekton marrëdheniet bilaterale të rregullta (2 here ne vit) ndërmjet delegacioneve të veta dhe parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor.[112]

Edhe pse kanë kaluar me shume se 10 vjet nga Traktati i Lisbonës, ngre diskutim fakti se disa dispozita të tij ende nuk janë shfrytëzuar. Në përgjigje të kësaj, në Shkurt të 2017, Parlamenti Europian, përshtati një 'resolutë për përmirësimin e funksionimit të BE duke punuar mbi potencialin e Traktatit' për të zhbllokuar pengesat në trajtimin e sfidave nga BE.[113]

Sa i takon Ballkanit Perëndimor, vlen të përmendet se, që pas traktatit të Lisbonës, ka qënë vazhdimisht në vemendje të institucioneve të BE për çeshtje të zgjerimit (përjashtuar periudhës Qershor 2014- Mars 2018), kundër-terrorizmit dhe dimensionit të jashtëm të emigracionit (Anghel:2020). Por mënyra e trajtimit të çështjes ballkanase e ka bërë procesin të humb besueshmërinë dhe ka shkaktuar tepër irritim a lodhje. Mbi të gjitha rrezikon mundësinë e krijimit të grupimeve brenda Unionit. Pa reforma solide, hyrjet e reja do të ndeshen me trekendëshin e grupeve burokratike, grupeve të rregjimeve demokratike joliberale dhe grupeve që janë të përkushtuar totalisht ndaj vlerave dhe parimeve të Europës, një zhvillim që bie në kundërshtim me themelet e integrimit Europian (Stanicek: 2020). Apo si konkludon Anghel&Drachenberg (në punimin për "Keshilli I Europës nën Traktatin e Lisbonës: Si është zhvilluar institucioni

[112] The Western Balkans: Fact Sheets on the European Union (2019, Dhjetor). Marrë nga https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/168/the-western-balkans

[113] Fact Sheets on the European Union: The Treaty of Lisbon (2020, Shkurt). Marrë nga https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/5/the-treaty-of-lisbon

që mbas 2009?”) që Këshilli dhe Parlamenti, përmes Presidenteve të tyre, kanë krijuar një sërë procesesh informale për të këmbyer qendrimet dhe për të informuar njëri tjetrin për aktivitetet respective, që tipikisht ndikohen nga qëllimet individuale.

Megjithatë, pavarësisht se politikat e huaja individuale të vendeve anëtare të BE vijojnë të dominojnë politikat e huaja të përbashkëta, duke e bërë BE thjeshtë si një komunitet mbikombetar ekonomik, BE ka treguar të jetë një model për paqen dhe pajtimin në një hapësirë kaq heterogjene sa kontinenti Europian (Halili:2012). Kjo dëshmuar dhe në komunikatën e Komisionit, mbi strategjinë e zgjerimit të Shkurtit 2018, që e cilësoj lëvizjen ndaj Ballkanit Perëndimor si një ‘dritare historike të mundësisë për t’ju atashuar BE’, se ‘duhet vepruar me vendosshmëri’ dhe se 2025 do ta gjej me shume gjasa Unionin me të bashkuar dhe të fort.

### III.C. Politikat e reja për Ballkanin Perëndimor mbi zgjerimin në BE

Gjithcka nisi me Samitin e Thessalonikisë (2003) midis EU dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo ktheu në vemendje dhe njëherë rëndësinë e zgjerimit drejte këtyre vendeve. Zgjerim i cili sigurisht qendron në linjë me Traktatin e Bashkimit Europian por dhe kriteret e Kopenhagen (1993) ku parashtrohen kushtet thelbësore për vendet candidate që pretendojnë të anëtarësohen në BE. Kriteret përbëhen nga 3 shtylla kryesore: Politike: stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimi I ligjit, të drejtat e njeriut dhe respekti dhe mbrojtja e minoriteteve; Ekonomike: një ekonomi funksionale tregu dhe kapacitet për të bashkëpunuar me konkurrence dhe forca të tregut; Administrative: kapacitet administrues dhe institucional që të mund të zbatojë me efektivitet acquis communautaire dhe aftesitë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Këto kritere bëhen bazë vlerësimi dhe për aftesinë e vendeve anëtare për të përthithur anëtarë të rinj në Union. [114]

Një tjetër iniciative e rëndësishme për Ballkanin Perëndimor është Procesi i Berlinit. Mbështetur nga Kominsioni Europian, institucionet financiare ndërkombëtare dhe vendet anëtare pjesë e procesit (Austria, Kroacia, Franca, Germania, Italia, Sllovenia

[114] European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations: Accession criteria (2016, Dhjetor 6). Marrë nga https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/accession-criteria_en

dhe Anglia), ajo synon rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndihmesën në integrimin Europian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Procesi është konceptuar në 3 dimensione (social, ekonomik, politik) lidhjeje, për të siguruar reformim, zgjidhje të problemeve të brendëshme dhe bilaterale, pajtim dhe bashkëpunim ekonomik dhe rritje të qëndrueshme të shoqërive në fjalë.[115] Ajo u bë shtysë e formimit të një sërë mekanizmave: Seritë e Samitit të Ballkanit Perëndimor (Viene, Paris, Trieste, Londer, Poznan), Forumi i Shoqërisë Civile i Serive të Samitit të Ballkanit Perëndimor, Forumi Rinor, Forumi i Biznesit, dhe institucioneve: Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (RYCO), Forumi i Investimeve të Dhomave të Ballkanit Perëndimor (WBCIF) dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF).

Pavarësisht, kjo iniciative nuk ka treguar arritjet e pritshme në sundiminin e ligjit, zgjidhjen e konflikteve apo përparim sa i takon pajtimit, edukimit dhe kulturës.[116]

Në Shkurt të 2018, komunikata e Komisionit Europian "Një perspektivë zgjerimi e besueshme për dhe rritje e angazhimit të BE me Ballkanin Perëndimor"[117] i dha një drejtim më konkret çeshtjes ballkanase. Pos konfirmimit të qendrimit pozitiv sa i takon zgjerimit, u theksuan dhe njëherë kriteret kyçe për anëtarësim, që në linjë me Traktatin e BE dhe kriteret e Kopenhagenit, përfshinin 4 fusha: sundimi i ligjit, konkurrenca, bashkëpunimi rajonal dhe pajtimi. Këto përkthyer në pavarësi, cilësi dhe efiçence e sistemit gjyqësor, institucione demokratike, administratë publike më cilësore dhe të përgjegjeshme, prokurime publike me profesionale dhe transparente dhe lufte ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sa i takon çeshtjes së konkurrencës Komisioni do të lancojë Agjencinë Dixhitale për Ballkanin Perëndimor ndërsa për bashkëpunimin rajonal fokusi do të jetë siguria e kufinjve, emigrimi dhe manaxhimi i lidhjeve të vendeve, për marrëdhënie miqësore me fqinjet, nëpërmjet krijimit dhe kordinimit nga Komisioni i Task Forcës së BE të të ashtëquajturës ndër-agjenci. Të gjitha të rregulluara nëpërmjet gjashtë iniciativave kryesuese ('Flagship Initiatives') parashtruar në Planin e Veprimit në Mbështetje të Tranformimit të Ballkanit Perëndimor.

---

[115] Civil Society Forum of the Western Balkans: Berlin Process Information and Resource Center. Marrë nga https://berlinprocess.info/about/#wbsummits

[116] Fouéré, E., (2019). The EU's re-engagement with the Western Balkans: A new chapter long overdue. Qëndra për Studime Politike Europiane, No.2019/01.

[117] European Commission: A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, COM(2018) 65 final.

Në këtë kuptim, integrimi i Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor komplementon dhe është me përfitim për integrimin rajonal në strukturën Euro-Atlantike (Halili:2014).

Dokument tjetër i rëndësishëm, lidhur me zgjerimin e Unionit nëpërmjet Ballkanit Perëndimor, është metodologjia e re e zgjerimit "Përmirësimi i procesit të anëtarësimit - Një perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor".[118]

Metodologjia e re mbështetet në katër parime kryesore:

1.Kredibiliteti- në kuptimin që marrëdhëniet e BE me vendet candidate të bazohen në mirëbesim, mirëkuptim dhe përkushtim nga të dyja palët. Pra, kur kushtet plotësohën nga vendi kandidat, vendet anëtare të vijojnë me procesin pa pengesa. Ndërkohë negociatat për kapitullin e politikave thelbësore të hapen të parat dhe të mbyllen të fundit.

2.Udhëheqje politike më të fortë- në kuptimin që BE mbart vlerat dhe standardet me të larta dhe një shoqëri I bashkohet Unionit për zgjedhje. Angazhim më të madh të udhëheqjes së nivelit të lartë të vendeve anëtare me vendet aspirante ndërmjet dialogut politik.

3.Proces me dinamik- Deri më tani, negociatat për antëarësim, ndarë sipas acquis, konsistonin në 36 kapituj, ku secili mbulonte një fushë të caktuar në aspektin politik.[119] Kjo metodologji do ti grupojë këto kapituj në gjashtë sfera tematike: 1.Politika thelbësore, 2.Tregu I brendshëm, 3.Konkurenca dhe rritja gjithëpërfshirëse, 4.Axhenda e Gjelbër ('Green Agenda') dhe lidhjet e qëndrueshme, 5.Burimet, agrikultura dhe kohezioni, si dhe 6.Marrëdhëniet e jashtme.

4. Proces i parashikueshëm, kushtëzim pozitiv ose negativ- Qartësi më të madhe të kërkesave që Unioni ka dhe mbajtjen e një qendrim sa me objektiv (pozitiv ose negativ)

[118] European Commission: Enhancing the accession process - A credible EU perspective for the Western Balkans, COM(2020) 57 final.

[119] Eu Enlargement Factsheet: How does the EU accession process work? Marrë nga https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/publication/factsheet_en.pdf

kur ka dhe kur nuk ka progress. Ndjekje përgjatë të gjithë procesit nga Komisioni duke ofruar një udhëheqje më të qartë dhe transparente për prioritetet dhe pritshmëritë.

Risi është modaliteti i adresimit/trajtimit të problemeve sepse metodologjia e re e zgjerimit parashikon pezullimin e negociatave, rihapjen e kapitujve njëherë të mbyllur dhe rishikimin e financave, përjashtuar mbështetjen e shoqerisë civile.

Ky ndryshim nuk nënkupton amendimin e negociatave në proces por sigurisht përmbushjen e kushteve sipas metodologjisë së re, aty ku ka hapësirë për ndërhyrje. Sipas vlerësimit të Z.Varhelyi në deklaratën e 18 Shkurtit, do të kishte një përfitim në reduktimin e kohës se trajtimit të kapitujve të caktuar në rreth një vit, ndryshe nga mesatarja kohore 6-8 vjet që merr aktualisht mbyllja e një kapitulli negocimi.[120]

Gjithashtu, Komisioni Europian do të përgatit një komunikatë, ndoshta përpara Samitit të Zagrebit, lidhur me planin e veprimit të metodologjisë së re, për të rritur investimet, fondet, mundësitë për çeshtjet mjedisore (‘green economy’), për të lehtësuar integrimin socio-ekonomik dhe aksesin në tregun e vetëm europian, për të forcuar marrëdhënien e fqinjësisë së mirë dhe sundimin e ligjit.

[120] Remarks by Commissioner Várhelyi at the European Policy Centre briefing: Reforming enlargement policy? (2020, Shkurt 2018). Marrë nga https://ec.europa.eu/commission/commissioners/2019-2024/varhelyi/announcements/remarks-commissioner-varhelyi-european-policy-centre-briefing-reforming-enlargement-policy_en

**KAPITULLI I KATËRT -Risitë dhe Problematikat e Traktatit të Lisbonës**



***Risitë***

Procesi që çoi në Traktatin e Lisbonës është rezultat i dy referendumeve mbi Traktatin Kushtetues në Maj dhe Qershor 2005, në përgjigje të të cilit Këshilli Europian vendosi një afat dy vjeçar për rishikime të mundshme. Në fund, në bazë të deklaratës së Berlinit të Marsit 2007, Këshilli Europian nga 21 deri në 23 Qershor 2007 miratoi një mandat të detajuar për një Konferencë Ndërqeveritare (IGC) pasuese, nën presidencën Portugeze. IGC përfundoi punimet e saj në Tetor 2007. Traktati u nënshkrua në Këshillin Europian të Lisbonës në 13 Dhjetor 2007 dhe u ratifikua nga të gjitha shtetet anëtare.

Traktati për krijimin e Komunitetit Europian është riemëruar "Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian" dhe termi "Komunitet" u zëvendësua me "Union" gjatë të gjithë tekstit të përmbajtjes së aktit. Unioni zë vendin e Komunitetit dhe është pasardhësi i tij ligjor. Traktati i Lisbonës nuk krijoi simbole shtetërore të Unionit/ Bashkimit si një flamur apo një himn i vetëm. Edhe pse teksti i ri nuk është më një marrëveshje kushtetuese nga emërtimi, ai ruan shumicën e arritjeve kryesore.

Me Traktatin e Lisbonës, asnjë kompetencë shtesë ekskluzive nuk transferohet në Bashkimin Europian. Sidoqoftë, ajo ndryshon mënyrën sesi Unioni ushtron fuqitë e tij ekzistuese dhe disa fuqi të reja (të përbashkëta), duke rritur pjesëmarrjen dhe mbrojtjen e qytetarëve, duke krijuar një strukturë të re institucionale dhe duke modifikuar proceset e vendimmarrjes për rritjen e efikasitetit dhe transparencës. Prandaj arrihet një nivel më i lartë i shqyrtimit parlamentar dhe përgjegjësisë demokratike.

Për dallim nga Traktati Kushtetues, Traktati i Lisbonës nuk përmban asnjë artikull që përcakton zyrtarisht epërsinë e së drejtës së Bashkimit mbi legjislacionin kombëtar, por për këtë qëllim i është bashkangjitur një deklaratë, duke iu referuar një opinioni të Shërbimit Ligjor të Këshillit, i cili përsërit praktikat gjyqësore të qëndrueshme të Gjykatës.

Traktati i Lisbonës për herë të parë sqaron fuqitë e Unionit. Ai dallon tre lloje të kompetencave:

-kompetencë ekskluzive, kur Unioni, i vetëm, mund të përgatisë ligje, dhe vendet anëtare vetëm i zbatojnë ato;

-kompetencë e përbashkët, kur vendet anëtare mund të bëjnë dhe miratojnë masa ligjërisht detyruese nëse Unioni ende nuk e ka bërë një gjë të tillë;

-dhe kompetencë mbështetëse, kur BE-ja miraton masa për të mbështetur ose plotësuar politikat e vendeve anëtare.

Kompetencat e Unionit tani mund t'u kthehen vendeve anëtare gjatë rishikimit të një traktati.

Traktati i Lisbonës përfundimisht i jep BE-së personalitet të plotë juridik. Kështu, Unioni fiton aftësinë për të nënshkruar traktate ndërkombëtare në fushat e kompetencave të tij ose të anëtarësohet në një organizatë ndërkombëtare. Vendet anëtare mund të nënshkruajnë vetëm marrëveshje ndërkombëtare që janë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Traktati për herë të parë parashikon një procedurë zyrtare që duhet të ndiqet nga vendet anëtare që dëshirojnë të tërhiqen nga Bashkimi Europian në përputhje me kërkesat e tyre kushtetuese, cituar në nenin 50 TEU.

Traktati i Lisbonës asimilon aspektet e shtyllës së tretë të mbetur në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë (FSJ), siç është bashkëpunimi policor dhe gjyqësor në çështjet penale, në shtyllën e parë. Struktura e dikurshme ndërqeveritare pushon së ekzistuari, pasi aktet e miratuara në këtë fushë tashmë bëhen objekt i procedurës së zakonshme legjislative (shumicë e kualifikuar dhe vendimmarrje e përbashkët), duke përdorur instrumentet juridikë të metodës së Komunitetit (rregulloret, direktivat dhe vendimet) përpos rasteve kur përcaktohet ndryshe.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Parlamenti Europian është në gjendje të propozojë ndryshime në traktate, në qeveri të vendeve anëtare ose Komisionin. Normalisht, një ndryshim i tillë do të kërkonte thirrjen e një Konvente e cila do të rekomandonte ndryshime në një IGC (Këshilli Europian, gjithësesi, mund të vendosë të mos i bashkohet një Konvente të tillë, në varësi të pëlqimit të Parlamentit (neni 48 (3) TEU, paragrafi i dytë). Pastaj një IGC mund të thirret për të përcaktuar ndryshimet në Traktate me marrëveshje të përbashkët. Sidoqoftë, është gjithashtu e mundur të rishikohen Traktatet pa thirrur një IGC dhe përmes procedurave të thjeshtuara të rishikimit, kur rishikimi ka të bëjë me politikat dhe veprimet e brendshme të Unionit (neni 48 (6) dhe 48 (7) TEU). Rishikimi do të miratohet më pas si vendim i Këshillit Europian, por mund të mbetet subjekt i rregullave të ratifikimit kombëtar.

Demokraci e përmirësuar dhe mbrojtje më e mirë e të drejtave themelore[121]

Traktati i Lisbonës shpreh tre parimet themelore të barazisë demokratike, demokracisë përfaqësuese dhe demokracisë pjesëmarrëse. Demokracia pjesëmarrëse merr formën e re të iniciativës së qytetarëve.

Karta e të Drejtave Themelore nuk është e përfshirë drejtëpërdrejtë në Traktatin e Lisbonës, por merr një karakter ligjor detyrues përmes nenit 6 (1) TEU, i cili i jep Kartës të njëjtën vlerë ligjore si Traktatet.

Procesi i pranimit të BE-së në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut u hap kur protokolli i 14-të i KEDNJ hyri në fuqi më 1 Qershor 2010. Kjo lejoi që jo vetëm shtetet por edhe një organizatë ndërkombëtare, d.m.th. Bashkimi Europian, të bëhen nënshkrues të KEDNJ-së. Aderimi ende kërkon ratifikim nga të gjitha vendet që janë palë në KEDNJ, si dhe nga vetë BE-ja. Negociatat midis Këshillit të Europës dhe përfaqësuesve të BE çuan në përfundimin e një draft-marrëveshjeje në Prill 2013, e cila, sidoqoftë, u konsiderua e papajtueshme me nenin 6 TEU nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian. Bisedimet e mëtejshme do të ishin  të domosdoshme përpara se të fillojë anëtarësimi.

Organizimi institucional

**Parlamenti Europian**

Në zbatim të Nenit 14 (2) TEU, PE tani është i përbërë nga përfaqësuesit e qytetarëve të Unionit, jo nga përfaqësuesit e popujve të shteteve.

Kompetencat legjislative të PE janë rritur përmes procedurës së zakonshme legjislative, e cila zëvendëson procedurën e mëparshme të vendimarrjes së përbashkët. Kjo procedurë tani vlen për më shumë se 40 fusha të reja të politikave, duke rritur numrin e përgjithshëm në 73. Procedura e dakortësisë vazhdon të ekzistojë si 'miratim', dhe procedura e konsultimit mbetet e pandryshuar. Procedura e re buxhetore krijon barazi të plotë midis Parlamentit dhe Këshillit për miratimin e buxhetit vjetor. Korniza/Kuadri Financiar Shumëvjeçar duhet të dakortësohet nga Parlamenti.

[121] Fact Sheets mbi Bashkimin Europian: The Treaty of Lisbon (2020, Shkurt). Marrë nga https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/5/the-treaty-of-lisbon

PE tani zgjedh Presidentin e Komisionit nga shumica e anëtarëve të tij me një propozim të Këshillit Europian, i cili është i detyruar të zgjedhë një kandidat me shumicë të kualifikuar, duke marrë parasysh rezultatin e zgjedhjeve Europiane. PE vazhdon të aprovojë Komisionin si kolegj.

Numri maksimal i eurodeputetëve është në rreth 751, vendosur kjo me përfaqësimin e qytetarëve në përpjesëtim degresiv. Numri maksimal i vendeve për një vend anëtar është reduktuar në 96 ndërsa numri minimal është rritur në 6. Më 7 Shkurt 2018, Parlamenti votoi në favor të zvogëlimit të numrit të vendeve të saj nga 751 në 705 me largimin e Mbretërisë së Bashkuar nga BE dhe rishpërndarjen e disa vendeve midis atyre vendeve anëtare që janë më pak të përfaqësuara.

Mbretëria e Bashkuar u largua nga BE më 1 Shkurt 2020. Deri në këtë moment, është aplikuar përbërja e re me 705 eurodeputetë. Nga 73 vendet bosh prej tërheqjes së Mbretërisë së Bashkuar, 27 vende janë shpërndarë për të pasqyruar më mirë parimin e proporcionalitetit degresiv: 27 vende janë shpërndarë në: Francë (+5), Spanjë (+5), Itali (+3), Hollandë (+3), Irlandë (+2), Suedi (+1), Austri (+1), Danimarkë (+1), Finlandë (+1), Sllovaki (+1), Kroaci (+1), Estoni (+ 1), Polonia (+1) dhe Rumania (+1). Prej vendeve anëtare nuk është humbur asnjë vend.

**Këshilli Europian**

Traktati i Lisbonës e njeh zyrtarisht Këshillin Europian si një institucion të BE-së, përgjegjës për t'i dhënë Bashkimit ‘impulsin e nevojshëm për zhvillimin e tij’ dhe për përcaktimin e ‘drejtimeve dhe përparësive të përgjithshme politike’ të tij. Këshilli Europian nuk ka funksione legjislative. Një presidencë afatgjatë zëvendëson sistemin e mëparshëm të rotacionit gjashtëmujor. Presidenti zgjidhet nga një shumicë e kualifikuar e Këshillit Europian për një afat të rinovueshëm për 30 muaj. Kjo për të përmirësuar vijimësinë dhe koherencën e punës së Këshillit Europian. Presidenti gjithashtu përfaqëson Unionin në marëdhëniet me jashtë, pa paragjykuar detyrat e Përfaqësuesit të Lartë të Unionit për Punë të Jashtme dhe Politikën e Sigurisë.

**Nënkryetari i Komisionit / Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë (NK / PL)**

NK/PL emërohet nga një shumicë e kualifikuar e Këshillit Europian sipas marrëveshjes me Presidentin e Komisionit dhe është përgjegjës për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së, me të drejtën për të paraqitur propozime. Përveç kryesimit të

Këshillit të Punëve të Jashtme, NK/PL gjithashtu ka rolin e Nënkryetarit të Komisionit. NK/PL ndihmohet nga Shërbimi Europian për Veprim të Jashtëm, i cili përfshin personelin e Këshillit, Komisionin dhe shërbimet diplomatike kombëtare.

**Këshilli**

Lisbona mban parimin e votimit me shumicë të dyfishtë (qytetarët dhe shtetet anëtare). Sidoqoftë, marrëveshjet e mëparshme i shtrin efektet deri në Nëntor 2014; që prej 1 Nëntorit të 2014-s, zbatohen rregullat e reja.

Një shumicë e kualifikuar arrihet kur 55% e anëtarëve të Këshillit (në praktikë, 15 shtete nga 27), që përbëjnë të paktën 65% të popullsisë, mbështesin një propozim (neni 16 (4) TEU). Kur Këshilli nuk vepron me një propozim të Komisionit ose NK/ PL, shumica e nevojshme e vendeve anëtare rritet në 72% (neni 238 (2) TFEU). Për të bllokuar legjislacionin, të paktën katër vende anëtare duhet të votojnë kundër një propozimi. Një skemë e re, e frymëzuar nga "kompromisi i Janinës", lejon 55% të vendeve anëtare të nevojshme për bllokimin e pakicës që të kërkojnë rishqyrtimin e një propozimi gjatë një "periudhe kohe të arsyeshme" (Deklarata 7).

Këshilli mblidhet në publik kur diskuton dhe voton për një akt legjislativ. Për këtë qëllim, çdo mbledhje e Këshillit është e ndarë në dy pjesë, që kanë të bëjnë me akte legjislative dhe aktivitete jo-legjislative. Kryesia e Këshillit vazhdon me sistem rotacioni mbi një bazë gjashtë mujore, por ka presidenca grupore 18-mujore të tre shteteve anëtare për të siguruar vijimsi më të mirë të punës. Si përjashtim, Këshilli i Punëve të Jashtme kryesohet vazhdimisht nga Nënkryetari i Komisionit / Përfaqësuesi i Lartë.

**Komisioni**

Meqenëse Presidenti i Komisionit tani zgjidhet duke marrë parasysh rezultatin e zgjedhjeve Europiane, rritet legjitimiteti politik i zyrës. Presidenti është përgjegjës për organizimin e brendshëm të kolegjit (emërimin e komisionerëve, shpërndarjen e portofoleve, trajtimin e kërkesve për të dhënë dorëheqjen në rrethana të veçanta).

**Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian**

Juridiksioni i Gjykatës shtrihet në të gjitha aktivitetet e Unionit me përjashtim të CFSP. Qasja në Gjykatë lehtësohet dhe më tej për individët.

Krijimi i politikave më efikase dhe demokratike shpalosur në politika dhe kompetenca të reja

Disa të ashtuquajtura 'klauzola paserele' lejojnë një ndryshim nga vendim-marrja unanime në votim me shumicë të kualifikuar (QMV) dhe nga procedura e konsultimit në vendimarrje të përbashkët (neni 31 (3) TEU, nenet 81, 153, 192, 312 dhe 333 TFEU, plus disa tip klauzola paserele të procedurave në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale). Në fjalimin e tij për gjendjen e Unionit për vitin 2017, Presidenti i Komisionit Juncker njoftoi iniciativat për t'u larguar nga rregulli i unanimitetit në një numër fushash duke përdorur klauzolat paserele. Për rrjedhojë, Komisioni miratoi dy propozime; një në Shtator 2018 për të kaluar nga unanimiteti në votimin me shumicë të kualifikuar në fushat e zgjedhura të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë , një në Janar 2019 duke propozuar një ndërrim të ngjashëm për çështjet e zgjedhura të politikës tatimore.

Në fushat kur Unioni nuk ka fuqi ekskluzive, të paktën nëntë vende anëtare mund të krijojnë një bashkëpunim të zgjeruar ndërmjet tyre. Autorizimi për përdorimin e tij duhet të jepet nga Këshilli pasi të ketë marrë pëlqimin e Parlamentit Europian. Për çështjet e CFSP, zbatohet unanimitet.

Traktati i Lisbonës forcon ndjeshëm parimin e subsidiaritetit duke përfshirë parlamentet kombëtar në procesin e vendimmarrjes së BE-së.

Një numër i caktuar i politikave të reja ose të zgjeruara janë parashikuar mbi politikën e mjedisit, që tani përfshin luftën kundër ndryshimit të klimës, dhe politikën e energjisë, e cila bën referime të reja për solidaritetin dhe sigurinë dhe ndërlidhshmërinë e furnizimit. Më tej akoma, subjekte të mundshme të bërjes së ligjit të BE-së janë zgjeruar në të drejtat e pronësisë intelektuale, sportit, hapësirës, turizmit, mbrojtjes civile dhe bashkëpunimit administrativ.

Në lidhje me Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP), Traktati i Lisbonës prezanton një klauzolë të mbrojtjes së ndërsjellëtë e cila parashikon që të gjitha vendet anëtare janë të detyruara t'i japin ndihmë një vendi anëtar nën sulm. Një klauzolë solidariteti parashikon që Unioni dhe secili prej vendeve anëtare të tij duhet të ofrojnë ndihmë me të gjitha mjetet e mundshme për një vend anëtar të prekur nga një katastrofë njerëzore ose natyrore, ose nga një sulm terrorist. Një bashkëpunim i strukturuar i përhershëm është i hapur për të gjitha vendet anëtare që angazhohen të

marrin pjesë në programet europiane të pajisjeve ushtarake dhe të sigurojnë njësi luftarake që janë në dispozicion për veprim të menjëhershëm. Për të krijuar një bashkëpunim të tillë, është e nevojshme të merret një shumicë e kualifikuar në Këshill pas konsultimit me NK/PL.

Në lidhje me IGC-në e vitit 2007, që çoi në nënshkrimin e Traktatit të Lisbonës, Parlamenti për herë të parë dërgoi tre përfaqësues në Konferencë, nën presidencën Portugeze.

Pothuajse një dekadë pas nënshkrimit të Traktatit të Lisbonës, Parlamenti pranoi se disa nga dispozitat e tij nuk po shfrytëzoheshin në maksimum. Si përgjigje ndaj saj, më 16 Shkurt 2017 ajo miratoi një rezolutë për përmirësimin e funksionimit të Bashkimit Europian ndërtuar mbi potencialin e Traktatit të Lisbonës, i cili parashtron një numër rekomandimesh se si të zhbllokohet ky potencial në mënyrë që të përmirësohet aftësia për të trajtuar sfidat aktuale globale.

Rezoluta e Parlamentit Europian P8_TA (2017) 0049 e datës 16 Shkurt 2017 për "P*ërmirësimin e funksionimit së Bashkimit Europian duke 'ndërtuar' mbi potencialin e Traktatit të Lisbonës"* (2014/2249 (INI)) vëren se Bashkimi Europian dhe shtetet e tij anëtare po përballen me sfida të pashembullta, të tilla si kriza e refugjatëve, sfidat e politikës së jashtme me fqinjët e afërt dhe luftën kundër terrorizmit, si dhe globalizimin, ndryshimin e klimës, zhvillimet demografike, papunësinë, shkaqet dhe pasojat e krizës financiare dhe të borxheve, mungesa e konkurrencës dhe pasojat sociale në disa shtete anëtare dhe nevoja për të forcuar tregun e brendshëm të BE-së; të gjitha këto duhet të adresohen në mënyrë më adekuate.

Me këtë shqetësim, rezoluta parashtron në 3 fusha aspektet përmes të cilave mund të sigurohet përmirësimi: organizimi institucional, demokracia dhe përgjegjshmëria, roli i buxhetit të BE-së në EMU, veprimet e jashtme dhe punët e brendshme.[122]

Organizimi institucional, demokracia dhe përgjegjshmëria parashtron veprimet e nevojshme për Parlamentin, Keshillin, Komisionin Europian, Gjykatën e Auditorëve, Agjensitë si dhe politika të tjera lidhur me respektimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit, zgjerimin dhe thellimin e Unionit Ekonomik dhe Monetar (EMU),

[122] Parlamenti Europian. (2017, Shkurt). "*Për përmirësimin e funksionimit të Bashkimit Europian duke 'ndërtuar' mbi potencialin e Traktatit të Lisbonës"* (2014/2249 (INI)). PE Bruksel, Belgjikë.

hartimi i aktit të ri juridik mbi politikën ekonomike, një proces i thjeshtuar, më i përqëndruar dhe më demokratik i procesit .

Sa i takon rolit të buxhetit të BE-së në EMU ai parashikohet përmes një kapaciteti të rritur për investime në BE, vendosje të një kapaciteti fiskal brenda zonës së euros përmes një pjese të buxhetit të BE-së, tregun e vetëm dhe integrim financiar, një strukturë institucionale më demokratike për EMU, përfytyrim i tregut të brendshëm si gjeneratori kryesor i rritjes si dhe dimensioni shoqëror që lidhet me të drejtat themelore, veçanërisht ato të punonjësve.

Veprimet e jashtme lidhen me rritjen e efektivitetit, koherencës dhe llogaridhënies së Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë (CFSP) si dhe ecuria drejtë një politike të përbashkët mbrojtëse.

Në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme (JHA) nënvizohet se, duke mbështetur të drejtat dhe liritë themelore dhe duke insistuar në nevojën për një mbikëqyrje demokratike dhe gjyqësore mbi politikat e luftës kundër terrorizmit, në dritën e sulmeve të fundit dhe rritjen e kërcënimit terrorist, një sistem i detyrueshëm dhe shkëmbim i strukturuar i informacionit dhe të dhënave midis autoriteteve kombëtare të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve të inteligjencës, dhe me Europol, Frontex dhe Eurojust, është absolutisht thelbësor dhe duhet të vendoset sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në të njëjtën ditë, Parlamenti miratoi gjithashtu një rezolutë *mbi evolucionin e mundshëm dhe rregullimet në strukturën institucionale aktuale të Bashkimit Europian*, duke sugjeruar propozime konkrete për reformat e traktatit.

Rezoluta e Parlamentit Europian P8_TA (2017) 0048 e datës 16 Shkurt 2017 mbi *evolucionet e mundshme dhe rregullimet në strukturën institucionale aktuale të Bashkimit Europian* (2014/2248 (INI)) parashtron këto politika si të nevojshme: përfundimin e 'Europe à la carte', qeverisjen e re ekonomike për rritjen ekonomike, kohezioni shoqëror dhe stabiliteti financiar ndaj sfidave të reja, forcim të politikës se të jashtme, ruajtje të të drejtave themelore, më shumë demokraci, transparencë dhe përgjegjshmëri si dhe disa procese të tjera përbërëse që lidhen me angazhimin e Unionit për të luajtur një rol udhëheqës në këto zhvillime të rëndësishme kushtetuese dhe vendosshmërinë për të bëre propozimet e veta për ndryshimin e Traktatit në kohën e duhur.

***Problematikat***

Pas një procesi intensiv ratifikimi, Traktati i Lisbonës hyri në fuqi në Dhjetor 2009. Ai ngriti shumë diskutim në botën akademike dhe politike. Ka kaluar rreth një dekadë nga hyrja në fuqi e Traktatit dhe kjo periudhë mund të shërbej për të bërë një analizë kushtetuese dhe institucionale të ndryshimeve që ai solli, në terma të efiçencës. Duke konsideruar këtu se, i gjithë aktiviteti i BE-së rregullohet nga traktatet dhe nga ana tjetër qendrojnë të gjithë problematikat kaluar në këto vite.

*Rrugëtimi i Traktatit të Lisbonës*

Procesi i reformimit të BE filloi në vitin 2000 në Konferencën Ndërqeveritare në Nicë, ku u diskutua e ardhmja e Bashkimit Europian. Traktati i Nicës kishte lënë disa çështje të pazgjidhura dhe për pasojë kishte krijuar pakënaqësi. Në 2001, Këshilli Europian miratoi Deklaratën e Lejkenit, e cila bëri thirrje për një thjeshtësim dhe riorganizim të traktateve të BE-së. U përcaktuan disa çështje kryesore: ndarja e kompetencave midis Bashkimit dhe Shteteve Anëtare të saj; thjeshtëzimi i instrumenteve legjislative të Unionit; mirëmbajtja e ekuilibrit ndërinstitucional dhe përmirësimi i efikasitetit të procedurës së vendimmarrjes; dhe dhënia e fuqisë kustetuese traktateve.

Çështjet e paraqitura në Deklaratën e Lejken u diskutuan në Konventën mbi të Ardhmen e Europës. Konventa u formua për të bashkuar palët kryesore të interesuara në një debat. Ajo përbëhej nga përfaqësues të Shteteve Anëtare, Parlamentit Europian, të parlamenteve kombëtar dhe Komisionit. Qëllimi i saj ishte paraqitja e një draft-traktati që do të shërbente si kushtetuta e BE-së në konferencën e ardhshme ndërqeveritare. Kështu në vitin 2003, Konventa ra dakord për atë që u bë draft Traktati i cili krijoi Traktatin Kushtetues të Europës. Përmbajtja ishte baza mbi të cilën do të zhvilloheshin negociatat midis Shteteve Anëtare. Këshilli Europian e miratoi në vitin 2004 këtë traktat.

Ashtu si me të gjitha rishikimet e Traktatit të BE-së, Traktati Kushtetues duhej të ratifikohej nga të gjitha shtetet anëtare. Në disa shtete anëtare, një vendim mbi ratifikimin duhej të merrej nga parlamenti kombëtar. Në shtetet e tjera anëtare, duhej të organizohej një referendum. E gjitha varet nga rregullat kombëtare (kushtetuese). Procesi i ratifikimit nuk mundi të përfundonte për shkak të referendumeve në 2005-ën të Francës dhe Hollandës që refuzuan Traktatin. Traktati Kushtetues duhej të shfuqizohej. Kështu, Këshilli Europian vendosi që do të ishte e nevojshme një "periudhë reflektimi".

Në Qershor 2007, Këshilli Europian miratoi një mandat për një Konferencë Ndërqeveritare me qëllim hartimin e "Traktatit të Reformës". Në Tetor të po atij viti, nën presidencën Portugeze, u arrit marrëveshja dhe u paraqit një përmbajtje e traktatit si e njohim ne sot nën emrin Traktati i Lisbonës.

Ishte një ndjenjë e përgjithshme se Traktati Kushtetues kishte dështuar pasi pretendonte se ishte një dokument kushtetues; ai e kishte bërë BE të duket si një shtet federal dhe për këtë arsye përbënte një kërcënim për sovranitetin kombëtar. Si pasojë, në Traktatin e Lisbonës, shumë nga elementët  të ashtëquajtur kushtetues u lanë jashtë. U fshinë dispozitat për "himnin" dhe "flamurin" e BE-së dhe dispozita të ndjeshme, si për shembull ajo për përparësinë e ligjit të BE-së mbi ligjin e vendeve anëtare. Por, ndryshe nga Traktati Kushtetues, Traktati i Lisbonës nuk i shfuqizoi dhe zëvendësoi traktatet ekzistuese. Përkundrazi, ai shërbeu si  një traktat ndryshues që reformoi traktatet e mëparshme.

Kjo bëri që më në fund Traktati të miratohej madje pa qënë i nevojshëm një referendum në Francë dhe Hollandë.

Në Qershor 2008, traktati u refuzua në një referendum në Irlandë. Pas këtij referendumi, Këshilli Europian ra dakord për disa garanci që do të adresonin disa nga shqetësimet irlandeze. Kryesorja ishte sistemi i ri për Komisionerët, që nënkuptonte reduktimin e numrit të komisionerëve, i cili duhej të shfuqizohej. Pavarësisht se traktati nuk u rishikua, pas këtyre garancive, u mbajt në Tetor 2009 një referendum i dytë dhe këtë herë Irlanda votoi pro traktatit.

Procesi i ratifikimit u bë gjithashtu një çështje në shtetet e tjera anëtare. Në disa shtete anëtare, Gjykatat Supreme duhej të vendosnin nëse Traktati i Lisbonës ishte në përputhje me kushtetutën e brendshme. Situata ishte veçanërisht e komplikuar në Poloni dhe Republikën Çeke. Republika Çeke më në fund arriti të marrë garancitë e caktuara nga Këshilli Europian se Protokolli mbi Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së me Mbretërinë e Bashkuar dhe Poloninë do të përfshinte dhe Republikën Çeke. Kjo bëri që traktati të mund të ratifikohej. Edhe Polonia vendosi të ratifikojë Traktatin e Lisbonës pas referendumit të dytë irlandez. Traktati i Lisbonës më në fund hyri në fuqi më 1 Dhjetor 2009, pasi ishte ratifikuar nga të gjitha Shtetet Anëtare. (Sodersten:2019)

*Reagimi ndaj krizave duke vepruar jashtë Traktatit*

Duke njohur dinamikën e institucioneve kryesore të BE, trajtuar më herët në këtë punim, mund të shikojmë disa praktika institucionale të cilat tregojnë si, nën presionin e ngjarjeve, Unioni përtërin dhe përshtatet pa ndërhyrë në traktat. Pra, evidentohet se si Traktati lejon hapësira zhvillimi nën të apo tregon për zhvillime të mëvonëshme të tij.

Praktika institucionale jashtë Traktatit ka qenë krijimi progresiv i një institucioni tjetër në nivelin e liderëve njohur si samiti i euros. Ndërsa Parisi dëshironte që të kishte një organ politik në nivelin presidencial që mbikëqyrte zonën e euros, Berlini gjithmonë i rezistonte asaj nga frika e 'politizimi' pa nevojë të politikës ekonomike dhe monetare dhe minimi i pavarësisë së BQE-së.

Në kulmin e krizës bankare të vitit 2008, kur dhe sistemi bankar gjerman ishte njëkohësisht në probleme, atëherë presidenti i Këshillit Europian Nicolas Sarkozy arriti të mblidhte në Tetor 2008 samitin e parë të liderëve të zonës së euros.

Megjithëse kancelarja gjermane Angela Merkel e kishte lejuar që të mblidhej privatisht që në Janar 2010 se ajo nuk dëshironte që të mblidhej përsëri një samit i tillë, shpërthimi i krizës Greke të vitit 2010 e detyroi Kryetarin e Këshillit Europian të bënte si paraardhësi dhe të mblidhte takimin e liderëve të zonës së euros. Ai u zhvillua në kufijtë e Këshillit Europian të Mars 2010: Takimi i 27 liderëve të BE u ndërpre për pak kohë, në mënyrë që 16 liderët e eurozonës të mund të bënin marrëveshje ndërmjet tyre. Pas këtij takimi, në 7 Maj 2010 vijoi një takim i veçantë i liderëve të eurozonës. Ishte një takim shumë dramatik, i nevojshëm për të shmangur një kërcënim akut për eurozonën dhe për të vendosur në lëvizje vendimet e takimit të mëparshëm gjatë së cilës u projektua pararendësi i fondit të shpëtimit ESM (Objekti i Stabilitetit Financiar Europian 750 miliardë euro, ose EFSF) dhe BQE rriti veprimin e saj. Precedenti tani ishte vendosur në mënyrë definitive. (Middelaar:2019)

Pas një tjetër samiti të posaçëm për krizën në verën e 2011, plus sa të tjerëve afër me takimet e rregullta, organi fitoi një status zyrtar. Më 23 Tetor 2011, ai e quajti veten 'Samitin i Euros'; tre ditë më vonë, në konsultim me Këshillin e plotë Europian, ai i dha vetes një paketë detyrash, rregullash proceduriale dhe një mekanizëm administrativ. Traktati i Stabilitetit Fiskal i fillim vitit 2012, edhe pse ishte zyrtarisht i jashtëm nga Traktati i Unionit, parashikoi samite të paktën dy herë një vit. Megjithatë, rezistenca ndaj forumit mbeti si në Gjermani ashtu edhe në vendet jashtë euros si Polonia. Pjesërisht për këtë arsye, frekuenca e takimeve u zvogëlua pasi kriza e euros u vu nën

kontroll. Zyrtarisht, ndodhi vetëm një samit i Euros në 2012–2014; kur kriza Greke u ndez përsëri në 2015, numri u rrit në katër.

Samitet e euros kanë provuar të jenë një mjet për të marrë vendime në kohë krize. Për vendimet e përditshme të vendeve të eurozonës, Këshilli i plotë Europian, aty ku është e nevojshme, shërben si maja e piramidës vendim-marrëse të euros, duke konsideruar që liderët e vendeve anëtare kanë nën vehte eurogrupin me ministrat përkatës të financave dhe organet e tyre përgatitore/mbështetëse. Shfaqja e Samitit të Euros është ilustruese e një Unioni që institucionalisht rinovon veten nën presionin e ngjarjeve: së pari jashtë traktatit, pastaj hap pas hapi brenda strukturave ekzistuese dhe fiton aftësinë për të marrë vendime kolektive të shpejta dhe autoritare.

Mund të supozohet se nëse Traktati i Lisbonës pëson një rishikim të plotë në të ardhmen, samiti i euros do të marrë statusin e plotë të Traktatit. Mësimi kushtetues këtu është se ndryshimet e traktatit mund të jenë  më shumë për kodifikimin sesa modifikimi.

Një praktikë tjetër, është krijimi i grupeve joformale të liderëve që drejtojnë vendim-marrjen. Brenda BE-së, qarqet e tilla joformale të brendshme janë një çështje delikate, e diskutueshme. Frika përfundimtare e shteteve më të vogla anëtare është që të mbizotërohet nga një drejtori e shteteve të mëdha, siç ishin dikur, në Kongresin e Vjenës (1814-1815), ku vetëm pesë fuqitë ridizajnuan hartën e Europës. Pas Luftës së Dytë Botërore, Komuniteti Europian i dha fund kësaj logjike . Sidoqoftë, në praktikë, Franca dhe Gjermania  ndonjëherë silleshin si vendim-marrësit e vetëm. Nga De Gaulle dhe Adenauer në vitet 1960 deri tek Merkel dhe Sarkozy në 2010–2011, kjo gjithmonë ka krijuar mosbesim të thellë midis liderëve të tjerë. Dilema për shtetet më të vogla është nëse duhet të hidhnin poshtë ndonjë iniciativë të madhe shtetërore si të rrezikshme dhe jolegjitime apo të pranonin se nuk mund t'i ndalonin të takoheshin dhe të përpiqeshin t'i kanalizonin forcat në strukturat e përbashkëta.

Qasja e fundit çon në forume të përziera, në qarqe të brendshme me një numër të kufizuar të përfaqësuesve të BE-së dhe atyre kombëtar. Ata mund të rezultojnë më të ligjshëm dhe më të aftë se një organizim franko-gjerman. Shembulli më i mirë i një rrethi kaq të përzier të brendshëm ishte Grupi i Frankfurtit, ku ndërmjet Tetorit 2011 dhe Marsit 2012 u përgatitën shumë vendime për krizën e euros. (Middelaar:2019).

Përfshirja e një pune të tillë në strukturat zyrtare është padyshim e domosdoshme, në BE edhe më shumë sesa në një kontekst kombëtar. Në të njëjtën kohë, menaxhimi i krizës me 30 persona në një dhomë samiti është i pamundur. Kjo situatë kërkon nga të gjithë pjesëmarrësit një balancim të kujdesshëm midis ngjarjeve, autoritetit politik dhe ligjit.

Në punët e jashtme të BE, një fushë ku pabarazia praktike midis Shteteve Anëtare për sa i përket historisë, përgjegjësisë dhe aftësisë për të vepruar pranohet më lehtë, grupe të tilla informale janë më të zakonshme. Dikush mund të mendojë, para Lisbonës, për iniciativën Paris-Londër-Berlin 2003 kundër Iranit, e cila së shpejti u përfshi në strukturat zyrtare të BE-së falë përfshirjes së Përfaqësuesit të Lartë Javier Solana dhe më vonë, përfshirja e pasardhësve të tij Catherine Ashton dhe Federica Mogherini. Gjatë shtrirjes së Rusisë mbi Ukrainën, u krijua në pranverën e vitit 2014 Formati i Normandisë, duke bashkuar drejtuesit e Francës, Gjermanisë, Rusisë dhe Ukrainës, në këtë rast pa përfshirjen e BE-së, megjithëse presidenti dhe kancelari pyetën sistematikisht kolegët e tyre në Këshillin Europian.

Brenda BE-së, mbledhje të tilla joformale nuk mund të vënë kurrë një kamp kundër tjetrit dhe mund të funksionojnë vetëm nëse ato lidhin pozicionet e ndryshme me një situatë të caktuar konflikti. Konkretisht, përgatitja gjermano-franceze në krizën e euros ishte thelbësore pikërisht sepse ata nuk pajtoheshin absolutisht dhe sepse të dy flisnin në mënyrë implicite për një grup shtetesh që ndajnë të njëjtën mendësi, në Veri dhe Jug. Në lidhje me këtë, është mbresëlënëse që në krizën e refugjatëve nuk u shfaq asnjë organ informal i krizës që shkrinte të gjitha pozicionet, vetëm grupe të shteteve që ndajnë të njëjtën mendësi. Kjo edhe për shkak të armiqësisë midis aktorëve kryesorë që mund të ketë kontribuar në perceptimin e publikut mbi kaosin dhe humbjen e kontrollit.

Por këto grupime informale, ndryshe nga samiti i Euros, me siguri do të mbeten vetëm në kufirin e praktikës dhe ligjit.

Kriza tjetër e madhe që goditi Bashkimin në dekadën e fundit ishte largimi i Mbretërisë së Bashkuar pas referendumit të vitit 2016. Për dallim nga trazirat e euros, konfliktit gjeopolitik me Rusinë dhe drama e refugjatëve, Brexit nuk kërkonte veprime të menjëhershme në kuptimin e reagimit ndaj situatës. Megjithëse rezultati i referendumit dëshmoi një tronditje të vërtetë politike për BE-në, shumica e pasigurive qëndronin në

anën e Londrës. Shumë shpejt vendet e BE, u treguan në gjendje të organizoheshin si një bllok, për të filluar procesin e ndarjes. Baza e tyre u vendos nga presidentët e katër institucioneve politike në ditën pas referendumit dhe u konfirmua nga Këshilli Europian i 29 Qershorit 2016, i pari format në të ashtuquajturin Nenin 50, pa shtetin e tërhequr.

Ky kohezion politik doli i qëndrueshëm, në një pjesë të madhe për shkak të emërimit të një Kryenegociatori të Unionit nën personalitetin e Michel Barnier. Megjithëse pozicioni nuk është një inovacion institucional në vetvete, ai e përdori atë në një mënyrë të pashembullt si për të negociuar me Mbretërinë e Bashkuar, ashtu edhe për të forcuar unitetin e BE-së. Barnier u bë Drejtor i Përgjithshëm në Komision nga Presidenti Juncker me një ekip të dedikuar ekspertësh në dispozicion të tij si një Task Forcën e Nenit 50, por duke qënë dy herë ish-Komisioner dhe si ish- Ministër i Jashtëm Francez ai menjëherë tejkaloi këtë mandat të nëpunësit civil. Si negociator, ai vizitoi të gjitha kryeqytetet e BE-së, duke dëgjuar dhe mbledhur mbështetje midis presidentëve dhe kryeministrave për pozicionin e BE-së përballë Londrës. Ai ishte gjithashtu i ftuar në të gjitha takimet e Këshillit Europian në formatin e Nenit 50, i cili është i jashtëzakonshëm për një institucion me një politikë të rreptë vetëm për anëtarët dhe vetëm me një pjesë të vogël të nëpunësve civilësi pjesëmarrës.

Michel Barnier arriti të përçonte rolin zyrtar të Komisionit negociues, ekspertizën teknike dhe fuqinë e të menduarit dhe të mobilizojë autoritetin e domosdoshëm politik të siguruar nga Këshilli i plotë Europian. Në një kontrast të mirëpritur me keqmenaxhimin e krizës së refugjatëve pikërisht në këtë pikë, është një shembull i potencialit të Unionit për t'u marrë me situata shkatërruese, me kusht që institucionet të zhvillojnë një bashkëveprim produktiv dhe të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta të njëri-tjetrit. (Middelaar:2019).

*Problematikat kryesore lidhur me demokracinë dhe efiçencën*

Ndoshta reforma më e rëndësishme për rritjen e efikasitetit që Traktati i Lisbonës prezantoi ishte fakti që bëri më të lehtë miratimin e legjislacionit në një sërë politikash. Megjithëse BE-ja nuk kishte aspak për qëllim pengimin para Lisbonës, proceset e saj legjislative ishin relativisht të ngadalta dhe të rrezikuara për t’u ngadalësuar dhe më tej me zgjerimin. Traktati i Lisbonës uli pengesën për miratimin e legjislacionit, së pari thjesht duke shtrirë votimin me shumicë të cilësuar (QMV) në mbi dyzet fusha të politikave që më parë i ishin nënshtruar votimit të unanimitetit, dhe së dyti duke ulur pragun e nevojshëm për të arritur një shumicë të cilësuar në zonat ku do të aplikohej

QMV. Para Lisbonës, procedura kryesore e vendimmarrjes së BE-së që përfshinte QMV ishte njohur si procedurë e vendimmarrjes së përbashkët (në lidhje me rolin e barabartë që i dha Parlamentit Europian në këtë procedurë, e cila diskutohet më poshtë). Bashkëvendimi ishte rritur në rëndësi që kur u prezantua për herë të parë në Traktatin e Mastrihtit dhe u përdor si bazë për afërsisht gjysmën e propozimeve legjislative në vitet pak para se të ratifikohej Traktati i Lisbonës. Traktati i Lisbonës e riemëroi 'bashkë-vendim' procedurën e zakonshme legjislative dhe e shtriu atë në shumicën e fushave të bërjes së ligjit në BE. Në vitet nga hyrja në fuqi e Lisbonës, afërsisht nëntëdhjetë përqind e propozimeve legjislative në BE janë bërë nën procedurën e zakonshme legjislative, dhe për këtë arsye kanë qënë pjesë e QMV.

Në të njëjtën kohë që zgjeroi përdorimin e QMV, Traktati i Lisbonës ndryshoi formulën QMV në një mënyrë që uli pragun e nevojshëm për të kaluar legjislacionin. Traktati i Nicës kishte prezantuar një sistem votimi QMV me shumicë të trefishtë që vendosi një prag të lartë. Sipas versionit të Traktatit të Nicës referuar QMV, shumica e cilësuar e nevojshme për miratimin e legjislacionit duhej të përfshinte: shumicën e vendeve anëtare, të cilët së bashku llogaritnin 74 përqind të votave të ponderuar në Këshill, dhe të cilët së bashku llogaritnin së paku 62 përqind e popullsisë së përgjithshme të BE-së. Jo vetëm që ky sistem i ndërlikuar ka të ngjarë të hutojë votuesit, por gjithashtu vendosi një prag mjaft të lartë që shumë prej tyre kishin frikë se mund të sillte bllokim. Procedurat e reja të votimit të paraqitura në Traktatin e Lisbonës përfshinin një shumicë të cilësuar të konsiderueshme, por ato ulën pragun e nevojshëm për të miratuar legjislacionin, dhe e bënë atë të paktën më të kuptueshme për votuesit. Sipas sistemit të ri me shumicë të dyfishtë të Lisbonës, që legjislacioni të miratojë atë duhet të mbështetet nga të paktën 55 përqind e vendeve anëtare në Këshill, dhe këto vende së bashku duhet të përfaqësojnë së paku 65 përqind të popullsisë së BE-së .

Sa ndikim ka pasur zgjerimi dhe reforma e QMV në efikasitetin e BE-së, mbetet e parakohshme të arrihet në një rezultat përfundimtar, pasi rregullat e reja të QMV hynë në fuqi vetëm nga Nëntori i vitit 2014, dhe deri në vitin 2017 vendet anëtare mund të kërkojnë, rast pas rasti, që të zbatohen rregullat e vjetra të votimit. Gjithashtu, është e pamundur të vlerësohet ndikimi i shtrirjes së QMV si rast I izoluar, pasi shtrirja e QMV ishte e lidhur në përgjithësi me procedurën e re legjislative të zakonshme, dhe kjo procedurë njëkohësisht zgjati rolin e Parlamentit Europian. Ndërsa QMV tenton të zvogëlojë kohëzgjatjen e procesit legjislativ të BE-së në krahasim me votimin e unanimitetit, forcimi i rolit të Parlamentit Europian (PE) tenton të rrisë kohëzgjatjen e

procesit. Pra, dy aspektet kryesore të procedurës legjislative të zakonshme mund në një farë mase të anulojnë njëri-tjetrin kur bëhet fjalë për efikasitetin. Në të vërtetë, ky efekt anullues mund të ndihmojë në shpjegimin pse një studim i fundit nxorri se ndikimi i Traktatit të Lisbonës në efikasitetin legjislativ ka qenë shumë modest.(Kelemen:2019).

Duke u kthyer prapa, ne mund të konsiderojmë arsye të tjera pse zgjerimi i QMV nën Traktatin e Lisbonës, edhe pse i mirëpritur, nuk ka ende dhe nuk ka gjasa në të ardhmen të rrisë thellësisht efikasitetin e vendimmarrjes së BE-së. Përkundër zgjerimit zyrtar të QMV në shumë fusha, rregulla të forta informale të kërkimit të konsensusit në Këshill vijojnë, dhe shumica dërrmuese e votave mbështeten përsëri në unanimitet. Për të qenë të sigurt, konsensusi mund të arrihet nën hijen e një votimit të mundshëm, të tillë që vendet të cilët parashikojnë se mund të tejkalohen, bien dakord të miratojnë me konsensus në grup për arsye strategjike. Por edhe nëse shkalla e vendimeve gjatë konsensusit është ekzagjeruar nga sjellja strategjike, qëndron fakti se ekzistojnë norma të forta në Këshill për të kërkuar konsensus dhe për të shmangur imponimin e vullnetit të shumicës së vendeve mbi pakicën duke i tejkaluar ato. Ajo që pritet është që norma të tilla do të ishin veçanërisht me ndikim në fushat më të ndjeshme të politikë-bërjes në BE, që përkojnë me fushat ku Traktati i Lisbonës shtriu QMV.

Shpejtimi i procesit legjislativ të BE ishte një qëllim kryesor i Traktatit të Lisbonës. Por nëse qeveritë anëtare do të ishin serioze në lidhje me këtë objektiv, ata do të duhet të heqin dorë nga norma e kërkimit të vazhdueshëm të konsensusit në Këshill, i cili në mënyrë të pashmangshme ngadalëson procesin legjislativ dhe shpesh bllokon legjislacionin edhe atje ku mund të fitojë një shumicë të cilësuar nëse vihet në votim. Çdo përparim i vërtetë në përshpejtimin e procesit legjislativ të BE-së do të vijë vetëm kur përfaqësuesit e qeverisë në Këshill të lejojnë që Këshilli të funksionojë si një dhomë e sipërme legjislative, dhe të bëhet më e rehatshme thjesht duke votuar dhe imponuar vullnetin e shumicës (ose shumica e cilësuar sipas QMV) në pakica. Sigurisht, mund të jetë rasti që reformat e Traktatit të Lisbonës do të kishin një ndikim më të madh në efikasitetin e vendimmarrjes nëse BE nuk do të goditej nga një sërë krizash të mëdha të tilla si kriza e Eurozonës, kriza e refugjatëve dhe Brexit menjëherë pas hyrjes në fuqi të Traktatit. Krizat mbizotëruan axhendën e politikave të BE-së në mënyra të atillë që mund të kenë ngadalësuar vendimmarrjen në fusha të tjera. Nuk mund të vlerësojmë shkallën e ndikimit me siguri; por, mund të themi se vendosja e normave të forta të konsensusit dhe roli pohues i Parlamentit Europian do të vazhdojë të kundërshtojë në mënyrë thelbësore përfitimet e efikasitetit të lidhura me zgjerimin e QMV.

*Parlamenti Europian*

Traktati i Lisbonës prezantoi një sërë reformash të krijuara për të forcuar demokracinë e BE-së duke rritur rolin e Parlamentit Europian. Në arenën legjislative, Traktati zgjati procedurën e zakonshme legjislative (e njohur më parë si procedurë e vendimimarrjes së përbashkët) në afërsisht dyzet fusha të reja të politikës. Kjo i dha Parlamentit gati fuqi të barabartë për Këshillin e Ministrave në fusha të tilla si azili, imigrimi, bashkëpunimi policor dhe gjyqësor, bujqësia, fondet strukturore dhe transporti. Kushdo që e sheh Parlamentin, që përbën të vetmin organ të zgjedhur drejtpërdrejt në nivel të BE, si një kanal kryesor për pjesëmarrjen demokratike në vendimmarrjen e BE-së do ta mirëpresë këtë reformë. Rritja e ndikimit të Parlamentit në vendimmarrjen e BE-së nuk shërbeu për ta bërë BE-në më efikase, pasi përfshirja parlamentare mund të zgjasë proceset legjislative; gjithësesi kontribuoi në bërien e procesit më demokratik.

Traktati i Lisbonës gjithashtu forcoi rolin e Parlamentit në përzgjedhjen e Presidentit të Komisionit dhe Kolegjit të Komisionerëve. Megjithatë, dispozitat që Traktati i Lisbonës i shtoi për të forcuar PE në këtë drejtim përmbajnë paqartësi që kanë çuar në konflikt ndërinstitucional. Para Lisbonës, traktatet i kishin dhënë Parlamentit fuqinë për të aprovuar (ose kundërshtuar) kandidatin e Këshillit për President të Komisionit. Traktati i Lisbonës shkoi një hap më tej duke shtuar faktin se Këshilli do të mund propozojë një kandidat për President të Komisionit, sipas zgjedhjeve për Parlamentin Europian dhe se kandidati duhet të zgjidhet nga shumica e eurodeputetëve. Pra, Lisbona ishte më e qartë për politizimin e zgjedhjes së Presidentit të Komisionit duke e lidhur atë me zgjedhjet e Parlamentit Europian.

Paqartësia e dukshme në këtë dispozitë kishte të bënte me atë se çfare nënkuptonte marrja parasysh nga Këshilli i zgjedhjeve të PE. Në prag të zgjedhjeve të vitit 2014, liderët e Europianëve të përfaqësuar në Parlamentin Europian shfrytëzuan këtë dispozitë për të filluar atë që ata e quajtën procesin *Spitzenkandidaten*. Pra, ideja ishte që secila europarti të paraqiste një kandidat për Kryesinë e Komisionit përpara zgjedhjeve parlamentare. Atëherë Parlamenti do të kërkonte që qeveritë në Këshill të propozojnë 'kandidatin fitues' (fillimisht të nënkuptuar si kandidatin e partisë që fitoi shumicën e vendeve, por edhe më tej për të nënkuptuar kandidatin që mund të bashkonte një koalicion mazhoritar në parlamenti pas zgjedhjeve) si Kryetar i Komisionit. Pra, kur Traktati i Lisbonës kishte lidhur në mënyrë të paqartë përzgjedhjen e Këshillit të

Presidentit të Komisionit me rezultatin e zgjedhjeve parlamentare, Parlamenti u përpoq t'i shndërronte këto zgjedhje në një konkurs aktual për Presidencën.

Në vitin 2014, kjo tregoi sukses. Partite Europiane paraqitën Spitzenkandidaten dhe pasi Partia Popullore Europian (EPP) doli në krye të zgjedhjeve, të gjitha partitë europiane kryesore u mblodhën rreth kandidatit të EPP-së, Jean-Claude Juncker. Ndërsa qeveritë në Këshillin Europian fillimisht u përpoqën t'i rezistonin kërkesës së Parlamentit që Juncker të bëhej President, në përfundim të gjithë, përjashtuar Hungarinë dhe Mbretërinë e Bashkuar, pranuan dhe mbështetën emërimin e tij.

Partite Europiane u përpoqën të përsërisnin procesin në vitin 2019, duke e paraqitur Spitzenkandidaten që bëri fushatë në të gjithë Europën dhe mori pjesë në debate televizive. Sidoqoftë, për një sërë arsyesh, Socialistët dhe Liberalët në Parlament nuk ishin të gatshëm të tërhiqeshin pas Manfred Ëeber, Spitzenkandidat i partisë (EPP) që përsëri fitoi pjesën më të madhe të vendeve. Deputetët e EPP dhe shumica e drejtuesve të EPP-së në Këshill më pas u përgjigjën duke refuzuar të mbështesin kandidatin e partisë së dytë më të madhe, Frans Timmermans, të socialistëve. Kundërshtarët e procesit Spitzenkandidaten në Këshillin Europian përfituan nga përçarjet mes partive Europiane dhe parashtruan një kandidat alternativ të PPE i cili nuk kishte qenë një Spitzenkandidat, Ministren Gjermane të Mbrojtjes Ursula von der Leyen. Ajo fitoi miratimin unanim në Këshillin Europian dhe përfundimisht u konfirmua nga një diferencë e ngushtë pas një votimi në Parlamentin Europian.

Këto zhvillime nënvizojnë faktin se dispozitat e Traktatit të Lisbonës që fuqizojnë Parlamentin Europian për të luajtur një rol më të madh në përzgjedhjen e Presidentit të Komisionit, dëshmuan një bazë mbi të cilën mund të ndërtohet sistemi Spitzenkandidaten. Në fund të fundit, debati që u shpalos në vitin 2019, në të cilin Partitë Europiane organizuan fushata dhe debate midis Spitzenkandidaten vetëm për të treguar ata kandidatë të lënë mënjanë nga Këshilli, mund të shërbente për të minuar besimin e publikut në procesin demokratik të BE-së. Nëse BE do të ketë ndonjëherë një sistem sipas të cilit zgjedh një President të Komisionit Europian përmes një votimi pan-Europian të një lloji, kjo do të kërkonte një bazë të qartë në Traktat.

Në përgjithësi, masat e vendosura nga Traktati i Lisbonës për të forcuar rolin e Parlamentit Europian kishin kundërvepruar në një farë mënyre dhe nga tendenca që u

shfaq në vitet pasuese për të anashkaluar metodën e Komunitetit për hartimin e ligjeve të BE plotësisht në favor të zhvendosjes së fokusit të vendimmarrjes në Këshillin Europian dhe duke u mbështetur në metodat ndërqeveritare. Parlamenti shpresonte se ajo mund të shndërronte BE-në në një lloj sistemi parlamentar të qeverisjes, me anë të të cilit Kryetari i Komisionit do të ishte një kryeministër i mbështetur nga, dhe i përgjegjshëm ndaj, një shumicë politike në Parlament. Sidoqoftë, liderët kombëtar e hodhën poshtë këtë vizion në favor të një qasjeje që sheh vendndodhjen përfundimtare të lidershipit dhe legjitimitetit në Këshillin Europian, i cili do të zgjidhte Presidentin e Komisionit dhe do të caktonte axheendën e politikave gjithëpërfshirëse për Komisionin. Procesi i Spitzenkandidaten i vitit 2019, dështoi qe Këshilli qëndron mbi Parlamentin.

*Parlamentet Kombëtare*

Traktati i Lisbonës përfshiu disa masa të hartuara për të forcuar rolin e parlamenteve kombëtar në procesin legjislativ. Këto reforma iu përgjigjën kritikës së zakonshme sipas të cilës BE-ja kishte minuar parlamentet kombëtarë, rrjedhimisht dhe demokracitë kombëtare duke u dhënë mundësi qeverive kombëtare që të evitojnë vendimarrjet jo transparente në Këshillin e Brukselit për ti prezantuar më pas në parlamentet e tyre si fakt. Një mënyrë për të adresuar këtë çështje do të ishte sigurimi i një roli më të madh të parlamenteve kombëtare në vendimmarrjen e BE-së, dhe Traktati i Lisbonës bëri pikërisht këtë. Dhe në fakt Traktati I Lisbonës në nenin 12 të tij njohu zyrtarisht rolin e parlamenteve kombëtar në BE, dhe së bashku me dispozitat e tjera ato krijuan mundësi të reja për bashkëpunim ndër-parlamentar dhe dialog me ligjbërësit e BE-së. Dhe një gjë tjetër e rëndësishme ishte se Traktatit vendosi përmes një protokolli një sistem paralajmërimi të hershëm (EËS) që fuqizoi parlamentet kombëtar të kontrollonin nëse legjislacioni i propozuar i BE-së respekton parimin e subsidiaritetit.

Parimi i subsidiaritetit, i cili është parashikuar në nenin 5 (3) të Traktatit për Bashkimin Europian (TEU), thotë se Unioni do të ndërmarrë veprime vetëm kur objektivat e veprimeve të propozuara nuk mund të arrihen sa duhet nga vendet anëtare. Pra, politikëbërja duhet të mbetet në nivelin më të ulët të mundshëm, dhe BE duhet të ndërhyjë kur qeveritë kombëtare (ose rajonale ose lokale) nuk mund të adresojnë në mënyrë adekuate një çështje. Nën këtë EËS, propozimet legjislative u përcillen parlamenteve kombëtare, të cilat më pas mund të japin një mendim nëse propozimi e tejkalon fuqinë e BE-së në kundërshtim me parimin e subsidiaritetit. Nëse, brenda tetë javëve nga njoftimi i propozimit, një e treta e parlamenteve kombëtare vendosin që një

propozim i Komisionit shkel subsidiaritetin, ata mund të lëshojnë të ashtuquajturin "kartë e verdhë", duke kërkuar ndaljen e iniciativës legjislative. Komisioni mund të zgjedhë të vazhdojë me iniciativën e tij legjislative përballë kësaj kundërshtie, por ai duhet të ofrojë një mendim të arsyeshëm se pse propozimi i tij nuk cënon subsidiaritetin, dhe propozimi i tij mund të bllokohet me një votim ose 55 përqind të shteteve anëtare ose 50 përqind të votave të hedhura në Parlamentin Europian.

Ka patur shumë pak ndikim nga këto dispozita në parlamentet kombëtare në demokracinë, transparencën dhe efikasitetin në vendimmarrjen e BE-së. Parlamentet kombëtar kanë ngacmuar vetëm tre herë procedurën e kartonit të verdhë. Në asnjërin prej këtyre rasteve Komisioni nuk konstatoi se ishte shkelur parimi i subsidiaritetit, megjithëse në një rast vendosi të tërhiqte propozimin për arsye politike.

Dispozitat e Traktatit të Lisbonës për parlamentet kombëtare janë përdorur rrallë dhe kanë pasur një ndikim më modest, sepse ato ishin të bazuara në një identifikim të gabuar të problemeve të BE-së. Shumë parlamentarë kombëtarë dhe kritikë akademikë të BE-së ishin të etur për të fajësuar procesin e politikës së BE për paaftësinë e parlamenteve kombëtar për të kontrolluar qeveritë e tyre; por në realitet, shkaqet e pafuqisë së shumicës së parlamenteve kombëtarë në Europë mund të gjendeshin në politikën e brendshme, jo në nivelin e BE.

Thënë më thjeshtë, shumë parlamente në Europë mbizotërojnë kryesisht nga drejtuesit e tyre si rezultat i dinamikës së disiplinës partiake dhe institucioneve të tjera vendase. Rasti shihet tek një pjesë e vogël e parlamenteve kombëtarë në të gjithë Europën, siç janë Danezët dhe Suedezët, që janë treguar të fuqishëm dhe kanë arritur për vite me radhë të bëjnë një punë mjaft efektive në mbajtjen e përgjegjësive të qeverive të tyre për veprimet në Bruksel. Sidoqoftë, shumica e parlamenteve kombëtare në Europë dominohen plotësisht nga drejtuesit e tyre. Të paturit e parlamenteve të dobëta që rrallë kane treguar interes për të shqyrtuar proceset legjislative të BE-së para Lisbonës, apo për të marrë pjesë në bërjen e ligjeve të BE-së dhe për të bërë përpjekje për të bllokuar legjislacionin nuk mund të sillte ndryshim. Mund të jetë e vërtetë që shumë qeveri kombëtare përpiqen të anashkalojnë kontrollin nga parlamentet e tyre kur ata përfshihen në hartimin e politikave në nivelin e BE; por përgjigjja për këtë deficit demokratik duhet të gjendet në nivelin kombëtar përmes reformave të brendshme që fuqizojnë

parlamentet për t'i mbajtur drejtuesit përgjegjësitë e tyre. Parlamentet kombëtar nuk duhet të presin që BE t'i ndihmojë ata ta bëjnë këtë.

*Këshilli Europian*

Një tjetër grup i rëndësishëm i reformave në Traktatin e Lisbonës u përpoq të institucionalizojë dhe forcojë rolin e Këshillit Europian. Megjithëse Këshilli Europian kishte ekzistuar që nga viti 1974, vetëm me Traktatin e Lisbonës u krijua zyrtarisht si një institucion i Bashkimit Europian. Përveç institucionalizimit zyrtarisht të Këshillit Europian, Traktati i Lisbonës krijoi një pozicion të ri drejtimi, një President të përhershëm të Këshillit Europian i cili do të shërbejë për një mandat dy vite e gjysëm, me një herë të drejtë rinovimi. Qëllimi kryesor i deklaruar i këtij pozicioni të ri ishte rritja e efikasitetit të vendimmarrjes së BE-së duke sjellë vazhdimësi më të madhe drejtimit të Këshillit Europian, i cili më parë ishte nryshuar çdo gjashtë muaj në varësi të vendit anëtar  që mbante Presidencën e rradhës së Këshillit të Ministrave. Por kjo as nuk pritej dhe as nuk ka dështmuar se ka përmirësuar efikasitetin, transparencën dhe demokracinë në BE.

Së pari, duhet të theksohet se ndërsa Traktati i Lisbonës themeloi një President të ri të përhershëm të Këshillit Europian, ai nuk shpëtoi institucionin e Presidencës së Këshillit, i cili ndryshon me sistem rotacioni midis qeverive anëtare çdo gjashtë muaj. Për të adresuar mospërputhjet e krijuara nga qarkullimi i Presidencave të Këshillit çdo gjashtë muaj, grupeve të tre vendeve anëtare që do të mbajnë Presidencën e Këshillit në vazhdim, ju kërkua të merrnin pjesë në të ashtuquajturin 'Presidencën e Trio-s', duke rënë dakord për një axhendë të përbashkët 18-mujore . Van Gruisen konstaton se Presidenca e trefishtë ka përmirësuar efikasitetin e vendimmarrjes legjislative në krahasim me skemën e rotacionit të thjeshtë gjashtëmujor. Gjithësesi nëse Traktati realisht do të kishte synuar maksimizimin e efiçencës së vendimmarrjes së Këshillit, ai do ta kishte eleminuar sistemin me rotacion te Presidencës. Në vend të kësaj, Lisbona përfundoi me një marrëveshje hibride të vështirë, në të cilën Këshilli Europian, i cili mbledh kokat e qeverive të vendeve anëtare, mban dhe Këshillin e Bashkimit Europian, i cili mbledh ministrat e ndryshëm të atyre qeverive, duke i udhëhequr këto ndarazi.

Nëse kthehemi  prapa, bëhet e qartë se çfarë kaosi ka krijuar Traktati i Lisbonës në drejtim të udhëheqjes. Nga njëra anë, ne kemi një Këshill Europian të udhëhequr nga një President i përhershëm i cili krijon një seri prioritetesh politike, një Axhendë Strategjike pesë-vjeçare. Nga ana tjetër, ne kemi një Presidencë Trio të Këshillit, e

përbërë nga tre Kryesitë Kombëtare të veçanta 6-mujore, të cilat përcaktojnë përparësitë e veta. Këto Presidenca të rradhës kontrollojnë pjesën më të madhe të axhendës së përditshme të Këshillit dhe, nëse ata vendosin, mund të bllokojnë përparimin në një çështje. Në fund, Presidenti i Komisionit Europian përcakton përparësitë e tij ose të saj politike, siç janë dhjetë prioritetet e Juncker të përcaktuara para zgjedhjes së tij në 2014.

Konfuzioni i madh për sa i përket udhëheqjes së BE të prodhuar nga Traktati i Lisbonës u krijua në vitin 2012 kur BE fitoi Çmimin Nobel për Paqen dhe duhej një udhëheqës i BE të tërhiqte çmimin. Sipas marrëveshjeve të Lisbonës, në skenën botërore nuk kishte një udhëheqës ose zë të qartë të BE-së, as Presidenti i Këshillit Europian, as Presidenti i Komisionit, dhe as Përfaqësuesi i Lartë i Punëve të Jashtme dhe Politikës së Sigurisë. Në fund të fundit, tre "presidentët" të BE-së, Presidenti i Komisionit, Presidenti i Këshillit Europian dhe Presidenti i Parlamentit Europian, udhëtuan në Oslo për të marrë çmimin së bashku në emër të BE-së.

Paqartësia në lidership që prodhoi Traktati i Lisbonës nuk ishte aksidentale. Në fakt, një pjesë e arsyes që qeveritë anëtare mezi prisnin të krijonin një President të përhershëm të Këshillit Europian ishte se ata donin të parandalonin që Presidenti i Komisionit Europian të bëhej udhëheqësi de-fakto i BE-së në skenën botërore. Duke e lidhur përzgjedhjen e Presidentit të Komisionit më fuqishëm me zgjedhjet e Parlamentit Europian, qeveritë anëtare e dinin se ato do t'i shtonin legjitimitetin demokratik të Presidentit të Komisionit. Por një President i Komisionit më i legjitimuar politikisht mund të bëhet gjithashtu një drejtues më i fuqishëm dhe që ndjehej më i qetë duke u njohur si lideri i BE-së. Për ta kapur këtë mundësi, Traktati i Lisbonës vendosi Presidentin e Këshillit si një burim alternativ të udhëheqjes së BE-së, dhe ai që do të lidhej fort me qeveritë anëtare, duke marrë një perspektivë ndërqeveritare dhe jo mbikombëtare.

*Iniciativa Qytetare Europiane*

Në përpjekje për të forcuar demokracinë e BE-së, për të inkurajuar pjesëmarrje më të drejtpërdrejtë nga qytetarët në procesin e politikave të BE-së, dhe për të nxitur një shoqëri civile pan-Europiane, Traktati i Lisbonës prezantoi gjithashtu mundësinë për Iniciativat e Qytetarëve Europianë, ose ECI (neni 11 TEU dhe neni 24 TFEU). Më shumë detaje që rregullojnë funksionimin e këtyre iniciativave u përcaktuan në një

rregullore të vitit 2011 (Reg. 211/2011). Në thelb, nëse një komitet transnacional i qytetarëve mund të mbledhë të paktën një milion nënshkrime dhe të përmbushë pragjet minimale të nënshkrimeve në të paktën shtatë shtete anëtare të ndryshme, atëherë organizatorët do të jenë në gjendje të paraqesin iniciativat e tyre përpara Parlamentit Europian dhe Komisionit do ti kërkohet të përgjigjen zyrtarisht. Një iniciativë e suksesshme nuk mund ta detyrojë Komisionin të prezantojë legjislacionin, por Komisioni së paku duhet të nxjerrë një komunikim duke shpjeguar se si planifikon t'i përgjigjet kësaj iniciative. Gjithësesi, ECI nuk ka luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e demokracisë së BE siç kishin shpresuar mbështetësit e saj.

Sigurisht, shumë organizata të shoqërisë civile kanë shfaqur interes për ECI dhe procedura ka treguar një potencial të madh. Janë nxjerrë më shumë se 70 ECI dhe mbi një duzinë kanë arritur të regjistrohen zyrtarisht në Komision. Sidoqoftë, vetëm katër nga këto ECI kanë arritur pragun e një milion firmave dhe asnjë prej tyre nuk ka rezultuar në zbatimin e legjislacionit. Gjithashtu, siç përfundoi një studim i fundit, ndërgjegjësimi i publikut dhe vëmendja e mediave për ECI mbetet jashtëzakonisht e kufizuar. Organizatorët e ECI kanë theksuar barrën e lartë administrative dhe sfidat e ndryshme burokratike të përfshira në sistemin aktual, gjë që çoi në dështimin e shumë prej nismave. Si përgjigje, në vitin 2019 ligjbërësit e BE ranë dakord për një rregullore të re për të lehtësuar ECI (Rregullorja 2019/788), e cila do të hyjë në fuqi vitin e ardhshëm. (Kelemen:2019).

Mund të ndodh të shohim ECI më të suksesshme në të ardhmen, pasi të hyjë në fuqi rregullorja e re. Për më tepër, procesi i përpjekjes për të filluar ECI-të, sido qofshin këto, mund të kontribuojë për një afat të gjatë në forcimin gradual të lidhjeve ndërkufitare midis organizatave të shoqërisë civile. Sidoqoftë, ndërkohë që ECI-të mund të jenë një risi e mirëseardhur, ata kurrë nuk do të zgjidhin sfidat themelore me të cilat përballet demokracia në BE. ECI nuk do të bëjnë kurrë më shumë sesa hera herës të përfshijnë një çështje në axhendën e politikave, duke detyruar liderët që të paktën ta konsiderojnë. Ndërsa është i mirëseardhur, zhvillimi i ECI-ve nuk mund të jetë zëvendësues për demokratizimin e mëtejshëm të institucioneve thelbësore të BE-së dhe proceseve legjislative.

Traktati i Lisbonës shënoi pikën kulmore të gati një dekade debati mbi reformën e institucioneve të BE-së. Traktati futi me siguri disa reforma që forcuan demokracinë e BE-së, siç është rritja e rolit të Parlamentit Europian duke marrë vendime të përbashkëta

si një procedurë e zakonshme legjislative e BE-së. Për më tepër, Traktati prezantoi reforma të tjera që të paktën kishin potencialin për të rritur efikasitetin e qeverisjes së BE-së, siç është reforma e procedurave të QMV, e krijuar për të ulur pragun e nevojshëm për miratimin e legjislacionit. Reforma të tjera të paraqitura në Lisbonë, siç është Nisma e Qytetarëve, nuk kanë ndikuar shumë në demokraci apo efikasitet, por mund të shihen si eksperimente premtuese për të rritur angazhimin e qytetarëve. Në fund, reformat e Traktatit të krijuara për të rritur përfshirjen e parlamenteve kombëtar në bërjen e ligjeve të BE-së kanë pasur pak ndikim të dukshëm sepse ata synuan një problem, mungesën e angazhimit të parlamenteve kombëtar në çështjet e BE, që zë vend më shumë në politikën e brendshme, në dinamikën e mbizotërimit të shumë drejtuesve mbi parlamentet e tyre, sesa në nivelin e BE-së.

Por, pavarësisht të gjitha këtyre reformave, BE-ja është bërë në përgjithësi më pak demokratike dhe më pak efikase në dekadën që nga ratifikimi i Lisbonës. Që do të thotë, jo se BE është dobësuar ose është duke u shpërbërë. Përkundrazi, në përgjigje të krizave me të cilat është përballur BE vitet e fundit, liderët europianë i kanë dhënë BE-së një varg fuqish të reja, si për shembull, në fushën e rregullimit bankar dhe mbikëqyrjes fiskale në përgjigje të krizës së Eurozonës, ose në fushën e sigurisë kufitare në reagim ndaj krizës së refugjatëve. E megjithatë, edhe në mesin e këtyre lëvizjeve që kanë forcuar BE-në në disa aspekte, demokracia e BE-së po sfidohet nga shfaqja e qeverive anëtare autoritare, dhe efikasiteti i qeverisjes së BE-së është minuar nga një besim në rritje në adresimin e sfidave të politikave jo përmes procesit normal legjislativ, por përkundrazi përmes marrëveshjeve të fshehta, të bëra në Këshillin Europian në momentet e krizës.

Sfidat kryesore për demokracinë dhe efikasitetin në BE sot nuk rrjedhin nga reformat e paraqitura në Lisbonë, por nga çështje dhe kërcënime që Traktati i Lisbonës nuk arriti t'i njohë ose adresojë. Ndërsa liderët e BE-së edhe njëherë mendojnë për mbajtjen e një konference mbi të ardhmen e Europës në vitin 2020, duhet të shpresojmë që kësaj radhe ata do të diagnostikojnë siç duhet sfidat qëndrore të demokracisë dhe efikasitetit në BE. Mbi të gjitha, liderët e BE-së duhet të prezantojnë reforma të krijuara për të forcuar aftësinë e BE-së për të sanksionuar qeveritë anëtare që shkasin në autoritarizëm, për të mbrojtur integritetin e zgjedhjeve europiane, për të mbrojtur të drejtat e votimit të qytetarëve europianë, për t'i dhënë fund kulturës së fshehtësisë dhe unanimitetit në Këshilli, dhe për të forcuar aftësinë e Komisionit dhe gykatave të BE-së për të zbatuar ligjin europian.

*Problematikat e Traktatit lidhur me legjitimitetin*

Problematikat e kësaj fushe janë relativisht të lehta për t'u zgjidhur, qoftë përmes një ndryshimi në praktikën gjyqësore të Gjykatës, qoftë përmes ndryshimeve legjislative, veçanërisht në lidhje me emigracionin. Më e vështirë është kriza e zbatimit të ligjit, me anë të së cilës vendet anëtare të BE-së mund të vendosin të largohen nga vlerat e demokracisë, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave themelore, tre vlera të ndërthurura në mënyrë të pandashme, në pamundësi për BE-në që të ndërhyjë.

Në këtë drejtim, Traktati i Lisbonës nuk është  sukses pasi nuk e ndryshoi në thelb nenin 7 TEU, një dispozitë e cila gjithmonë është konsideruar tepër simbolike. Këtu është ndoshta e dobishme të kujtojmë si historinë ashtu edhe funksionimin e Nenit 7 TEU. Siç dihet, BE nuk ka një kompetencë specifike në mbrojtjen e të drejtave themelore dhe nuk është një organizim i të drejtave themelore. Kjo do të thotë që Komisioni nuk ka kompetenca përmbaruese, pra, fuqi për të sjellë një shtet para Gjykatës së Drejtësisë, me arsyetimin e vetëm që vendi anëtar nuk i përmbush të drejtat themelore. Mbi të gjitha, Karta zbatohet vetëm kur autoritetet kombëtare zbatojnë ligjin e BE-së; kur autoritetet kombëtare ushtrojnë të drejtat e tyre, Karta nuk ka vend, dhe duhet që gjykatat kombëtare dhe Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut të veprojnë si garantues të vlerave themelore që duhet të jenë përcaktuesi minimal i përbashkët i të gjithë politikave kombëtare të Bashkimi Europian.(Spaventa:2019)

Gjatë përgatitjeve të BE-së për zgjerim në Europën Qendrore dhe Lindore, ekzistonte frika se demokracitë e reja mund të mos i mbështesin vlerat e BE-së në standardet e dëshiruara. Kjo çoi në dy zhvillime: para së gjithash, Këshilli Europian në konkluzionet e tij të Kopenhagenit vendosi që respektimi i këtyre vlerave ishte parakusht për anëtarësim. Së dyti, në Traktatin e Amsterdamit dhe më vonë Traktatin e Nicës, BE-ja pajisi veten me një mekanizëm sanksionues kundër vendeve anëtare që shkelin këto vlera. Kriteret e Kopenhagenit dhe neni 7 TEU duhet të kishin garantuar moskompromentimin e vlerave të BE-së.

Kjo dëshmoi të jetë një levizje e mirë  pasi Neni 7 TEU siguron një mekanizëm deklarues dhe sanksionues. Neni 7 (1) TEU i jep mundësinë Këshillit, duke vepruar me një shumicë prej katër të pestave (22 anëtarë), të deklarojë se ekziston një rrezik i qartë i një shkeljeje serioze të vlerave të përcaktuara në nenin 2 TEU; që është demokracia, sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore të një vendi anëtar të caktuar. Përpara deklaratës, Këshilli mund të angazhohet në një lloj dialogu të zgjeruar me vendin anëtar

përkatës dhe t'i adresojë rekomandimet për të. Sidoqoftë, sanksionet nuk mund të imponohen, vetëm nëse ekziston konstatimi se ekziston një shkelje serioze dhe e vazhdueshme e vlerave të parashikuara në nenin 2 TEU. Në këtë rast, vendimi duhet të merret unanimisht, perjashtuar votën e vendit anëtar në gjykim, nga Këshilli Europian. Problemi me nenin 7 TEU  është jashtëzakonisht politik, duke e bërë shumë të vështirë arritjen e mazhorancës së lartë në Këshill, madje edhe pragun më të ulët 4/5 të kërkuar nga neni 7 (1) TEU.

Efektiviteti i Traktatit varet nga qasja e dy situatave: kur ka shkas për pezullim ose dëbim, do të thotë se BE vepron si një organizatë e thjeshtë ndërkombëtare, anëtarësimi prej të cilës mund të ndërpritet nëse pala kontraktuese nuk respekton rregullat e lojës. Nga ana tjetër, nëse BE do të parashikonte zbatimin e standardeve themelore të të drejtave në fushat që nuk rregullohen me ligjin e BE-së, atëherë ajo do të ndryshonte rrënjësisht natyrën e saj. Nëse shkeljet e të drejtave themelore bëhen çështje e ligjit të BE-së, atëherë nuk do të kishte hapësirë për të identifikuar fushat e paprekura nga ligji i BE-së. Kjo do të sjellë marrjen e një hapi të madh drejt të bërit një entitet federal, më shumë sesa një sistem që karakterizohet nga kompetencat e dhëna. (Spaventa:2019).

*Baza ligjore për mbrojtjen e të drejtave themelore në BE*

Karta e të Drejtave Themelore, shpallur për herë të parë në vitin 2000 dhe dhënien e efektit të plotë juridik me Traktatin e Lisbonës, është një kodifikim i të drejtave ekzistuese. Ai bazohet në një numër burimesh, siç janë praktikat gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë dhe traditat e njohura kushtetuese të vendeve anëtare, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Traktate të tjera ndërkombëtare. Ajo ofron një përmbledhje të qartë të të drejtave, azhurnuar për të përfshirë të drejtat e gjeneratës së re, të tilla si mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtat bioetike, dhe është premisuar për 'ekuivalencën' e të drejtave, duke refuzuar kështu hierarkinë tradicionale midis të drejtave civile dhe politike, nga njëra anë, dhe të drejtat shoqërore nga ana tjetër. Struktura e saj largohet nga dokumentet tradicionale kushtetuese në atë që Karta është e ndarë në gjashtë tituj tematikë, secili duke parashikuar një vlerë kushtetuese, si dinjitetin, liritë, barazinë, solidaritetin, të drejtat e qytetarëve, drejtësinë. Titulli pasues, ai më i ndërlikuari, përcakton fushën e zbatimit të Kartës, marrëdhëniet midis dispozitave të tij dhe të drejtave të mbrojtura në dokumente të tjera, veçanërisht ECHR, dhe kushtet në të cilat të drejtat në Kartë mund të kufizohen.

*Karta dhe aplikimi i saj në BE*

Karta i adresohet para së gjithash BE-së dhe institucioneve të saj. Në të fundit, qëllimi kryesor i kodifikimit ishte të siguruarit që, në rolin e saj legjislativ dhe administrativ, BE të ishte e kufizuar qartazi nga kufijtë ekuivalent me ato që zbatohen në nivel kombëtar. Në institucionet e BE-së përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, Karta mund të ketë bërë një ndryshim në besimin me të cilin gjykata interpretoi rolin e saj të garantuesit të të drejtave themelore.

Gjykata ka qenë aktive jo vetëm në lidhje me ligjin e privatësisë; Kjo do të thotë që edhe kur institucionet e BE-së veprojnë jashtë sferës së Traktateve (siç janë ato në lidhje me krizën e euros), të drejtat themelore dhe, rrjedhimisht, juridiksioni i Gjykatës brenda procedurës së vendimit paraprak garantohet, të paktën në teori.

Por ka dhe aspekte të ndryshme nga kjo pikëpamje. I tillë është rasti i qasjas së Gjykatës ndaj Rregullores së Dublinit II. Kujtojmë se sistemi i Dublinit parashikon që porti i hyrjes së parë, pra vendi ku mbërrin së pari emigranti jo-europian i pa dokumentuar, është përgjegjës për përpunimin dhe ofrimin e mbrojtjes ndërkombëtare për azilkërkuesit. Pas krizave të emigracionit që buruan së pari nga konflikti në Siri dhe më vonë nga konfliktet dhe ndryshimet klimaterike në Afrikë, Greqia dhe Italia kanë qenë brigjet e destinacionit për shumicën e madhe të flukseve të migrantëve. Veçanërisht Greqia u gjend e paaftë për të përballuar fluksin dhe, si rezultat, situata në kampet e migrantëve u përkeqësua, duke rezultuar në kushte të pasigurta dhe degraduese. Ishte në këtë kontekst që u ngrit para Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut çështja për emigrantët, porti i parë i hyrjes i të cilëve ishte Greqia dhe që kishin mbërritur më pas në Belgjikë për të aplikuar atje për azil. Këto u përballën me një urdhër deportimi në përputhje me Rregulloren e Dublinin. Paditësit argumentuan me sukses se, duke pasur parasysh kushtet në kampet e pritjes në Greqi, kthimi i tyre i detyruar do të shkelte të drejtën për të mos u përballur me një trajtim degradues, garantuar nga ECHR. (Spaventa:2019).

Nga këndvështrimi i BE-së, ky rast është një frenues i rëndësishëm në sistemin e Dublinit në atë që ndikon në aftësinë e Shteteve Anëtare për të kthyer migrantët në portin e hyrjes së parë kur kushtet në kampet e migrantëve ose në përpunimin e aplikacioneve në atë shtet nuk është i kënaqshëm. Në këtë kontekst është thirrur Gjykata e Drejtësisë të vendosë një çështje të ngjashme. Këtë herë, paditësit ishin në Mbretërinë e Bashkuar dhe gjithashtu po i rezistonin dëbimit në Greqi; ata argumentuan se dëbimi i

tyre do të ishte në kundërshtim me Kartën e të Drejtave Themelore, kështu që gjykata nacionale bëri një referencë paraprake në Gjykatën e Drejtësisë.

Duhet të theksohet se Karta përmban një të drejtë ekuivalente me nenin 3 KEDNJ dhe që BE nuk mund të bjerë nën mbrojtjen e KEDNJ-së. Prandaj, Gjykata e Drejtësisë ishte e detyruar me ngurim të pasqyrojë vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, por e bëri këtë duke u përpjekur të ruajë sa më shumë të jetë e mundur të sistemit të Dublinit dhe të prezantonte një provë shumë të rreptë, ndoshta më e rreptë se ajo që parashikohej për nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut, e cila u përqëndrua në faktin nëse qeveria Belge 'dinte ose duhej të dinte që ai (kërkuesi) nuk kishte asnjë garanci se kërkesa e tij do të shqyrtohej nga autoritetet greke'. (Spaventa:2019).

Gjykata e Drejtësisë,nga ana tjetër, me vendimin se shteti anëtar nuk duhet të transferojë një azilkërkues në portin e hyrjes së parë, kur nuk mund të mos jetë në dijeni të mangësive sistemike në procedurën e azilit dhe në kushtet e pranimit të azilkërkuesve në atë shtet anëtar shuma të konsiderueshme me besimin se azilkërkuesi do të përballet me një rrezik të vërtetë për t'u nënshtruar një trajtimi çnjerëzor ose degradues në kuptimin e kësaj dispozite.

Arsyeja e ngurimit të Gjykatës për zbatimin e të drejtave themelore në këto raste është sa e ndërlikuar dhe e thjeshtë: roli i Gjykatës ka ndryshuar në 60 vitet e fundit; fillimisht veproi si kujdestar i traktateve kur traktatet ishin të kufizuara në kërkimin e integrimit ekonomik, por tani, dhe gjithnjë e më teper, vepron si mbrojtës i të drejtave themelore. Megjithatë, instinkti për të mbrojtur efektivitetin e ligjit të BE-së, dhe vetë mundësia për të mbajtur atë ligj, fiton një peshë më të rëndësishme sesa duhet. Në rastet që lidhen me Rregulloren e Dublinit, dhe në rastet që lidhen me Garancinë Europiane të Urdhër Arrestit, një aplikim serioz i standardeve themelore të të drejtave do të dëmtonte bazën mbi të cilën ndërtohen këto masa: atë të besimit të ndërsjellë ndërmjet vendeve anëtare, besim të ndërsjellë që gjithashtu përfshin besimin në standardin e mbrojtjes së të drejtave themelore.

Megjithëse mbrojtja e të drejtave themelore në lidhje me aktet e institucioneve të BE-së mund të ishte përmirësuar prej Kartës, ekzistojnë disa fusha në të cilat mbrojtja e ofruar nga Gjykata e Drejtësisë mund të bëjë më mirë. Në praktikë, si në rastin e migracionit, kjo ndodh sepse, një mbrojtje e rreptë dhe serioze e të drejtave themelore do të vijë në kurriz të efektivitetit të masave të BE-së. Nëse Gjykata do t'i merrte seriozisht të drejtat

e azilkërkuesve, atëherë sistemi i Dublinit do të bëhej shumë i paefektshëm. (Spaventa:2019).

*Zbatimi i Kartës nga vendet anëtare*

Karta gjithashtu vlen për aktet e vendeve anëtare kur ato zbatojnë ligjin e BE-së. Në praktikë, kjo do të thotë që kur një vend anëtar i jep fuqi çdo pjese të legjislacionit parësor ose sekondar të BE-së, përfshirë këtu kur heq dorë nga të drejtat e lëvizjes së lirë garantuar nga Traktati, ai duhet të përputhet me dispozitat e Kartës.

Detyrimi për të respektuar të drejtat themelore si parim i përgjithshëm i ligjit të BE-së ishte edhe përpara Kartës; kështu, Neni 51 është një kodifikim i situatës para-ekzistuese. Sidoqoftë, ajo që ndryshon në kodifikim është që gjykatat kombëtare fitojnë një vetëdije të re për fushën e zbatimit të të drejtave themelore të BE-së, duke shtyrë shpesh kufijtë e zbatimit të Kartës, dhe kanë një përdorim më të gjerë të të drejtave themelore të BE-së.

